



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë

Raporti Vjetor “Për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2013” të Prokurorisë së Përgjithshme është një material i përmbledhur mbi zhvillimet institucionale, prioritetet, objektivat dhe rezultatet e arritura gjatë vitit të kaluar, lidhur me numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë si dhe drejtimit e përparësitë në luftën ndaj tij.

Në fokus të punës së organit të Prokurorisë ka qenë dhe vijon të jetë lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në kuadër të këtyre prioritetëve, Prokuroria e Përgjithshme ka hartuar plane dhe strategji veprimi, të ndërthurura me rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit Europian, Këshillit të Ministrave, si edhe të institucioneve të tjera kombëtare e ndërkombëtare që operojnë në fushën e drejtësisë dhe forcimit të shtetit ligjor.

Në raportin për vitin 2013, Prokuroria e Përgjithshme Ju prezanton në mënyrë të detajuar statistikat për grup-veprat penale, si edhe pritshmëritë për periudhën në vijim.

Gjithashtu, konstatohet rritje e ndjeshme e bashkëpunimit me agjencitë homologe ndërkombëtare, e cila ka forcuar më tej rolin e organeve shqiptare të drejtësisë në luftën kundër krimit transkufitar.

Për vitin 2014, prokuroria ka përcaktuar objektivat e saj, për rritjen e efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfqësimin e akuzës në gjykatë, forcimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave, interesave e lirive të ligjshme të shtetasve, me synim rritjen e luftës kundër kriminalitetit, rritjen e transparencës dhe besimi të publikut në veprimtarinë e prokurorisë.

Duke shprehur vlerësimet për mbështetjen dhe duke ju siguruar se Prokuroria e Përgjithshme do të vijojë me intensitet të lartë luftën kundër krimit në çdo formë të tij, ju paraqesim Raportin Vjetor për Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2013.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

PJESA I.....	4
PREZANTIMI I PRIORITETEVE DHE ARRITJEVE TË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2013.....	4
KUSHTETUETSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA.....	4
REKOMANDIMET E KOMISIONIT EUROPIAN.....	4
REKOMANDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE.....	6
PRIORITETET, VITI 2013.....	7
Lufta kundër korrupsionit.....	7
Lufta kundër krimit të organizuar.....	10
Të drejtat e njeriut.....	14
Forcimi i kapaciteteve institucionale.....	16
VITI 2013, ANGAZHIME TË RËNDËSISHME.....	20
RAPORTET ME INSTITUCIONET KRYESORE.....	26
PJESA II.....	30
STATISTIKAT PENALE TË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2013.....	30
VOLUMI I PUNËS NË HETIM PËR VITIN 2013.....	30
ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË.....	31
TREGUESIT KRYESOR TË PUNËS SË PROKURORISË NË PESË VITET E FUNDIT.....	32
PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2013.....	37
KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100.000 BANORË BAZUAR NË SISTEMIN STATISTIKOR TË PROKURORISË.....	40
TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE.....	41
TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË.....	43
KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL.....	44
II. ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL.....	49
KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE.....	49
KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI.....	58
VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE.....	59
VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA.....	64
VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS.....	64

KRIME SEKSUALE.....	67
VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT.....	71
VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT.....	74
VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES.....	78
LIRIA E BESIMIT.....	83
VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE.....	83
MASHTRIMET.....	92
SHKATËRRIMI I PRONËS.....	98
VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE.....	104
VEPRA PENALE NË VEPRIMTARITE BANKARE DHE FINANCIARE.....	107
KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE.....	108
VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET.....	115
FALSIFIKIMI I MONEDHEVE DHE LETRAVE ME VLERË.....	119
FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE.....	122
ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJRAVE TË FATIT.....	128
VEPRA PENALE QË CËNOJNË REGJIMIN JURIDIK TË TOKËS.....	131
VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT.....	134
KRIME KUNDËR PAVARËSISË E RENDIT KUSHTETUES DHE KRIME QË CËNOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA.....	138
VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE.....	139
KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT.....	140
VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHERBIM PUBLIK.....	145
VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE.....	150
VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE.....	165
VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHTETËRORE.....	169
VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË.....	173
VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE.....	181
VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT.....	182
KRIMI KIBERNETIK.....	188
TRAFIQET E PALIGJSHME.....	192

VEPRA PENALE TË KRYERA NGA BANDA E ARMATOSUR,ORGANIZATA KRIMINALE...	196
TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2013.....	197
TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK.....	208
TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË GJYKIMIN DHE NË DËNIMIN E TË PANDEHURVE.....	209
TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KËRKUARA NGA PROKURORËT.....	209
TE DHENA MBI KERKESEN E PROKURORIT DHE VENDIMET GJYKATES.....	214
PJESA III.....	216
MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2013.....	216
Ekstradimet.....	217
Letërporositë.....	221
Njohjet e vendimeve penale.....	226
Transferimet e procedimeve penale.....	228
Transferimet e personave të dënuar.....	230
Urdhrat e arrestit ndërkombëtar.....	231
Marrëveshjet dypalëshe/shumëpalëshe të nënshkruara në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale.....	234
Trajnime, vizita të prokurorëve jashtë vendit.....	237
Përfshirje e prokurorisë me vendosje pika kontakti në organizata të ndryshme si dhe pika kontakti ndërinstucionale.....	240
PJESA IV.....	241
PROKURORIA PËR KRIME TË RËNDA.....	241
VOLUMI DHE DINAMIKA E PROCEDIMEVE.....	241
PJESA V.....	248
OBJEKTIVAT DHE VIZIONI I PROKURORISË PËR VITIN 2014.....	248
Objektivat dhe vizioni i prokurorisë shqiptare në strategjinë kombëtare kundër korrupsionit	248
Roli i prokurorisë në strategjinë ndërsektoriale të drejtësisë.....	251
Marrëdhëniet me jashtë, nevoja për përmirësime.....	252

PJESA I

I. PREZANTIMI I PRIORITETEVE DHE ARRITJEVE TË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2013

Prokuroria Shqiptare, institucioni kushtetues për ushtrimin e ndjekjes penale dhe ngritjen e akuzës në emër të shtetit në Republikën e Shqipërisë, ka zhvilluar aktivitetet të gjerë gjatë vitit 2013. Volumi i punës është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2012, kjo e lidhur me intensifikimin e punës së organit të akuzës, rritjes së bashkëpunimit me institucionet e tjera, aktivizimit të rritur të qytetarëve, medias dhe shoqërisë civile.

Aktiviteti institucional është bazuar në tre komponentë kryesore;

1. Kushtetutën dhe Ligjet
2. Rekomandimet e Komisionit Europian
3. Rekomandimet e Këshillit të Ministrave

Mbi këtë bazë është ndërtuar strategjia afat-shkurtër dhe afat-mesme e organit të Prokurorisë, si edhe janë përgatitur prioritetet institucionale.

KUSHTETUETSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA

E gjithë veprimtaria e organit të Prokurorisë është bazuar në radhë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si edhe në kuadrin ligjor që rregullon mënyrën e funksionimit të institucionit, mënyrën e hetimit, ushtrimit të ndjekjes penale, ngritjes së akuzës, përfaqësimit të saj në gjykim, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si edhe bashkëpunimin me aktorë dhe faktorë të jetës institucionale dhe shoqërore.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në nenin 148 dhe 149 të saj, është përcaktuar mënyra e funksionimit dhe llogaridhënia e institucionit.

Vendimmarrja dhe aktiviteti i Prokurorisë së Përgjithshme kontrollon në dy forma:

- Së pari, nga Kuvendi i Shqipërisë, lidhur me gjendjen e kriminalitetit, parashikuar kjo nga neni 149, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Së dyti, nga Presidenti i Republikës, lidhur me emërimet dhe shkarkimet prokurorëve, parashikuar nga neni 149, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ky përcaktim kushtetues është një formë indirekte e llogaridhënies, nisur nga fakti se propozimet e Prokurorit të Përgjithshëm kalojnë për dekretim te Presidenti i Republikës. Kreu i shtetit, sipas përcaktimeve kushtetuese, ka hapësirën e duhur ligjore për të miratuar ose për të mos u shprehur lidhur me propozimet e Prokurorit të Përgjithshëm, duke i rrëzuar në këtë mënyrë këto propozime.

Organi i Prokurorisë ushtron aktivitetin e tij institucional mbi bazën e ligjit organik, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Në harmonizim me aktet ligjore në fuqi, një vëmendje të veçantë në veprimtarinë e prokurorisë zënë zbatimi i normave që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve, si edhe ruajtjen e të dhënave konfidenciale të shtetasve dhe të institucioneve publike.

REKOMANDIMET E KOMISIONIT EUROPIAN

Shqipëria po punon intensivisht për të qenë pjesë integrale e Bashkimit Europian. Për këtë arsye, organi i Prokurorisë i konsideron shumë të rëndësishme rekomandimet e Komisionit Europian, duke i vlerësuar në radhën e hartimit të strategjive institucionale dhe përfshirjes në këtë raport.

Në Raport-Progressin e vitit 2013 për Shqipërinë, i cili rithekson çështjet e prezantuara edhe në Raport-Progressin e vitit 2012, në kreun ku flitet për institucionet e drejtësisë, theks i veçantë i vendoset vijimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në vlerësimin e përgjithshëm përsa i përket **luftës kundër korrupsionit**, Progres-Raporti thekson se “*Ka patur përmirësime në luftën kundër korrupsionit, një prioritet kyç i Opinionit*”. Por ‘*korupsioni mbetet një problem veçanërisht serioz dhe është mbizotërues në shumë fusha, përfshi institucionet e zbatimit të ligjit*’.

Ndër arritjet e shënuara gjatë vitit 2013, Komisioni European veçon:

- Janë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha rekomandimet e raundit të 3-të të vlerësimit të GRECO-s, që kishin të bënin posaçërisht me financimin e partive politike.
- Track records fillestare mbulojnë një larmi fushash dhe nivelesh, përfshi nivelin e lartë. Ato tregojnë rritje në dënime.
- Disa masa të marra në sektorë kyç dëshmojnë rritje të ndërgjegjësimit, një kuadër të përmirësuar institucional dhe një bashkëpunim më të zhdërvjellët midis institucioneve të zbatimit të ligjit.
- Janë krijuar kushte për një administratë publike më transparente dhe të përgjegjshme, nëpërmjet ofrimit të disa shërbimeve publike online dhe masave ndërgjegjësuese në disa sektorë.

Për periudhën në vijim, Komisioni European rekomandon për luftën kundër korrupsionit:

- Monitorimi i korrupsionit në pushtetin lokal;
- Një vlerësim i përgjithshëm i rolit dhe veprimit të institucioneve të luftës kundër korrupsionit, për të forcuar më tej kuadrin e përgjithshëm institucional.
- Krijimi i një koordinatori kombëtar me mandat të fuqishëm, për vlerësimin dhe përmirësimin e kuadrit të përgjithshëm si më lart.
- Përmirësim i bashkëpunimit me institucionet e pavarura të kontrollit si KLSH.
- Pas kufizimit të imunitetit për zyrtarët e lartë dhe gjyqtarët, nevojiten masa për të qartësuar procedurat e hetimeve.
- Sfidë afat-shkurtër është forcimi i hetimeve pro-aktive, bazuar në një vlerësim sistematik të rrezikut – parakusht për ndërtimin e një track record për dënimin e korrupsionit në të gjitha nivelet, veçanërisht në ato fusha ku për korrupsionin ka një perceptim të fortë publik.

Po ashtu, Komisioni European, në vlerësimin e përgjithshëm për **luftën kundër krimit të organizuar**, shprehet se: *Ka pasur progres përsa i përket luftës kundër krimit të organizuar, që është një nga prioritetet e Opinionit*. Progres evidentohet në:

- miratimin e strategjisë dhe planit të ri të veprimit mbi luftën kundër krimit të organizuar;
- forcimit të bashkëpunimit policor ndërkombëtar;
- rritjes së numrit të hetimeve të aseteve, konfiskimeve (të drogave veçanërisht) dhe çështjeve të dërguara në gjykatë, analiza e riskut dhe përdorimi i shërbimit të inteligjencës kriminale;
- forcimit të sistemit për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- adresimit në mënyrë të përshtatshme të rekomandimeve të Moneyval për pastrimin parave;
- bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë policisë dhe gjyqësorit;
- krijimi i një njësie policore për krimin kibernetik;

- trajnimet e përbashkëta polici-prokurori për sekuestrimin e aseteve dhe krimin kibernetik.
- amendimi i Kodit penal, i cili ka adresuar çështjen e trafikimit të brendshëm të qenieve njerëzore dhe penalizmin e përdorimit të shërbimit të viktimave.

Megjithatë raporti vlerëson se krimi i organizuar mbetet një problem serioz dhe përpjekje të mëtejshme domethënëse nevojiten për të përmirësuar rezultatet në këtë fushë. Komisioni European adreson në raportin e tij:

- ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale që presin ende të miratohen;
- rritja e numrit të konfiskimeve të aseteve kriminale dhe dënimeve për pastrim parash, i cili vlerësohet se është i ulët;
- rritja thelbësore e hetimeve pro-aktive për pasuritë e vendosura nga aktiviteti kriminal jashtë shtetit dhe të ri-investuara në Shqipëri;

Raporti vlerëson se Shqipëria mbetet një vend burimi për trafikimin e të miturve dhe të rriturve, duke përfshirë dhe lypjen e fëmijëve. Kjo çështje kërkon koordinim më të mirë ndërmjet agjencive ligj-zbatuese dhe shërbimeve sociale.

Duke qëndruar në vlerësimet e Komisionit European për Shqipërinë, veçohet edhe Letra që Komisioneri European për Zgjerimin u dërgon vendeve anëtare të Bashkimit European pak ditë para mbledhjes së Dhjetorit 2013 për diskutimin e çështjes së statusit kandidat të Shqipërisë. Në argumentat pro-dhënies së statusit kandidat për Shqipërinë, Komisioneri për Zgjerim, ndër të tjera përmend edhe rolin e organit të Prokurorisë. Në mënyrë të përmbledhur, ky vlerësim përmendet në:

- Bashkëpunimin e autoriteteve shqiptare, përfshirë Prokurorinë, në disa aksione të përbashkëta të drejtuara nga EURO-POL për shkatërrimin e disa bandave kriminale
- Shtimin e rasteve të ekstradimit.
- Nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi; Prokurori e Përgjithshme-Ministri e Brendshme-SHISH.
- Dërgimin para gjykatës të një drejtuesit të lartë lokal në një qytet të rëndësishëm shqiptar.

REKOMANDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Bazë e rëndësishme në aktivitetin institucional të organit të Prokurorisë janë Rekomandimet e Këshillit të Ministrave, të përcjella nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Gjatë vitit 2013, prokuroria është mbështetur në këto rekomandime, të cilat në vija të përgjithshme përkojnë me rekomandimet e Komisionit European dhe me prioritetet e prezantuara nga Prokurori i Përgjithshëm. Në mënyrë të përmbledhur, rekomandimet e prezantuara janë:

- *Forcimi i shtetit të së drejtës;*
- *Forcimi i luftës kundër korrupsionit;*
- *Forcimi i luftës kundër krimin të organizuar;*
- *Respektimi i të drejtave të njeriut;*
- *Zbatimin e Strategjive Ndërsektoriale të “Luftës kundër krimin të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit”, si edhe Dokumentit Strategjik Kombëtar “Për Hetimin e Krimin Financiar”,*

PRIORITETET, VITI 2013

Bazuar në detyrimet kushtetuese dhe ligjore, si edhe në rekomandimet e Progres-Raportit të Komisionit Europian dhe Këshillit të Ministrave, organi i Prokurorisë ka përcaktuar prioritetet e tij. Peshën kryesore e kanë aktiviteti në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Në këtë drejtim, rëndësi e veçantë i është dhënë bashkëpunimit me institucionet e tjera vendase, si edhe me agjencitë homologe e partnerët ndërkombëtarë.

Prioriteti-Lufta kundër korrupsionit

Në kuadër të marrëveshjes së disa institucioneve për funksionimin e Njësive të Përbashkëta Hetimore, organi i prokurorisë ka luajtur rolin e tij koordinues dhe efektet e bashkëpunimit kanë prodhuar rezultate konkrete.

Konstatohet se ekziston frymë pozitive bashkëpunuese në rritje ndërmjet institucioneve. Kjo është shoqëruar me vendosjen para përgjegjësisë ligjore të zyrtarëve të niveleve të ndryshme për

Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore	Kryesisht	Pol.Shtetit	KLSH	ILDKP	FIU	SHISH	D.P.T	D.P.D	Të tjera	Kallëzime	Totali	Mosfillime	Vazhdon verifikimi	Regjistruar procedimi	TOTALI
	40	654	25	0	9	9	35	49	214	652	1687	437	178	1052	1669

korruption dhe shpërdorim me detyrën.

Krahas bashkëpunimit me Policinë e Shtetit, e vlerësojmë të domosdoshme të theksojmë koordinimin me institucione të tjera, si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Ministrinë e Financave (administratën tatimore dhe doganore), etj. Falë këtij bashkëpunimit, disa zyrtarë janë marrë nën përgjegjësinë ligjore, ndërkohë që procesi hetimor për raste të tjera është në zhvillim. Më poshtë paraqiten të dhënat konkrete të referimeve nga ana e institucioneve, pjesë e Njësive të Përbashkëta Hetimore, për vitin 2013.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Shërbimin Informativ Shtetëror është hartuar një platformë e përbashkët për realizimin e hetimeve proaktive. Në këtë kuadër, tre institucionet nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi dhe vlerësojmë se është një hap shumë i rëndësishëm për të dëshmuar vullnetin e përbashkët në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, organi i prokurorisë rezervon opinionin pozitiv edhe mbi qëndrimin e faktorit politik parlamentar lidhur me aktivitetin e prokurorisë.

Për prokurorinë, është për t'u vlerësuar fakti se faktori politik shqiptar po dëshmon gjithnjë e më shumë vullnet për të mbështetur aktivitetin e institucionit në luftën kundër korrupsionit.

Nga ana tjetër, ajo për të cilën prokuroria është e angazhuar dhe po e realizon është fakti se hetimet për rastet korruptive po zhvillohen dhe po paraqiten në gjykatë në një kohë shumë të shpejtë dhe me prova të plota. Në këtë mënyrë, pra nëpërmjet veprimeve të shpejta, synohet të arrihet goditja efektive dhe të forcohet besimi i publikut tek institucionet e zbatimit të ligjit. Prokuroria vijon të punojë në drejtim të forcimit të perceptimit të barazisë para ligjit të të gjithë qytetarëve, pavarësisht pozicionit në jetën publike.

Njësiti e Përbashkëta Hetimore

Gjatë këtij viti është vazhduar aktiviteti në drejtim të forcimit dhe konsolidimit të Njësive të Përbashkëta Hetimore, si struktura të specializuara për ushtrimin e ndjekjes penale, në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik, pastrimit të parave dhe krimit kibernetik.

Prokuroria e Përgjithshme ka mbështetur me përparësi me mjete financiare dhe administrative këto struktura, brenda mundësive që i lejon buxheti i institucionit. Janë kryer trajnime të shumta të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Njësive të Përbashkëta Hetimore, duke shfrytëzuar kapacitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, Policisë së Shtetit, si dhe projekteve të financuar nga donatorë të huaj (MCC dhe OPDAT të financuara nga qeveria e SHBA, si dhe PACA dhe Projekti i Binjakëzimit me qeverinë spanjolle të financuara nga Komisioni Europian. Ndërkohë ka filluar implementimi i projektit PACA IV në të cilën janë parashikuar një numër i konsiderueshëm trajnimesh dhe shkëmbimi përvoje me ekspertë të huaj dhe vendas).

Duhet vlerësuar sidomos puna e mirë që prokurorët e Njësive të Përbashkëta Hetimore kanë bërë në kuadër të hetimit të veprës penale të pastrimit të parave, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Si rezultat i kësaj pune të mirë të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe kordinimit me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit është arritur që të përmirësohen ndjeshëm treguesit e ndjekjes penale për këtë vepër. Është arritur që të vendoset dhe sekuestro procedurale në shuma të mëdha.

Një risi gjatë vitit 2013 ka qenë fillimi i hetimeve dhe dërgimi për gjykim i çështjeve me të akuzuar Personin Juridik.


Krimi kibernetik

Nisur nga rrezikshmëria që paraqet dhe nevoja për një hetim profesional, është gjykuar që fusha e Krimit Kibernetik të fuqizohet dhe të jetë një sektor më vete, i cili do të ushtrojë ndjekjen penale dhe përfaqësimin në gjyq të veprave që lidhen me këtë veprimtari të paligjshme. Me vendosjen e luftës ndaj fenomenit të Krimit Kibernetik (krimi kompjuterik) një ndër prioritetet e punës së prokurorisë, synohet parandalimi dhe goditja e autorëve të veprave penale, të cilët me veprimet e tyre të paligjshme sjellin pasoja të mëdha dhe paraqesin një rrezik të lartë për shoqërinë dhe sistemet e mbrojtura kompjuterike shtetërore dhe publike.

Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 22 % të numrit të procedimeve të regjistruara për Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik në krahasim me vitin 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



Përsa i përket hetimeve për akte korruptive në fushën e drejtësisë, prokuroria vlerëson se, krahas ndryshimeve kushtetuese mbi imunitetin, një ndikim të madh rreth hetimit të gjyqtarëve pritet të japin edhe amendimet e parashikuara për Kodin e Procedurës Penale.

Transparenca

Në kuadër të strategjisë antikorrupsion brenda radhëve të institucionit, organi i prokurorisë ka ndërmarrë nisma konkrete për realizimin e transparencës. Është aktivizuar një adresë on-line për denoncimin e rasteve të dyshuara si abuzive gjatë aktivitetit të prokurorëve (denonco@pp.gov.al). Në këtë mënyrë, qytetarët kanë mundësi për t'i adresuar Prokurorit të Përgjithshëm problematikën me të cilën ndeshen gjatë përbaljes me organin e prokurorisë.

Gjithashtu, është vendosur një standart i ri për publikimin e propozimeve të Këshillit të Prokurorisë për emërimet dhe transferimet e prokurorëve. Gjatë këtij viti, publiku dhe çdo i interesuar është vënë në dijeni të kandidaturave të propozuara nga Këshilli i Prokurorisë dhe mbi vendimmarrjen përfundimtare të Prokurorit të Përgjithshëm. Kjo iniciativë është ndërmarrë me qëllimin për të realizuar një transparencë sa më maksimale në vendimmarrjen e strukturave drejtuese të organit të prokurorisë.

Nga ana tjetër, është forcuar roli i Këshillit të Prokurorisë, në dy drejtime të rëndësishme:

- Së pari, duke filluar nga viti 2013, Këshilli i Prokurorisë ka nisur procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve. Ky proces zhvillohet për herë të parë dhe do të vijojë të jetë periodik çdo vit.

- Së dyti, janë krijuar kushtet që, gjatë procesit të rekrutimit, emërimit, transferimit dhe shkarkimit të prokurorëve, Këshilli i Prokurorisë, krahas shqyrtimit të anës dokumentare, do të ketë mundësi të marrë edhe opinionin verbal të kandidatëve apo të prokurorëve të propozuar për masa disiplinore. Këtë ndërmarrje e konsiderojmë një risi të rëndësishme në punën e Këshillit të Prokurorisë, pasi këtij organizmi i shtohen aftësitë për një vendimmarrje më të qartë dhe të plotë lidhur me rekrutimin apo procedimin disiplinor të prokurorëve.

Po ashtu, në vitin 2013 është ridimensionuar struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme për përpunimin e të dhënave statistikore dhe po punohet me Policinë e Shtetit dhe gjykatat e niveleve të ndryshme për të koordinuar shifrat e procedimeve penale dhe vendimeve të formës së prerë. Përpunimi i të dhënave do të shtrihet gjatë vitit 2014 edhe me institucionet e tjera

ligjzbatuese, të cilat kanë detyrimin ligjor të referojnë raste të dyshuara si vepra penale në organin e prokurorisë.

Rëndësi e posaçme, në kuadër të transparencës institucionale, i është kushtuar raporteve me publikun, median dhe shoqërinë civile.

Nëpërmjet riorganizimit strukturor, është përmirësuar ndjeshëm komunikimi me publikun. Ankimet dhe kërkesat e qytetarëve drejtuar organit të prokurorisë shqyrtohen në një kohë shumë të shpejtë, si edhe orientohen kërkuesit për rrugën e mëtejshme që duhet të ndjekin në rastet kur objekti i kërkesës nuk është në kompetencë të institucionit për shqyrtim.

Po ashtu, janë ridimensionuar raportet me median. Është riaktivizuar urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm i vitit 2005 për publikimin e të dhënave të punës së prokurorisë. Komunikimi me median kryhet në mënyrë të plotë dhe të menjëhershme për të gjithë mediumet nga zyra përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme. Kjo formë veprimtarie ka disiplinuar dhënien e informacionit, si edhe ka krijuar lehtësitë e nevojshme për marrjen e informacionit nga ana e organeve mediatike në mënyrë të padiferencuar.


Komunikimi me organizata të shoqërisë civile është forcuar ndjeshëm gjatë vitit 2013. Prokurorë dhe staf mbështetës në Prokurorinë e Përgjithshme janë angazhuar në aktivitete të ideuara nga shoqatat joqeveritare. Po ashtu, është përmirësuar ndjeshëm dhënia e informacionit për organizmat që monitorojnë forcimin e shtetit ligjor në Shqipëri.

Prioriteti- Lufta kundër krimit të organizuar


Organi i Prokurorisë ka vijuar të jetë i angazhuar maksimalisht në luftën kundër krimit të organizuar.

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 4,2 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafikëve të paligjshme në krahasim me vitin 2012. **Ndërkaq kemi rritje prej 68 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012.** Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, është regjistruar 1 i pandehur më shumë se në vitin 2012, kemi një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 54 % dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 51 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale të trafikëve për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



Numri i procedimeve të regjistruara për trafikim të qënieve njerëzore, pati të njëjtin trend me 2012, me një rritje të vogël (nga 36 në 41 raste). Tendenca e kriminalitetit të hetuar për krime të kryera nga organizata ose grupe të strukturuar mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2012.



Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, nga ana e Prokurorisë (posaçërisht Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda) është zhvilluar aktiviteti si më poshtë:

Hetimet pasurore

Gjatë vitit 2013 është punuar për verifikimin e 272 referimeve për hetim pasuror, nga të cilat 152 të mbartura nga vitet e kaluara dhe 120 të regjistruara rishtazi. Për 11 materiale është vendosur mosfillimi i procedimit, kurse për 16 materiale referues është vendosur regjistrimi i procedimit pasuror. Janë paraqitur 3 kërkesa për sekuestrim. Për njëjërën prej tyre gjykata e apelit ka vendosur revokimin e sekuestro. Janë paraqitur 6 kërkesa për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, nga të cilat 3 janë pranuar (plotësisht ose pjesërisht), kurse për të tjerat është pushuar gjykimi.

Trafiku i narkotikëve

Nga sa konstatohet edhe nga grafiku, numri më i lartë i çështjeve (269 procedime penale) janë për veprën penale të parashikuar në nenin 283/a i Kodit Penal (“Trafiku i lëndëve narkotike”). Konstatohet rritje e ndjeshme e referimeve për këtë veprë penale, kjo falë edhe rritjes së numrit të arrestimeve të kryera në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Policisë së Shtetit.

Konstatohet se, pavarësisht rritjes së ndjeshme të sasive me lëndë narkotike të sekuestruara gjatë vitit 2013, pjesa më e madhe është bllokuar në flagrancë në pikat e kalimit kufitar. Për të shmangur problematikën e hasur, si edhe për të rritur efikasitetin në luftën kundër trafikut të lëndëve narkotike, prej fundit të vitit 2013 është hartuar një strategji e përbashkët ndërmjet institucioneve ligjzbatuese, përfshirë edhe ato të inteligjencës, për të faktuar, nëpërmjet hetimeve proaktive, përgjegjësini penale të personave që drejtojnë dhe organizojnë këtë veprimtari të paligjshme. Kjo strategji përfshin, ndër të tjera, evidentimin dhe bllokimin e kultivimit të lëndëve narkotike në disa zona të Shqipërisë.

Gjithësesi, vlerësohet se sfida kundër trafikut të lëndëve narkotike është ende e hapur. Në pjesën më të madhe të rasteve, personat e ndaluar dhe arrestuar janë transportues të lëndëve narkotike. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në hetimet pasurore, pasi subjektet e hetuar, më së shumti korrierë, shpesh rezultojnë pa prona, llogari bankare dhe pa veprimtari biznesi.

Sa më poshtë është tabela e hetimeve proaktive në lidhje me korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e rënda:

Grup-Veprat Penale ne lidhje me korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e rënda	Neni 222 i K.Pr.Penale	Neni 294/a i K.Pr.Penale	Neni 294/b i K.Pr.Penale	Hetime Proaktive
Neni 245/1	3	2	0	5
Neni 248	10	15	0	21
Neni 256	1	1	0	2
Neni 259	40	11	0	31
Neni 319/ç	0	3	0	3
Neni 164/b	0	1	0	1
Neni 109	5	0	0	0
Neni 109/b	34	0	0	0
Neni 110/1	5	0	0	0
Neni 114/b	5	0	0	0
Neni 128/b	3	0	0	0
Neni 138/a	2	0	0	0
Neni 141/a	1	0	0	0
Neni 278/a	3	0	0	0
Neni 283	56	2	1	16
Neni 283/a	74	0	0	10
Neni 287	1	2	0	3
Konfis. 287	0	0	0	2
Neni 230	3	0	0	0
Neni 232/a	1	0	0	0
Totali	247	37	1	94

Pastrimi i produkteve të veprave penale

Ushtrimi i ndjekjes penale ndaj autorëve që kryejnë veprën penale të “Pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ka vazhduar të jetë një prioritet i punës së prokurorisë edhe gjatë vitit 2013. Gjatë vitit 2013 ka vijuar puna për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha strukturave të zbatimit të ligjit që janë të angazhuara me parandalimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Një kontribut të çmuar në luftën kundër “Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit” ka dhënë edhe gjatë vitit 2013 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, etj. Janë organizuar trajnime, seminare, takime pune, analiza, shkëmbim eksperience, janë shkëmbyer informacione në mënyrë të vazhdueshme me agjensi ligjzbatuese brenda vendit dhe me autoritet gjyqësorë të huaja, me qëllim rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale ndaj kësaj veprë penale, me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Ndikim pozitiv ka dhënë implementimi në vitet paraardhëse i Projektit të Binjakëzimit në kuadër të përmirësimit të luftës kundër “Pastrimin e parave dhe Financimit të terrorizmit” me autoritetet spanjolle dhe bullgare, i financuar nga Komisioni Europian, i cili çmohet se është i nevojshëm për t’u ndjekur nga projekte të tjera në këtë drejtim. Vlen për t’u theksuar se, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe D.P.P.P., është duke u punuar për mundësinë e përfundimit të një projekti të ri me objekt “Përmirësimin e luftës kundër Parandalimit të Pastrimit të Parave në Shqipëri”.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjithashtu, gjatë vitit 2013 konstatohet shtimi i rasteve të bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me strukturat homologe të vendeve fqinje, të anëtarëve të Bashkimit Evropian, por edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Rezultatet pozitive kanë ndikuar në forcimin e imazhit të institucioneve shqiptare, duke shtuar në këtë mënyrë shkëmbimin e informacionit për shtetas shqiptarë ose të huaj, të përfshirë në trafikë të paligjshme.

Në aspektin e rritjes së bashkëpunimit juridiksional me autoritetet e huaja, vlen për tu përmendur rritja e numrit të kërkesave për ndihmë juridike me autoritetet e huaja, numrit të subjekteve të ekstraduar, si dhe rritje të konsiderueshme të kërkesave për transferimin e personave të dënuar, në frymën e marrëveshjeve të nënshkruara gjatë vitit 2013, midis Republikës së Shqipërisë e Britanisë së Madhe dhe midis Republikës së Shqipërisë e Kosovës.



Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, gjatë vitit 2013 janë realizuar disa operacione të rëndësishme ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe strukturave homologe, në goditjen e organizatave kriminale, në përbërje të të cilave ka pasur edhe shtetas shqiptarë që vepronin në

Shqipëri dhe në disa vende europiane. Mund të veçohen bashkëpunimet të koordinuara nga Euro-Just, si edhe komisionet rogatore me autoritetet e Italisë, Belgjikës, Britanisë së Madhe, etj. Duke e konsideruar krimin e organizuar si një sfidë që do të jetë e shtrirë në kohë, një pjesë e prokurorëve kanë qenë dhe vijnë të jenë aktivë në procese trajnuese, të organizuara nga partnerët ndërkombëtarë. Prokurorë të ndryshëm kanë marrë pjesë në një sërë takimesh rajonale dhe ndërkombëtare të zhvilluara me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, në kuadër të asistencës së vazhdueshme të Projekteve të Bashkimit European, për rritjen e kapaciteteve të organit të Prokurorisë, në luftën kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe korrupsionit.

Projekte me partnerët

Gjithashtu, një ndikim pozitiv në punën e Prokurorisë ka patur edhe Projekti Rajonal IPA 2010 “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”, si një Instrument i Bashkimit European, në kuadër të të cilit janë zhvilluar një sërë kurse trajnimi për prokurorët.

Për forcimin e luftës kundër trafikut ndërkombëtar do të ndihmojë edhe projekti PAMECA IV, e cila në fushën e veprimit ka tashmë objektiva konkrete në drejtim të asistencës për të forcuar kapacitetet dhe bashkëpunimin e Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit, në lidhje me hetimet për krimin e organizuar, krimet e rënda dhe korrupsionin.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar për luftën kundër krimit të organizuar, Prokuroria e Përgjithshme ka aktive disa pika kontakti me strukturat ndërkombëtare, konkretisht me EUROJUST, Njësia e Bashkëpunimit Gjyqësor të Bashkimit European; SEEPAG, Grupi i Këshillimit të Prokurorëve të Europës Juglindore; ILECU/SELECU, Njësia e Koordinimit Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit etj.

Prioriteti- Të drejtat e njeriut

Mbrojtja e të drejtave të njeriut është konsideruar si një ndër prioritetet e organit të prokurorisë gjatë vitit 2013. Në këtë drejtim janë marrë disa masa dhe janë realizuar nisma konkrete:

Mbrojtja e të drejtave për të miturit

Organi i prokurorisë ka treguar kujdesin e duhur në respektimin e të drejtave të të miturve në procesin penal, duke siguruar në çdo rast të mundshëm:

- Pjesëmarrjen e psikologut gjatë procedimeve penale ku përfshihen minorenë dhe ndihma mjeksore
- Aplikimin e alternativave të dënimit
- Shmangien e vonesave gjatë hetimeve paraprake dhe për sa është e mundur edhe gjatë gjykimit
- Fshtësia e informacionit dhe ndalimi i publikimit
- Kontrollit të ligjshmërisë dhe profesionalizmit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore, në mënyrë të posaçme atyre që lidhen me njoftimin e menjëhershëm të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjor të cilët duhet të jenë të pranishëm në të gjitha procedurat

Me qëllim marrjen e masave konkrete dhe të drejtpërdrejta në mbrojtjen e të drejtave të të miturve të përfshirë në procedime penale, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë Udhëzimin nr.03

prot, datë 25.11.2013 “Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar”, ku janë ritheksuar detyrimet ligjore, kërkohet vemendje dhe përgjegjshmëri më e lartë e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajtimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të çështjeve ku përfshihen të miturit.

Udhëzimi synon, përcaktimin e parimeve themelore për mbrojtjen e të drejtave të të miturit të pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar i veprës penale, të cilat duhet të respektohen gjatë procedimit penal.

Por ajo që mbetet shqetësuese është fakti, se aktualisht parashikimi ligjor mbi masat edukuese sipas nenit 46 të Kodit Penal, për vendosjen e një të mituri në një institucion edukimi është i pazbatueshëm për shkak të mungesës së institucioneve përkatëse. Ky është një shqetësim prezent, që është ngritur shpesh nga ana jonë dhe veçanërisht nga organizma joqeveritare dhe faktori ndërkombëtar.

Mbrojtja e të drejtave të personave të ndaluar/arrestuar.

Me ndryshimet e që janë bërë në Kodin Penal është përshtatur neni 86 i Kodit Penal me parimet dhe kërkesat e nenit 1 të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese.

Marrë shkas nga rekomandimet dhe shqetësimet e Komitetit të Kombeve të Bashkuara kundër Torturës, paraqitur në raportin e muajit Maj 2012, lidhur me rastet e raportuara të keqtrajtimit nga ana e policisë ndaj personave të ndaluar/arrestuar veçanërisht gjatë procesit të marrjes në pyetje apo qendrimit në ambientet e paraburgimit, Prokurori i Përgjithshme ka kërkuar nga trupa e prokurorëve të rretheve gjyqësore, një rol më aktiv në respektim të të drejtave të njeriut dhe konkretisht:

- Kur gjatë hetimeve paraprake apo gjatë gjykimit, pretendohet dhunë e ushtruar nga funksionarët publikë apo konstatohen shënja të dukshme dhune, prokurori duhet të marrë masat për kryerjen e verifikimeve të nevojshme dhe të iniciojë fillimin e procedimit penal.
- Të bëhet kujdes në kualifikimin e drejtë të veprave penale të parashikuar nga neni 86 “Tortura” dhe 250 “Veprime arbitrare” të Kodit Penal,
- Rritja e bashkëpunimit me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Policisë të Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, me qëllim evidentimin dhe hetimin e këtyre rasteve.

Në këtë kuadër synohet dhe rritja e bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim dokumentimin ligjor të veprës penale të torturës, parandalimin e ngjarjeve të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo të arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit, duke marrë masa për të mundësuar monitorimin me kamera të ambienteve ku mbahen dhe merren në pyetje të shoqëruarit, ndaluarit apo të arrestuarit.

Nga ana tjetër, Prokuroria Shqiptare ka intensifikuar dhe rritur bashkëpunimin me Avokatin e Popullit në cilësinë e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Mungesa e institucioneve të specializuara mjeksore

Organi i Prokurorisë në shumë raste është përballur me vështirësi në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që përmbajnë masa mjeksore të detyrueshme (neni 46 dhe 239 i Kodit Penal) duke qënë se aktualisht mungon një institucion i specializuar mjeksor sipas kërkesave të nenit 28 të ligji nr.44/2012 “Për shendetin mendor”.

Për këtë arsye, personat e papërgjegjshëm që kanë kryer vepra të ndryshme penale, ndaj të cilëve gjykata ka vendosur masë mjeksore “mjekim të detyruar” në një institucion mjeksor janë dërguar për ruajtje dhe trajtim mjeksor në spitalet e burgjeve. Për shkak të rrezikshmërisë shoqërore që paraqesin dhe nevojës për ruajtje në ambiente me kushte të posaçme sigurie dhe nga Policia e Shtetit, nuk garantohet ruajtja e tyre në spitalet psikiatrike.

Prokuroria e Përgjithshme e ka ngritur disa herë këtë problem pranë organeve më të lartë të administratës shtetërore si Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë me qëllim që t’i jepet një zgjidhje përfundimtare këtij problemi. Lidhur me këtë shqetësim, tashmë të bërë prezent edhe nga organizma joqeveritare kërkohet një bashkëpunim ndërinstytucional me qëllim gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejtë të këtij problemi.

Prioriteti-Forcimi i kapaciteteve institucionale

Me marrjen e mandatit, në muajin Dhjetor 2012, Prokurori i Përgjithshëm, prezantoi, ndër të tjera, nevojën për ristrukturimin e strukturës drejtuese të institucionit. Është vlerësuar se organi i prokurorisë, për rezultate më të larta në ndjekjen penale, kishte nevojë për “rifreskim dhe riorganizim”. Kjo, nisur nga fakti se disa prokurorë kishin vite në nivele drejtuese ose në të njëjtën prokurori, gjë që sjell vetëvetiu një familjaritet të tepruar me problematikën kriminale në një territor të caktuar. I gjithë procesi i transferimeve është realizuar në përputhje me ligjin organik dhe në transparencë të plotë.

Konkurimi dhe kontrolli i brendshëm

Procesi i konkurimit ka qenë i hapur dhe do të vijojë të jetë i tillë edhe në të ardhmen, duke aplikuar në këtë mënyrë një standart të ri transparence institucionale. Prokurorëve në të gjithë Shqipërinë u është bërë njoftim zyrtar për mundësinë e aplikimit për këto pozicione drejtuese.

Aplikimet janë shqyrtuar, sipas ligjit organit të Prokurorisë, fillimisht nga Këshilli i Prokurorisë, i cili ka paraqitur propozimet e tij tek titullari i institucionit. Në të gjitha rastet, propozimet e Këshillit të Prokurorisë janë pranuar nga Prokurori i Përgjithshëm, duke e cilësuar këtë edhe si një akt të vërtetë bashkëvendimmarrjeje.

Ndërkohë, është punuar në mënyrë rigorozë për forcimin e kontrollit të brendshëm, Funksion i rëndësishëm i punës së strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme ka qenë dhe mbetet kontrolli i brendshëm i prokurorive të shkallës së parë dhe atyre të apeleve me synim mbikqyrjen e ushtrimit të funksioneve prej tyre në zbatim të kushtetutës, ligjit dhe akteve normativë të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në përmbushje të këtij funksioni, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2013 kanë ushtruar kontrole të përgjithshme, të pjesshme, për grup çështjesh dhe për çështje të veçanta.

Janë ushtruar kontrole në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Dibër, Berat, Tiranë (per punën e prokurorëve të Task-Forcë) dhe prokuroritë e Apeleve Gjyqësore Korçë dhe Shkodër.

Në konkluzion të kontroleve, për shkeljet ligjore të evidentuara në aktet procedurale në hetimet paraprake të prokurorëve, rast pas rasti është vendosur shfuqizimi i tyre, si dhe është filluar procedimi disiplinor ndaj prokurorëve.

Më konkretisht kanë filluar procedime disiplinore për 5 prokurorë: në një rast është vendosur masa e uljes në detyrë, për 2 prokuror masa e vërejtje me paralajmërim dhe 2 prokuror janë në proces.

Sistemi i vlerësimit të prokurorëve

Gjithashtu, pas miratimit të rregulloreve për sistemin e vlerësimit nga Prokurori i Përgjithshëm, për herë të parë është bërë vlerësimin i punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve, për të përmirësuar dhe zhvilluar punën personale dhe organizative, duke inkurajuar një nivel më të lartë të motivimit dhe pjesëmarrjes më gjerësisht të prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre. Nga drejtuesit e prokurorisë të rretheve është bërë vlerësimi për rreth 280 prokurorë dhe 145 oficerë të policisë gjyqësore për aktivitetin e tyre gjatë vitit 2012. Gjatë vitit 2013 është mbaruar shqyrtimi nga ana e Këshillit të Prokurorisë i të gjithë vlerësimeve të prokurorëve.

Lidhur me procesin e vlerësimit, nisur nga fakti se zhvillohet për herë të parë dhe raportohet në Kuvendin e Shqipërisë si risi, duhen theksuar disa specifika:


- Vlerësimi përfshin periudhën kohore Janar-Dhjetor 2012.
- Në bazë të rregullores së posaçme për këtë proces, çdo prokuror dhe oficer i policisë gjyqësore vlerësohet nga ana e drejtuesit të prokurorisë. Më pas, ky vlerësim i nënshtrohet shqyrtimit nga ana e Këshillit të Prokurorisë. Rekomandimet e Këshillit të Prokurorisë për çdo prokuror vlerësohet nga Prokurori i Përgjithshëm.
- Duhet pranuar fakti se, duke qenë një proces që zhvillohet për herë të parë, ka hasur disa problematika teknike. Probleme teknike tashmë të tejkaluara dhe vlerësimi për punën e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2013 do të jetë një proces më i saktë dhe do të prezantohet niveli real i arritjeve të çdo punonjësi të ngarkuar me hetimin penal.

Vendimarrja e Prokurorisë së Përgjithshme

Në funksion të procesit të kontrollit të brendshëm, gjatë vitit 2013 është konstatuar rritja e angazhimit të Prokurorisë së Përgjithshme, në shqyrtimin e rasteve të mosfillimit dhe të pushimit nga ana e prokurorëve të strukturave më të ulta.

Gjatë vitit 2013 është ushtruar vendimmarrja nga Prokuroria e Përgjithshme në total për 61 çështje. Ky numër është shumë herë më i lartë se në vitin 2012, kur në total janë shqyrtuar nga kjo Drejtori vetëm 6 raste.

Në vitin 2013, janë shfuqizuar nga Prokuroria e Përgjithshme 47 vendime të pushimit/pezullimit nga ana e prokurorisë të shkallëve më të ulta. Po ashtu, janë shfuqizuar 4 vendime mosfillimi, ndërkohë që është marrë vendimi për mospranim ankimi në 10 raste, ndërkohë që janë marrë 58 vendime për zgjidhje të konfliktit të kompetencës tokësore/lëndore.

Vendimarrjet e Prokurorisë së Përgjithshme

Aktivizimi i shtuar i Prokurorisë së Përgjithshme në kontrollin e dosjeve të prokurorive të shkallëve më të ulta ka ndikuar në rritjen e cilësisë së hetimit në strukturat e varësisë. Këto vendime i bashkohen dosjes personale të prokurorëve dhe shërben për vlerësimin sa më të saktë të punës së prokurorëve. Ndryshimet e vendimeve të prokurorëve në shkallët më të ulta nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme i kalohen për dijeni edhe Drejtorisë së Inspektimit, e cila përgatit relacionin për vlerësimin vjetor të punës së prokurorëve, apo dhe inicimin e procedimeve disiplinore në raste kur të njëjtët prokurorë nuk reagojnë ndaj vendimarrjes së Prokurorit të Përgjithshëm, apo kur i shfuqizohen disa vendime brenda një viti.

Trajnimet e prokurorëve

Forcimi i kapaciteteve në prokurori ka qenë dhe mbetet një nga objektivat e punës sonë me synim rritjen e aftësive profesionale dhe profilizimin e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës për të rritur efektivitetin në ushtrimin e funksioneve ligjore.

Në mënyrë të veçantë ky proces është fokusuar në trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore pjesëtarë të njësisë të përbashkëta hetimore duke shfrytëzuar maksimalisht mbështetjen dhe asistencën e dhënë nga OPDAT-i për këtë qëllim. Tematika e këtyre trajnimeve ka qenë fokusuar në përdorimin e metodave të specializuara të hetimit të krimit financiar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, nëpërmjet këtyre trajnimeve është tentuar të bëhet një trajtim teorik i dispozitave të reja në Kodin Penal, i harmonizuar me diskutimin e rasteve konkrete praktike. Këto trajnime të zhvilluara brënda dhe jashtë vendit, kanë rezultuar të efektshme edhe për shkak të përcjelljes së praktikave më të mira të vendeve me një eksperiencë të gjatë dhe të konsoliduar në drejtim të luftës kundër këtij lloji kriminaliteti.

Në proces të vazhdueshëm trajnimi, të zhvilluara kryesisht jashtë vendit, kanë qenë edhe prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë për Krime të Rënda. Këto trajnime janë fokusuar kryesisht në diskutimin e problematikave që lidhen me goditjen e krimit të organizuar, terrorizmit dhe hetimit të aseteve kriminale.

Në proces trajnimi kanë qenë të gjithë prokurorët në kuadër të trajnimit vazhdueshëm të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, tematika e të cilës ka qenë e zgjedhur nga vetë prokurorët. Gjithashtu Bordi i Organizimit të Trajnimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, me qëllim unifikimin e interpretimit dhe zbatimit nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të ndryshimeve të kryera në ligjin penal, ka organizuar trajnime, mbi shtesat dhe ndryshimet e ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, me ligjet 23/2012 dhe 114 /2013.

Nisur nga domosdoshmëria, si edhe nga rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë, organi i prokurorisë është orientuar dhe janë zhvilluar trajnime të përbashkëta me prokurorët dhe shërbimet e policisë gjyqësore të policisë së shtetit. Me qëllim përmirësimit dhe shpalosjen e politikave të përbashkëta gjatë zhvillimit të këtyre trajnimeve, është finalizuar së fundmi një udhëzim i përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrin e Brendshëm. Në vitin 2013 janë trajnuar 50 oficerë të policisë gjyqësore në tema si “Manifestimet e Krimit Kibernetik, sulmet kundër sistemeve kompjuterike të bankave me qëllim përfitimi”; “Identifikimi i viktimave të trafikimit nëpërmjet procesit të intervistimit”, etj.

Amendimi i ligjit të prokurorisë

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale, duke patur synim rritjen e kërkesave të vazhdueshme për arritjen e standarteve më të mira në aktivitetin institucional, performancën dhe efektivitetin në punën e prokurorëve, apo përmirësime në organizimin dhe funksionimin e organit të Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë disa propozime për amendim të ligjit organik të Prokurorisë. Me këtë projekt synohet të arrihet një standart më i lartë në aktivitetin institucional, garanci më të mëdha në procesin e punës të prokurorisë, në pavarësinë, performancën dhe efektivitetin në punën e prokurorëve dhe përmbushjen me sukses të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të organit të Prokurorisë.

Sistemi i Menaxhimit të Rasteve

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale, në të gjithë strukturën e Prokurorisë po përfundon infrastruktura logjistike dhe elektronike për Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (*Case Management*). Ky projekt, i cili konsiderohet si një ndër rrisitë kryesore të aktivitetit të institucionit në vitet e fundit, synon përmirësimin e infrastrukturës elektronike të prokurorive.

Projekti Menaxhimi i Rasteve (*Case Management*) për Prokurorinë Shqiptare është një projekt i financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian i ndarë në dy faza:

Faza e parë përfshin ndërtimin e infrastrukturës informatike të Prokurorisë Shqiptare të centralizuar në datacenter të Prokurorisë së Përgjithshme.

Implementimi i kësaj faze ka filluar në 15 Shkurt 2013 dhe është përfunduar në Tetor 2013. Gjatë kësaj periudhe janë instaluar pajisjet teknologjike, të ardhura në kuadër të projektit dhe të shpërndara sipas nevojave të prokurorive të të gjitha niveleve.

Në kuadër të Implementimit të Infrastrukturës Informatike të institucionit të Prokurorisë Shqiptare, Projekti Menaxhimi i Rasteve parashikon trajnim për stafin e IT-së mbi pajisjet Informatike të implementura për menaxhimin e tyre.

Pas përfundimit të infrastrukturës informatike që po implementohet në kuadër të Projektit Menaxhimi i Rasteve, ka filluar kodimi i programit, i cili parashikon dixhitalizimin e proceseve të punës të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore në prokuroritë e të gjitha niveleve.

Implementimi i këtij sistemi përmirëson ndjeshëm teknikën e punës në Prokurori, si edhe krijon mundësitë e komunikimit në kohë reale me Policinë e Shtetit dhe me institucione të tjera për hetimin e çështjeve të referuara. Ndër rrisitë e Sistemit të Menaxhimit të Rasteve (SMR), i cili fillon aplikimin pilot në Qershor 2014, janë si më poshtë:

1. Gjenerimi i statistikave në kohë reale. Nëpërmjet Sistemit, Prokuroria ka mundësitë që të përfitojë të dhëna për situatën e procedimeve penale në çdo kohë. Kjo është një arritje e rëndësishme për punën e institucionit, si edhe pjesë e përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Europian për krijimin e bazës së të dhënave (*track records*).
2. Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Rasteve realizohet koordinimi në kohë reale me Policinë e Shtetit që në momentin e referimit dhe më tej në fazat e tjera të hetimit. Çdo referim nga ana e Policisë së Shtetit në çdo prokurori të Shqipërisë do të marrë një numër UNIK të çështjes (ashtu si edhe çdo referim nga institucionet e tjera). Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në këtë mënyrë, do të kenë mundësi që të kryejnë të gjitha veprimet procedurale për secilin hetim në formë elektronike dhe në të njëjtim sistem.
3. Sistemi i Menaxhimit të Rasteve forcon në mënyrë të ndjeshme kontrollin e brendshëm në organin e Prokurorisë. Zyra përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, nëpërmjet të dhënave që gjenden në këtë sistem, do të ketë mundësinë që të kontrollojë efikasitetin


dhe shpejtësinë e veprimeve hetimore nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

VITI 2013, ANGAZHIME TË RËNDËSISHME

Në tërësinë e veprave penale të regjistruara gjatë vitit 2013, organi i Prokurorisë është fokusuar në mënyrë të veçantë në disa çështje specifike, të cilat kanë pasur impakt dhe vëmendje të përqëndruar në hetimin e tyre.

Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje

“Krime kundër jetës të kryera me dashje” përbën një nga grupet e veprave penale që kërkojnë vëmendje maksimale, pasi lidhen drejtpërdrejtë me sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 9,6 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash në krahasim me vitin 2012.



Gjithësesi, duhet theksuar se gjatë vitit 2013, në krahasim me vitin 2012, ka një ulje të procedimeve penale në dy prej veprave penale më të rëndësishme, të përfshirë në këtë grup;

- “Vrasje me dashje”- ulje 38 %
- “Vrasje në rrethana cilësuese”- ulje 6 %

Ndërkohë, vërehet një rritje me 6% të procedimeve penale për veprën “vrasje me paramendim”. Në këtë grup-veprash, prokuroria veçon “vrasjen për gjakmarrje” (neni 78/a) dhe “kanosjen për gjakmarrje” (neni 83/a) për specifikën e tyre, si edhe për impaktin negativ që përcjellin në zonat e Shqipërisë ku janë më të përhapura krime të kësaj natyre.

Gjakmarrja

Me amendimet e Kodit Penal në vitin 2013, kompetencë për gjykimin e “vrasjes për gjakmarrje” është Gjykata e Krimeve të Rënda. Prokuroria pranë kësaj gjykate, pas ndryshimeve ligjore, ka regjistruar gjatë vitit 2013 vetëm 2 procedime lidhur me këtë veprë.

Ndërkohë, për veprën penale “kanosje për gjakmarrje”, numri i procedimeve penale është rritur në vlera të vogla, të papërfillshme me realitetin e ngujimit, që lidhet ngushtë me këtë veprë penale.

Në kuadër të goditjes së fenomenit që sjell ngujimin, organi i Prokurorisë ka ndërmarrë nisma konkrete. Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe përfaqësues të komuniteteve fetare në Shkodër, zhvilloi një takim në Dhjetor 2013 lidhur me mundësitë për zbutjen e efekteve të kanosjes për gjakmarrje. Në vijim të këtij takimi, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër është hartuar një plan konkret për evidentimin dhe më pas regjistrimin e procedimeve penale për veprën penale të “kanosjes për gjakmarrje”. Në bazë të këtij plani, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit dhe drejtuesit vendorë, kanë nisur të kontaktojnë me familjet e ngujuara për të regjistruar procedimet penale dhe për të vijuar më tej hetiet lidhur me personat përgjegjës në formën procedurale të kërkuar nga ligji. Pavarësisht se rezultatet për këtë proces do të përfshihen në raportin vjetor për vitin 2014, deri më tani vlerësohet se ky angazhim ka dhënë rezultatet e para konkrete.


Krimet në familje

Problematikë për këtë grup vijon të jetë vepra e parashikuar nga nenin 79/c i Kodit Penal “vrasje për shkak të lidhjeve familjare”. Me amendimet e Kodit Penal të vitit 2013, kjo veprë penale është kompetencë gjykimi e Gjykatës për Krime të Rënda. Ligjvënësi e vlerësoi të tillë, nisur nga qëllimi për parandalimin e kësaj vepre penale, si edhe forcimi i politikës penale për t’i krijuar një mbrojtje të posaçme institutit të Familjes. Nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda, për të gjitha rastet që ka përfunduar hetimi, është kërkuar dënimi maksimal për krimet në familje. Kjo kërkesë do të vijojë të jetë permanente edhe për çështjet që janë në hetim dhe gjykim.


Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes

Gjatë vitit 2013 konstatohet angazhim specifik i organeve të drejtësisë lidhur me evidentimin, hetimin dhe dënimin e “veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”. Gjithashtu, konstatohet rritje e ndjeshme e rasteve të referuara lidhur me këto vepra. Në vlerësimin e organit të Prokurorisë, kjo rritje është rrjedhojë e forcimit të besimit të publikut tek institucionet. Nga hetimet e pjesës më të madhe të rasteve, rezulton se viktimat kanë qenë në ushtrimin e dhunës për një kohë të gjatë dhe janë ndërgjegjësuar për raportimin e këtyre rasteve pranë organeve shtetërore. Gjithashtu, vlerësojmë se një rol pozitiv në shtimin e kallëzimeve për këtë veprë penale ka dhënë edhe media. Seria e gjatë e emisioneve dhe kronikave sensibilizuese lidhur me këtë temë ka ndikuar në bindjen e qytetarëve, viktimat të dhunës, të kërkojnë mbrojtjen e institucioneve shtetërore.

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 154 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi rritje prej 279 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 218 %, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur me 263 % dhe ka rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 431 % përkundrejt vitit 2012.



Një vend të veçantë në grupin e “veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” zë “dhuna në familje”. Vihet re se në vitin 2013 janë regjistruar 826 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”, ndërkohë që në vitin 2012 ky numër ka qenë 328. Janë dërguar për gjykim 589 procedime penale nga ana e organit të prokurorisë në vitin 2013, në vitin 2012 ky tregues ka qenë 159, janë regjistruar 791 të pandehur dhe është ngritur akuza në gjykatë për 606 të pandehur, ndërkohë që për vitin 2012 janë regjistruar 255 të pandehur dhe është ngritur akuzë për 171 të tillë, janë dënuar nga gjykata 405 të pandehur për vitin 2013 ndërsa në vitin 2012 janë dënuar 69 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”.



Keqtrajtimi i të miturve

Vepra penale e parashikuar nga neni 124/b paragrafi i dytë i Kodit Penal, detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij, mbetet ende një problem shqetësues për vendin tonë.

Gjatë vitit 2013, janë referuar 4 raste dhe janë regjistruar të gjitha si procedime penale për veprën penale të parashikuar në nenin **124/b, paragrafi i dytë i** Kodit Penal. Sipas qyteteve: 1 në Vlorë, 1 në Elbasan, 1 në Tiranë, 1 në Korçë. Faktikisht, numri i referimeve për këtë vepër penale është në shifra të ulta.

Nga aplikimi në praktikë i këtij neni, ka rezultuar një problematikë specifike. Në rastet e proceduara gjatë vitit 2013, por edhe në vitet e mëparshme, ka rezultuar se, të miturit janë detyruar për të lypur nga ana e prindërve ose familjarëve të tyre të afërt. Ndërkohë, që nuk ekzistojnë institucione të posaçme për të përfshirë në jetën sociale të miturit që janë të detyruar të lypin. Pra, nga aplikimi me burgim për prindërit e të miturve, sipas dispozitës, nuk zgjidhet e ardhmja e të miturve, të cilët përveç faktit që nuk mund të sigurohen në qendra të specializuara ku të strehohen (pasi nuk ekzistojnë), por mbeten për një periudhë kohë edhe pa prindër (deri sa të vuajnë dënimin). Pra, ekzistojnë sërish mundësitë dhe rreziku që këta të mitur, me probleme të theksuara ekonomike, të rikthehen sërish për të lypur, apo të përfshihen në veprimtari të tjera kriminale.

Nisur nga shifrat e ulta të referimeve dhe problematikës që u theksua më sipër, Prokurori i Përgjithshëm, ka iniciuar një koordinim me institucione të tjera, si Avokati i Popullit, Policia e Shtetit, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe organizmat joqeveritare që merren me respektimin e të drejtave të të miturve, për të krijuar mundësitë për sistemin e fëmijëve që janë të detyruar të lypin, krahas ndëshkimit penal të personave që detyrojnë të miturit të lypin. Gjithsesi, nga ana e saj, Prokuroria do të vijojë që të ndjekë penalisht sipas përcaktimeve ligjore çdo rast që lidhet me shkeljet e nenit 124/b, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Ndërtimi i paligjshëm

Ndër veprat që kanë pësuar rritjen më të madhe të procedimeve gjatë vitit 2013 vlerësohet “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar në nenin 199/a të Kodit Penal. Referuar statistikave, në vitin 2013 konstatohet rritje në shifrën 579%, krahasuar me vitin 2012.




Organi i Prokurorisë ka qenë veçanërisht i angazhuar në goditjen e fenomenit të ndërtimeve të paligjshme, të cilat kanë shtrirje të gjerë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, por me një përqendrim më të madh në zonën bregdetare të vendit. Në shtator të vitit 2013, Prokurori i Përgjithshëm shpërndau një qarkore të posaçme lidhur me hetimin e këtyre veprave. Ky dokument u vlerësua si domosdoshmëri, nisur nga fakti se vërehej ulje e ndjeshme e rasteve të

referuara në prokurori për këtë veprë nga ana e autoriteteve përgjegjëse për evidentimin dhe ndalimin e tyre.

Ndikim të rëndësishëm në shtimin e numrit të referimeve për këtë veprë penale kanë dhënë edhe angazhimi së fundi i strukturave të pushtetit ekzekutiv.


Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi

Gjatë vitit 2013 konstatohet rritje e ndjeshme në regjistrimin e procedimeve penale për veprën e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi”. Krahasuar me vitin 2012, në vitin 2013, janë regjistruar **353 %** procedime më shumë. Këtu vlen për t’u veçuar impenjimi i shtuar i strukturave të Policisë së Shtetit për referimin e këtyre shkeljeve ligjore. Nga ana e prokurorive të rretheve gjyqësore, referimet e strukturave policore për këtë veprë janë mbështetur, nisur nga fakti i rritjes së sigurisë rrugore në territorin e Republikës së Shqipërisë.



Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit

Rritje e konsiderueshme e procedimeve penale gjatë vitit 2013 konstatohet për veprat penale, parashikuar në nenin 197 dhe 198 të Kodit Penal, në seksionin “Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit”. Sikurse vihet re edhe nga tabela më poshtë, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2013 ka një rritje të madhe prej **197%** të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit, në krahasim me vitin 2012. Në rritjen e referimeve për këtë grup veprash ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtaria gjatë muajve të fundit të administratës tatimore, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.





Vjedhja e pasurisë

Nga të dhënat statistikore, rezulton se numri më i madh i procedimeve penale për vitin 2013 vijon të mbetet grupi i veprave penale “vjedhje e pasurisë”.

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike është 41,3 %, ndërsa në vitin 2012 ka qenë 42,03 %. Pra, gjithësesi, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 23 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë në krahasim me vitin 2012. Po ashtu, ka rritje të procedimeve penale për “vjedhja me dhunë” prej 43 % krahasuar me vitin 2012. Ndërkohë, është shënuar ulje në procedimet penale për “vjedhje me armë”, e cila shënon 22% më pak se një vit më parë dhe “vjedhja me pasojë vdekjen”, e cila ka ulje prej 75 % krahasuar me vitin 2012.



II. RAPORTET ME INSTITUCIONET KRYESORE

Organi i Prokurorisë ka zhvilluar raporte korrekte dhe pozitive me institucionet publike, të përfshira në forcimin e shtetit ligjor në Shqipëri dhe në luftën kundër kriminalitetit. Nga ana tjetër, vlerësohet se edhe institucionet e tjera kushtetuese dhe të krijuara me ligj kanë vepruar në mënyrë korrekte dhe bashkëpunuese me prokurorinë, gjë e cila ka ndikuar në forcimin e klimës positive ndërmjet agjencive kryesore të shtetit.

Raporti me Presidentin e Republikës

Në nenin 149, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se “Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit”. Krahas emërimit të titullarit të institucionit, institucioni i Presidentit të Republikës i ka dhënë mbështetje të plotë Prokurorisë së Përgjithshme në ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Gjatë vitit 2013, Presidenti i Republikës ka dekretuar disa propozime të Prokurorit të Përgjithshëm për transferime të drejtuesve të prokurorive të Rretheve Gjyqësore, të Prokurorive të Apelit, si edhe disa emërimet e prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme.

Raporti me Kuvendin e Shqipërisë

Marrëdhëniet ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme janë bazuar në korrektesë të ndërsjellë dhe bashkëpunim reciprok për forcimin e kuadrit ligjor përsa i përket luftës kundër korrupsionit dhe kriminalitetit. Organi i Prokurorisë ka qenë aktiv me opinione dhe ka vlerësuar pozitivisht amendimet e Kodit Penal, të cilat hynë në fuqi në muajin Qershor 2013. Gjithashtu, Prokuroria ka qenë dhe vijon të jetë pjesë aktive e diskutimeve në Kuvendin e Shqipërisë për amendimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Në kuadër të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, Prokuroria e Përgjithshme ka prezantuar opinionin e saj në Komisionit të Ligjeve lidhur me propozimet e përcjella nga Këshilli i Ministrave. Në mënyrë të përmbledhur, Prokuroria e Përgjithshme, në parim, shprehet dakord me ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Penal. Prokuroria vlerëson se është e domosdoshme rritja e vëmendjen ndaj korrupsionit, si një vepër penale që përbën problem serioz për shoqërinë dhe shtetin shqiptar.

Po ashtu, organi i Prokurorisë ndan të njëjtin qëndrim me relacionin që shoqëron projekt-ligjin, sipas të cilit “Korrupsioni, në të gjitha format e tij, shërben si ndihmë për krimin e organizuar duke qenë vepër penale shoqëruese e tyre”. Por, në vlerësimin e Prokurorisë kalimi i këtyre veprave nga një prokurori në një tjetër, nuk sjell detyrimisht ndryshime në mënyrën e hetimit apo gjykimin dhe as në llojin dhe masën e dënimit të autorit/ëve të këtyre veprave penale.

Duke i marrë në shqyrtim në mënyrë të detajuar propozimet në Kodin Penal, Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se vëmendja duhet të përqëndrohet në zbatimin e efektshëm të këtij legjislacioni, që normalisht mund të kërkojë dhe një rishikim më të zgjeruar të Kodit të Procedurës Penale. Në lidhje me shtimin e kompetencës së Gjykatës për Krime të Rënda, Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, çmobjmë se propozimi në opinionin tonë gjendet pjesërisht i mbështetur.

Organi i prokurorisë sugjeron që në kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda, të përfshiheshin veprat penale korruptive të kryera nga zyrtarë të lartë dhe ato të Gjyqtarit, Prokurori dhe funksionarëve të drejtësisë, kjo për shkak të riskut të lartë për korrupsion dhe rolin të tyre në vendimmarrje të rëndësishme për vendin, shoqërinë dhe qytetarët në tërësi”.

Për sa më sipër, Prokuroria shpreh mendimin se mund të jenë në kompetencën e Gjykatës për Krime të Rënda dhe rrjedhimisht edhe të Prokurorisë për Krime të Rënda, nenet 260, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal”, të cilat janë:

- “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë”,
- “Korrupsioni aktiv i Gjyqtarit, Prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”,
- “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare”,
- “Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj”,
- “Korrupsioni aktiv i anëtareve të jurive gjyqësore të huaja”,
- “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”,
- “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare”,
- “Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj”,
- “Korrupsioni pasiv i anëtareve të jurive gjyqësore të huaja”,

Ndërkohë që, për Prokurorinë, përfshirja e dispozitave të tjera të parashikuara në paketën e amendimeve në Kodin Penal, do të sillte probleme në zbatimin dhe hetimin e këtyre rasteve, duke ulur efektivitetin e goditjes së krimit”.

Duke u përqëndruar te kalimi i disa prej veprave penale në fushën e korrupsionit në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda, Prokuroria shpreh opinionin se kjo nismë duhet të shoqërohet me shtim të numrit të përgjithshëm të prokurorëve në këtë prokurori si dhe në të gjitha nivelet e Prokurorisë. Kjo për shkak të ngarkesës dhe rritjes së konsiderueshme të numrit të çështjeve vitet e fundit.

Ndërsa lidhur me ndryshimet në ligjin nr.10192 datë 3.12.2009, të njohur ndryshe si “ligji Antimafia”, Prokuroria vlerëson se janë të lidhura me ndryshimet e propozuara në Kodin e Procedurës Penale dhe nga sa u argumentua më sipër, vlerësojmë se këto ndryshime do të kenë të njëjtin efekt si ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale. Pra në parim, organi i Prokurorisë shpreh dakordësinë me përfshirjen në fushën e zbatimit të këtij ligji për veprat penale në fushën e korrupsionit, por ligji duhet të shoqërohet me ndryshime të tjera, si rrjedhojë e nevojës që ka lindur në praktikë.

Kuvendi i Shqipërisë ka mbështetur kërkesat financiare të paraqitura nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme. Për Buxhetin Vjetor të vitit 2013, po ashtu edhe për Buxhetin Vjetor të vitit 2014, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë janë pranuar si të bazuara parashikimet financiare dhe i është akorduar institucionit shuma e kërkuar nga organi i Prokurorisë. Kjo mbështetje ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e kushteve të punës dhe në shtimin e logjistikës institucionale.

Raporti me Këshillin e Ministrave

Gjatë vitit 2013, ka ofruar mbështetjen e plotë për organin e prokurorisë si në aspektin ligjor formal, ashtu edhe në atë financiar. Një vend të veçantë në marrëdhëniet ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Ministrave kanë raportet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Ministrinë e Brendshme.

- Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të parashikimeve ligjore janë të orientuara në disa drejtime, të cilat ndërtohen kryesisht në rekomandimet për prioritet e luftës kundër kriminalitetit, që Ministria i paraqet në prokurori në emër të Këshillit të Ministrave. Për vitin 2013, raportet me Ministrinë e Drejtësisë janë ndërtuar mbi baza ligjshmërie dhe bashkëpunimi institucional, si më poshtë:

Në inspektimet që Ministria e Drejtësisë ka kryer në institucionin e prokurorisë. Ministria e Drejtësisë në vitin 2013, ka sjellë në Prokurorinë e Përgjithshme raportin e kontrollit të bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat për verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorëve për periudhën 29.04.2010 deri më 30.04.2011.

Duhet theksuar se sikundër është përmendur edhe në raportin e inspektimit, nga 317 çështje të kontrolluara, janë konstatuar me shkelje procedurale 17 qëndrime të prokurorit në gjykim, shkelje të cilat u atribuohen 6 prokurorëve. Pra rezulton se raporti në mes numrit të çështjeve të kontrolluara me numrin e shkeljeve të konstatuara nga grupi i inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë është shumë i vogël.

Në të gjitha rastet e evidentuara me shkelje nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, nuk konstatohet se nga prokurorët është shkelur ndonjë dispozitë procedurale konkrete e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, ashtu siç në raport inspektimi nuk është cituar ndonjë të tillë (përveç nenit 408 e vijues të K.Pr.Penale).

Veprimtaria e prokurorëve në seancë gjyqësore në përcaktimin e masës dhe llojit të dënimit, është kryer në të gjitha rastet në zbatim të Udhëzimit Nr.1 datë 14.11.2008 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për ushtrimin me efikasitet të së drejtës së ankimit” si dhe pas diskutimit paraprak me Drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat.

Gjithashtu, gjatë vitit 2013 Ministria e Drejtësisë ka ushtruar kontroll tematik për çështje të veçanta në 7 prokurori të rretheve gjyqësore, Tiranë , Vlore, Elbasan dhe Gjirokastrë, për një total prej 31 çështje. Në përfundim të këtyre kontrolleve, Ministria e Drejtësisë ka kontestuar zgjidhjet e çështjeve nga prokurorët vetëm në 7 çështjeve ose rreth 3.2 % të tyre. Nga prokurorët e Drejtësisë së Inspektimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme janë shqyrtuar konkluzionet e Ministrisë së Drejtësisë duke ushtruar kontroll të drejtpërdrejtë për të gjitha dosjet e kontestuara. Në përfundim të këtij kontrolli është konkluduar për shfuqizimin e 1 (një) vendimi.

- Marrëdhëniet me Ministrinë e Brendshme, për shkak të specifikës ligjore dhe praktike, janë vlerësuar të një rëndësie prioritare nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme. Viti 2013 është karakterizuar nga një bashkëpunim korrekt dhe intensive ndërmjet dy strukturave bazë në luftën kundër kriminalitetit. Janë intensifikuar ndjeshëm komunikimet dhe analizimet e veprave kriminale, si edhe janë ndjekur në mënyrë të përbashkët hetimet për veprat penale të referuara nga ana e Policisë së Shtetit.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit, në vitin 2013, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme, në praninë edhe të Shërbimit Informativ Shtetëror, është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi. Çështjet që janë objekt i kësaj marrëveshjeje përbëjnë thelbin e rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe janë ato problematika që gjenden në fokusin kryesor të aktivitetit të Prokurorisë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese.

-Raportet me Policinë e Shtetit: Duhet theksuar se, gjatë vitit 2013, reforma në kuadrin drejtues të strukturave të Policisë së Shtetit krijoi ulje të ritmit të hetimeve. Por, kjo situatë zgjati për një kohë të shkurtër dhe angazhimi me intensitet të lartë i dy institucioneve po i afrohet ritmit të kërkuar. Fakt konkret për këtë janë disa aksione shumë të rëndësishme në luftën kundër kriminalitetit dhe korrupsionit.

Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, Prokuroria e Përgjithshme dhe Policia e Shtetit janë të angazhuara për hetime të përbashkëta për nxjerrje të sekretit hetimor. Pavarësisht se kanë qenë raste të pakta të kësaj natyre gjatë vitit 2013, dy institucionet vijojnë hetimet në

mënyrë intensive për të evidentuar dhe vendosur para përgjegjesisë ligjore funksionarë publikë, të cilët publikojnë të dhëna sensitive hetimore, të cilat ndikojnë negativisht në proceset vijuese.

Në kuadër të ruajtjes së sekretit hetimor dhe mbrojtjes së të dhënave personale, Prokuroria e Përgjithshme ka hartuar Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Prokurori”, miratuar me urdherin nr.122, datë 10.04.2013 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Kjo Rregullore, e detyrueshme për të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe punonjësit e administratës së Prokurorisë, ndër të tjera ka qëllim të sigurojë që përpunimi i të dhënave personale të subjekteve, që kryhet nga prokuroria në kuadër të veprimtarisë së saj, të jetë në përputhje me parimet dhe standartet e vendosura në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

- Një formë e veçantë bashkëpunimi me Këshillin e Ministrave është shënuar gjatë vitit 2013. Prokuroria e Përgjithshme ishte palë në firmosjen e Marrëveshjes ndërinstitutionale të Bashkëpunimit për ngritjen e strukturës Task-Force “Për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”. Prokuroria e Përgjithshme është bërë pjesë e kësaj Task-Force, me kërkesë të Këshillit të Ministrave. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Prokuroria shqiptare po ofron kontributin e saj për të minimizuar dëmin e madh ekonomik që i shkaktohet shtetit shqiptar nga abuzimi me energjinë elektrike të bizneseve dhe qytetarëve të ndryshëm.

- Organi i Prokurorisë ka nënshkruar gjatë vitit 2013 disa akte të përbashkëta me institucione të tjera, në kuadër të përmbushjes së objektivit për rritjen e efektivitetit dhe bashkërendimit me organet e pushteteve të tjera dhe agjencitë e pushtetit ekzekutiv;

Memorandumin e bashkëpunimit të datës 09.01.2013, lidhur midis Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë të Financave, Ministrisë të Drejtësisë, Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, si edhe;

Memorandumin e Bashkëpunimit, datë 15.04.2013 “ Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

- Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional në luftën kundër korrupsionit, organi i Prokurorisë është përfshirë në tryezat e punës me përfaqësues të institucioneve të tjera për krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Lidhur me këtë argument, nga ana e përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme është theksuar nevoja e forcimit të kuadrit ligjor dhe logjistik kundër korrupsionit, si edhe janë parashtruar alternativa të mundshme për organizimin dhe funksionimin e saj.

- Prokuroria e Përgjithshme ishte pjesë integrale e Konferencës së Nivelit të Lartë “Mbi një strukturë efektive kundër korrupsionit”, organizuar nga Këshilli i Ministrave dhe Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri, në të cilën merrnin pjesë dhe referuan të gjithë institucionet kryesore kushtetuese të Shqipërisë.

PJESA II


I. STATISTIKAT PENALE TË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2013¹

1. VOLUMI I PUNËS NË HETIM PËR VITIN 2013

Gjatë vitit 2013, në organin e prokurorisë janë trajtuar **42175²** materiale kallzuese. Janë ndjekur gjithsej **33761** procedime penale që përbëjnë **rritje prej 22%** në krahasim me vitin 2012, prej të cilave janë regjistruar **27677** procedime penale që tregojnë **rritje prej 25 %** në krahasim me vitin 2012 dhe janë rifilluar **425** procedime që tregojnë **ulje prej 22 %** në krahasim me vitin 2012. Janë mbartur nga viti i kaluar **5659** procedime penale me **një rritje prej 13 %** (për qind) më shumë se viti 2012 por që në raport me totalin e procedimeve penale të ndjekura ky tregues është ulur nga 18 % për vitin 2012 në 16 % në vitin 2013

Është vendosur mosfillimi për **8414** referime dhe kallzime penale, që do të thotë ulje prej 5 % në krahasim me vitin 2012.

Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë për vitin 2013 paraqitet si vijon:




¹ Procedimi penal nuk njësohet me vepër penale, pasi:

- 1- Sistemi statistikor i prokurorisë regjistron të dhëna për veprën penale më të rëndë, pavarësisht se mund të jenë kryer disa vepra penale.
- 2- Në bazë të nenit 79 e 93 të Kodit të Procedurës Penale prokurori vendos bashkimin ose ndarjen e procedimeve.

² Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e *mbartura* nga viti 2012; procedimet e reja të *regjistruara* gjatë vitit 2013; procedimet e *rifilluara* gjatë vitit 2013 si rezultat i shfuqizimeve nga Prokuroria e Përgjithshme, gjykatat dhe nga drejtuesit e prokurorisë për shkak të zbulimit të provave të reja; si dhe *mosfillimet e marra* gjatë vitit 2013, përkatësisht $5.659 + 27.677 + 425 + 8.414 = 42.175$ materiale gjithsej.

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike volumi i punës i organeve të prokurorisë, për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012:




2. ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

Gjatë vitit 2013 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 8189 procedime (rritje prej 12 % në krahasim me vitin 2012) me 9974 të pandehur, përkundrejt 9354 të pandehur në vitin 2012 (rritje prej 6,6 % në krahasim me vitin 2012). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 11749 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal (rritje prej 10 % në krahasim me vitin 2012).

Nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 3041 çështje themeli (ulje prej 13 % në krahasim me vitin 2012) dhe 2139 raste për masat e sigurimit personal (rritje prej 21 % në krahasim me vitin 2012).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 378 gjykime themeli, 20 masa sigurimi personal, (nga këto 8 përfaqësime në Kolegjet e Bashkuara) dhe në cilësinë e subjektit të interesuar në mbrojtje të interesave të shtetit dhe të individëve pranë Gjykatës Kushtetuese për 11 çështje.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



3. TREGUESIT KRYESOR TË PUNËS SË PROKURORISË NË PESË VITET E FUNDIT

3.1 Procedime regjistruar

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2010 janë regjistruar 19286 procedime penale, që do të thotë rritje prej 14% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 janë regjistruar 19726 procedime penale që do të thotë rritje prej 2% në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 janë regjistruar 22079 procedime penale që do të thotë rritje prej 11,9 % në krahasim me vitin 2011 dhe **në vitin 2013 janë regjistruar 27677 procedime penale që do të thotë rritje prej 25 % në krahasim me vitin 2012**. Me rritje rezulton të jetë edhe volumi i punës së organit të prokurorisë në lidhje me procedimet penale që kanë qenë në ndjekje penale gjatë vitit 2013.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet penale të regjistruara në pesë vitet e fundit nga organi i prokurorisë:



3.2 Procedime në ndjekje

Në ndjekje penale në vitin 2010 rezultojnë 24506 procedime, që do të thotë rritje prej 10% në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 rezultojnë 24977 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 1,9 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 rezultojnë në ndjekje penale 27626 procedime që do të thotë rritje prej 10,6 % në krahasim me vitin 2011 dhe në **vitin 2013** rezultojnë **33761 procedime** në ndjekje penale që do të thotë **rritje prej 22 %** në krahasim me **vitin 2012**.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet në ndjekje penale në pesë vitet e fundit nga organi i prokurorisë:



3.3 Çështje të përfunduara


Në lidhje me çështjet e përfunduara, në vitin 2010 ka rritje prej 9,3 % në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 ka përsëri rritje prej 2 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 ka rritje prej 10,06% në krahasim me vitin 2011 dhe në **vitin 2013 rezulton një rritje prej 9 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2012**.

Në lidhje me çështjet e pushuara, në vitin 2010 ka rritje prej 4,3 % në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 ka ulje prej 12 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 ka rritje prej 29,63% në krahasim me vitin 2011 dhe në **vitin 2013 rezulton një ulje prej 12 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2012**.


Në lidhje me çështjet e pezulluara, në vitin 2010 ka rritje prej 15 % në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 ka përsëri rritje prej 15,8 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 ka rritje prej 10,63% në krahasim me vitin 2011 dhe në **vitin 2013 rezulton një rritje prej 21 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2012**.

Në lidhje me çështjet e dërguara në gjyq, në vitin 2010 ka rritje prej 10,7 % në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 ka rritje prej 1 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 ka ulje prej 1,6 % në krahasim me vitin 2011 dhe në **vitin 2013 rezulton një rritje prej 12 % e çështjeve të dërguara në gjyq në krahasim me vitin 2012.**

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake:



Sikurse vihet re nga tabela, rezulton se numri i të pandehurve të dërguar në gjyq në vitin 2010 ka rritje prej 10,8 % në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 janë dërguar në gjyq 9256 të pandehur, përkundrejt vitit 2010 kur janë dërguar gjyqit 9261 të pandehur dhe në vitin 2012 ka rritje prej 1 % të numrit të të pandehurve të dërguar në gjyq në krahasim me vitin 2011 dhe **në vitin 2013 rezulton një rritje prej 6,6 % e numrit të të pandehurve të dërguar në gjyq, në krahasim me vitin 2012.**


3.4 Vendimarrja e gjykatës

Vendi që zënë vendimet e gjykatës për pushimin e çështjeve, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq, rezulton të jetë si më poshtë:

Në vitin 2009 vendimet e gjykatës për pushimin e çështjes zënë 2,9 % në numrin e përgjithshëm të çështjeve të dërguara gjyqit, në vitin 2010 është 3,42 %, në vitin 2011 vendi që zënë vendimet e gjykatës për pushimin e çështjeve në numrin e përgjithshëm të çështjeve të dërguara gjyqit, është 3,11 %, në vitin 2012 ky tregues është 14,49 % dhe në **vitin 2013 ky tregues është 3,4 %.**

Në lidhje me pushimin e akuzës për të pandehurit, dinamika në pesë vitet e fundit është e tillë që: në vitin 2010 ka rritje prej 36,73% në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 ka ulje të lehtë prej 1,37% në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 ka rritje prej 10,89 % në krahasim me vitin 2011 dhe në **vitin 2013 ka një ulje prej 50 % në krahasim me vitin 2012.**

Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë, në pesë vite, 2009-2013:



Në lidhje me vendimet e gjykatës për pafajësinë, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2010 ka ulje prej 0,41 % në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 ka ulje prej 2,5 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 ka ulje prej 5,55 % në krahasim me vitin 2011 dhe në **vitin 2013 ka rritje prej 7,6 % në krahasim me vitin 2012.**


Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2009, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,88 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në vitin 2010, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,59 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate, në vitin 2011, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,52 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate në vitin 2012, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq vetëm 2,36 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në **vitin 2013 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq vetëm 2,38 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate.**

3.5 Mosfillimet

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte e në rrugë të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementët e veprave penale. Me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në mungesë të ekzistencës së rrethanave për fillimin e procedimit, të japë vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

Ky tregues i punës ka pësuar ulje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar.

Kështu, ndërsa në vitin 2012 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 8866 referime dhe kallzime, në vitin 2013 janë marrë 8414 vendime të tilla.



Në lidhje me procedimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2010 ka rritje prej 23,5 % në krahasim me vitin 2009, në vitin 2011 ka rritje

prej 11 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 ka rritje prej 13 % në krahasim me vitin 2011 dhe në **vitin 2013 rezulton një ulje prej 5 %, në krahasim me vitin 2012.**

4. PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2013

Në prokurorinë e shkallës së parë **Berat** janë regjistruar 1139 procedime penale, që do të thotë rritje prej 36 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Dibër** janë regjistruar 465 procedime penale, që do të thotë ulje prej 20 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Durrës** janë regjistruar 2248 procedime penale, që do të thotë rritje prej 13 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Elbasan** janë regjistruar 2514 procedime penale, që do të thotë rritje prej 42 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Fier** janë regjistruar 1747 procedime penale, që do të thotë rritje prej 35% në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Gjirokastrë** janë regjistruar 640 procedime penale, që do të thotë ulje prej 7% në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kavajë** janë regjistruar 592 procedime penale, që do të thotë rritje prej 57 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Korçë** janë regjistruar 1513 procedime penale, që do të thotë rritje prej 27 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Krujë** janë regjistruar 622 procedime penale, që do të thotë rritje prej 15, 6 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kukës** janë regjistruar 496 procedime penale, që do të thotë rritje prej 29 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kurbini** janë regjistruar 402 procedime penale, që do të thotë rritje prej 20 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Lezhë** janë regjistruar 1020 procedime penale, që do të thotë rritje prej 37 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Lushnje** janë regjistruar 802 procedime penale, që do të thotë rritje prej 72 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Mat** janë regjistruar 231 procedime penale, që do të thotë ulje prej 11 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Përmet** janë regjistruar 109 procedime penale vetëm një më shumë se në vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Pogradec** janë regjistruar 568 procedime penale, që do të thotë rritje prej 40 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Pukë** janë regjistruar 265 procedime penale, që do të thotë rritje prej 79 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Sarandë** janë regjistruar 780 procedime penale, që do të thotë rritje prej 45 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Shkodër** janë regjistruar 1582 procedime penale, që do të thotë rritje prej 16 % në krahasim me vitin 2012;


Në prokurorinë e shkallës së parë **Tiranë** që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 7463 procedime penale, që do të thotë rritje prej 25 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Tropojë** janë regjistruar 193 procedime penale aq sa edhe në vitin 2012;


Në prokurorinë e shkallës së parë **Vlorë** janë regjistruar 1975 procedime penale, që do të thotë rritje prej 5 % në krahasim me vitin 2012;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për **Krime të Rënda** janë regjistruar 285 procedime penale, që do të thotë rritje prej 37 % në krahasim me vitin 2012;

Sa më sipër paraqitet grafikisht në vijim:



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në përqindje mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2013:



5. KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100.000 BANORË BAZUAR NË SISTEMIN STATISTIKOR TË PROKURORISË


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000³ banorë në vitin 2013 është 992 ndërsa në vitin 2012 është 784. Në lidhje me koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë, sipas prefekturave nga të dhënat statistikore rezulton se:

Në prefekturën Berat që përfshin prokurorinë e shkallës së parë Berat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 822; në prefekturën Dibër që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Dibër dhe Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 524; në prefekturën Durrës që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Durrës dhe Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 1076; në prefekturën Elbasan që përfshin prokurorinë e shkallës së parë Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 858; në prefekturën Fier që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Fier dhe Lushnje koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 836; në prefekturën Gjirokastër që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër dhe Përmet koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 1093; në prefekturën Korçë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Korçë dhe Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 961; në prefekturën Kukës që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Kukës dhe Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 827; në

³ <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx?tab=tabs-5>

prefekturën Lezhë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Lezhë dhe Kurbin koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 1070; në prefekturën Shkodër që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Shkodër dhe Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 872; në prefekturën Tiranë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Tiranë dhe Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 1051 dhe në prefekturën Vlorë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Vlorë dhe Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2013 është 1591.

Sa më sipër paraqitet grafikisht në vijim:



6. TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2013 janë **filluar kryesisht** 176 procedime penale nga ana e prokurorisë.

Kallëzime nga nëpunësit publikë: në vitin 2013 rezultojnë të jenë 1087 kallëzime, që do të thotë ulje prej 4.1% në krahasim me vitin 2012. Kallëzime nga nëpunësit publikë, në vitin 2012 rezultojnë të jenë 1134 kallëzime, që do të thotë rritje prej 60,4% në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq për vitin 2010 rezultojnë 1134 kallëzime, që do të thotë rritje prej 25,30 % në krahasim me vitin 2009.

Kallëzime nga personeli mjekësor: për vitin 2013 rezultojnë 3 kallëzime nga personeli mjekësor, për vitin 2012 rezultojnë 4 kallëzime, për vitin 2011 rezultojnë 3 kallëzime, për vitin 2010 rezulton 1 kallëzim, dhe për vitin 2009 rezultojnë të regjistruara 5 kallëzime penale.

Kallëzime nga shtetasit: në vitin 2013 rezultojnë 2118 kallëzime që do të thotë ulje prej 15.41% në krahasim me vitin 2012, në vitin 2012 rezultojnë 2504 kallëzime që do të thotë rritje prej 39,03 % në krahasim me vitin 2011, në vitin 2011, nga të dhënat statistikore rezultojnë 1801 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë ulje prej 10,35% në krahasim me vitin 2010, në vitin 2010 rezultojnë 2009 kallëzime, që do të thotë ulje prej 14,80% në krahasim me vitin 2009.

Kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim: në vitin 2013 rezultojnë 187 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim që do të thotë ulje prej 62 % në krahasim me vitin 2012, në vitin 2012 rezultojnë 500 ankime që do të thotë rritje prej 34,05 % në krahasim me vitin 2011, në vitin 2011 rezultojnë 373 ankime, që do të thotë ulje prej 18,55 % në krahasim me vitin 2010, ndërsa në vitin 2010 rezultojnë 458, që do të thotë rritje prej 118 % në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2013 është marrë njoftim për **5565 ngjarje**, që do të thotë rritje 17.9 % në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2012 është marrë njoftim për 4717 ngjarje, që do të thotë rritje prej 61,87% në krahasim me vitin 2011, gjatë vitit 2011 është marrë njoftim për 2916 ngjarje, që do të thotë rritje prej 18,29 % në krahasim me vitin 2010 dhe gjatë vitit 2010 është marrë njoftim për 2465 ngjarje, që do të thotë se është një tregues në ulje prej 3,71 % në krahasim me vitin 2009.

Gjithashtu, theksojmë se, gjatë vitit 2013 janë marrë **23911 referime nga Policia e Shtetit**, që do të thotë rritje prej 30.48 % në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2012 janë marrë 18325 referime nga Policia e Shtetit, që do të thotë rritje prej 32,82 % në krahasim me vitin 2011, gjatë vitit 2011 janë marrë 13828 referime nga Policia e Shtetit, që do të thotë rritje e lehtë prej 0,4 % në krahasim me vitin 2010. Gjatë viti 2010 janë marrë 13772 referime nga Policia e Shtetit, që do të thotë ulje prej 3,94 % në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2013 janë marrë **58 kallëzime nga Policia Tatimore**, që do të thotë ulje prej 57.97 % në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2012 janë marrë 138 kallëzime nga Policia Tatimore, që do të thotë rritje prej 64,28 % në krahasim me vitin 2011, gjatë vitit 2011 janë marrë 84 kallëzime nga organet tatimore, gjatë vitit 2010 janë marrë 85 kallëzime nga organet tatimore që do të thotë rritje prej 21,42 % në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2013 janë bërë **91 kallëzime nga Policia Pyjore**, që do të thotë ulje prej 52.60 % në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2012 janë bërë 192 kallëzime nga Policia Pyjore, që do të thotë rritje prej 3,78 % në krahasim me vitin 2011, gjatë vitit 2011 janë bërë 185 kallëzime nga Policia Pyjore, që do të thotë rritje prej 18,58 % në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010 janë bërë 156 kallëzime nga Policia Pyjore, që do të thotë ulje prej 19,58% në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2013 janë bërë **144 kallëzime nga CEZ**, që do të thotë ulje prej 58.85 % në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2012 janë bërë 350 kallëzime nga CEZ, që do të thotë ulje prej 53,08 %

në krahasim me vitin 2011, gjatë vitit 2011 janë bërë 746 kallëzime nga CEZ, që do të thotë rritje prej 13,03 % në krahasim me vitin 2010 dhe gjatë vitit 2010 janë bërë 660 kallëzime nga OSSH/CEZ, që do të thotë rritje prej rreth 5,2 herë në krahasim me vitin 2009.

Gjithashtu, për vitin 2013 janë bërë **11 kallëzime nga polici të tjera**, që do të thotë ulje prej 66 % në krahasim me vitin 2012 gjatë të cilit janë bërë 33 kallëzime nga polici të tjera, që do të thotë ulje prej 51% në krahasim me vitin 2011, gjatë vitit 2011 janë bërë 67 kallëzime nga polici të tjera, që do të thotë rritje prej 26,41% në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010, janë bërë 53 kallëzime nga polici të tjera gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 26,19 % në krahasim me vitin 2009.

7. TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË

Funksion i organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale. Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë të marra gjatë vitit 2013, organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre.

Më konkretisht, gjatë vitit 2013, prokurorët kanë urdhëruar ekzekutimin e 7644 vendimeve penale të formës së prerë. Nga këto vendime, gjatë vitit 2013 janë ekzekutuar nga Policia Gjyqësore dhe përmbarimi, 4554 vendime penale të formës së prerë.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 urdhrat për ekzekutim të dënimeve me burgim zënë 67 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori, ndërsa urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 33 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori. Për të patur një këndvështrim krahasimor në lidhje me këtë tregues, sjellim të dhënat statistikore të vitit 2012, sipas të cilave urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zinin 24 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori ku përfshihen (në total) urdhra për ekzekutimin e dënimeve me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë, dënime plotësuese dhe dënime alternative. Urdhrat për ekzekutim të dënimeve me burgim zinin 76 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori.

Vendime të cilët kanë mbetur pa u ekzekutuar, gjatë vitit 2013 janë regjistruar 3158, që do të thotë se ka përmirësim me 41 % në krahasim me vitin 2012. Vendime të cilët kanë mbetur pa u ekzekutuar gjatë vitit 2012 kanë qenë 5374, që do të thotë ulje prej 2,82 % në krahasim me vitin 2011. Pra siç mund të vihet re, ky tregues është gjithmonë në përmirësim.

Numri i vendimeve sipas llojit të tyre, të mbetura pa ekzekutuar gjatë vitit 2013 janë: 1 vendim për masën e dënimit burgim i përjetshëm, 603 vendime me burgim, 1246 vendime për dënimin me gjobë e 64 dënime plotësuese dhe dënime alternative 1244.

Lidhur me dënimet e paekzekutuara me burgim, vlen për tu theksuar fakti se kata të pandehur janë gjykuar në mungesë si dhe janë shpallur në kërkim ndërkombëtar, por nuk është mundur ekzekutimi i këtyre vendimeve.


Sa më sipër paraqitet në grafikun në vijim:




II. KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

1. Raporti krime dhe kundërvajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2013, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë sipas veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal.



2. Procedime të regjistruara sipas seksioneve të Kodit Penal për vitet 2012-2013:



3. Raporti i grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal:


Nga analiza e të dhënave statistikore rezulton se:

- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 2,7 %⁴;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,05 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me dashje** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 4 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,02 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,69 %;
- Raporti që zënë **krimet seksuale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,38 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,49 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,58 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 3,4 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **vjedhja e pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 42 %;
- Raporti që zënë **mashttrimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 3,2 %;
- Raporti që zënë **shkatërrimi i pronës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 3,9 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,09 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me veprimtarinë bankare dhe financiare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,07 %;
- Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,5 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,3 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i monedheve dhe letrave me vlerë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,2 %;

⁴ Përfshirë vrasjet e mbetura ne tentative.

- Raporti që zë **falsifikimi i dokumenteve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 3,3 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në fushën e falimentimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 1 %;
- Raporti që zë **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 2,6 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 3,5 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,9 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër pavarësisë dhe integritetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër rendit kushtetues** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0 %;
- Raporti që zënë **veprat me qëllime terroriste** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 2 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 2,1 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 20 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,5 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 1,2 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që prekin zgjedhjet e lira**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,1 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,01 %;

Këto të dhëna paraqiten grafikisht si më poshtë:



Në vijim do të analizohet në mënyrë më të detajuar secili nga seksionet e Kodit Penal:

III. ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL⁵

KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike⁶ që zë ky grup veprash penale për vitin 2013 është 2,4 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2012 ky grup veprash përbënte 2,76 % të totalit të procedimeve. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun II, Seksioni I, “Krime kundër jetës të kryera me dashje”.

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja ⁷	107	57	90	71	84	66	40	50	52	40
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	1	0	1	1	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	65	29	46	38	48	69	33	35	47	23
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje	⁸					3	1	2	1	0
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	72	31	77	36	35	52	33	63	51	18
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	0	0	0	0	0	4	0	4	0	0
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	0	0	0	0	0	27	9	27	9	4
Neni 80	2	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Neni 81 Vrasja e foshnjës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	4	5	4	5	6	0	0	0	0	2
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme	7	8	7	8	6	0	0	0	0	3

⁵ Në statistikat e të pandehurve të regjistruar, dërguar në gjykim dhe /ose dënuar, shifrat në tabelat përkatëse mund të përfshijnë edhe raste të mbartuara përveç vitit 2012 edhe viteve të tjera.

⁶ Këtu e në vijim “Pesha specifike” është llogaritur si raport i grupveprave të renditura në tabelë me numrin total të procedimeve. Për shkak të grupimit të veprave jo gjithmonë sipas strukturës së Kodit Penal, por edhe sipas fushës, mund të ketë mosperputhje midis këtij treguesi dhe raportit të grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal.

⁷ Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativa (96 procedime regjistruar dhe 92 pandehur regjistruar).


⁸ Mungojnë të dhënat për vitin 2012 për nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c pasi këto dispozita kanë qenë paragrafe të neneve 78 e 79. Me ligjin 144/2013 janë parashikuar si dispozita konkrete.

Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje	4	0	2	0	0	10	5	4	5	2
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84 Kanosja	348	114	186	124	113	436	129	274	138	82
Totali	610	245	412	283	293	669	251	459	304	175

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 9,6 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi një rritje prej 2,4 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 11,4 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 7,4 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 40 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër jetës të kryera me dashje për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2013 në total janë 459 të pandehur të regjistruar ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 412 të pandehur të regjistruar. Pra, në këtë tregues vihet re një rritje prej 11.04 %.

Në lidhje me moshën e të pandehurve vihet re se 97 % e tyre janë meshkuj (434 të tillë, nga të cilët 14 të mitur) dhe vetëm 3 % janë femra (11 femra ndër të cilat nuk rezultojnë të mitura). Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2012 rezulton ulje prej 66 % e të pandehurve meshkuj të mitur 14-18 vjeç.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se për këto grup veprash penale janë regjistruar 8 të pandehur me arsim të lartë, 139 të pandehur janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 61 % e të pandehurve janë të papunë, rreth 29 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe vetëm rreth 1 % e tyre janë nëpunës shtetëror.

Rezulton se 238 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 20 % në krahasim me vitin 2012 i këtij treguesi) ndërsa 221 prej tyre në komuna. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se vetëm 26 prej tyre janë përsëritës në krime.

Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 173 nga të cilët 20 janë femra.

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 117 vdekje, 44 plagosje e rëndë dhe 44 plagosje e lehtë.

Në vitin 2013 janë marrë të pandehur 3 shtetas të huaj.

Bazuar në sa më sipër, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e këtyre veprave penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vrasja me dashje


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2013 është 9,8 %, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 17,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013, ka tendencë në ulje prej 38 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”, në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja” për vitet 2012 e 2013.



Siç rezulton edhe nga paraqitja grafike e procedimeve, vepra penale e vrasjes me dashje në përgjithësi ka tendencë ulje nga viti 2012 në vitin 2013, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet, Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë. Në prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Fier, Gjirokastrë dhe Pukë, procedimet penale të regjistruara për këtë veprë për vitin 2013 paraqesin tendencë në rritje kundrejt vitit 2012.

Të dhënat e detajuara për procedimet e regjistruara gjatë vitit 2013 në prokuroritë e shkallës së parë për vrasjen me dashje, gjenden në mënyrë të detajuar në vijim:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 21 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë, që përbën 10,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Krujë, që përbën 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë e Fier në të cilat janë regjistruar 7,6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Lushnjë e Shkodër për këtë veprë penale, janë regjistruar 5,8 % e procedimeve penale në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Kavajë, Lezhë, Pogradec, Pukë, Sarandë e Vlorë kanë një shpërndarje pothuajse të njëtrajtshme të kësaj veprë duke regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % e totalit të regjistruar për këtë veprë në shkallë vendi. Ndërkaq në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet e Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”.

Vrasja me paramendim


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2013 është 10,3 %, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 11 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013, ka një rritje prej 6 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 “Vrasja me paramendim” i Kodit Penal krahasuar me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim”, për vitin 2013.



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vrasjes me paramendim, është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë që përbën 29 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë ku është regjistruar 10 % e këtyre procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë e Durrës ku janë regjistruar 9 % e këtyre procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lushnjë, Mat, Përmet e Pogradec kanë një shpërndarje pothuajse të njëtrajtshme të kësaj vepre duke regjistruar nga 1 deri në 3 procedime penale (e shprehur në përqindje nga 1,5 % deri në 4 %), ndërsa në prokuroritë e shkallës së parë Pukë, Sarandë e Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim”.

Vrasja në rrethana të tjera cilësuese


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 7,7 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 11,8 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2013, ka ulje prej 27,7 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” i Kodit Penal krahasuar me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rrethave për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” në vitin 2013;



Sic vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vrasjes me paramendim është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë ku janë regjistruar 17 % e procedimeve për këtë veprë në shkallë vendi dhe në


prokurorinë e shkallës së parë Durrës ku janë regjistruar 15% e totalit të procedimeve penale. Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 6 procedime që përbëjnë 11,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Kurbin e Vlorë janë regjistruar 4 procedime ose 7,7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Elbasan e Shkodër janë regjistruar 3 procedime penale ose 5,8 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013 në prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Lezhë janë regjistruar nga 2 procedime ose 3,8 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Korçë, Kukës, Krujë, Lushnjë, Pukë, Sarandë e Tropojë kanë një shpërndarje të njëtrajtshme të kësaj veprë, kanë regjistruar nga 1 procedim penal, ndërsa në prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Mat, Përmet e Pogradec nuk është regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” gjatë vitit 2013.

Kanosja

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krimet kundër jetës të kryera me dashje” është 65 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 75 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 janë regjistruar 436 procedime penale që përbën një rritje prej 25 % krahasuar me 348 procedime të regjistruara për vitin 2012, për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rrethëve për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja” në vitet 2012 e 2013;



Siç rezulton edhe nga paraqitja grafike e procedimeve, vepra penale e kanosjes ka në përgjithësi tendencë rritje nga viti 2012 në vitin 2013. Numri më i lartë i procedimeve të regjistruara, rezulton në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Fier, Korçë, Lushnje e Tiranë, ndërsa në prokuroritë e shkallës së parë Përmet e Sarandë kjo vepër ka ruajtur të njëjtin nivel si në vitin 2012.

Të dhënat e detajuara për procedimet e regjistruara në prokuroritë e shkallës së parë për veprën penale të kanosjes gjenden në mënyrë të detajuar në vijim:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kanosjes është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë që përbën 24 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi.

Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 7, 8 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 7 % e totalit të procedimeve penale, në prokurorinë e shkallës së parë Berat e Vlorë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Pogradec, Lezhë e Durrës janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë e Lushnjë janë regjistruar 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastër, Krujë, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet, Pukë, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar gjatë vitit 2013 numrin më të vogël të procedimeve (më pak se 2 %) për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i II “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2012					2013				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	9	5	7	5	8	15	11	7	13	9
Totali	9	5	7	5	8	15	11	7	13	9

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi” 66,6 % në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi rritje të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012 nga 5 në 11 të tilla. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re se numri i të pandehurve të regjistruar rezulton i pandryshuar për të dy vitet, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur nga 5 në 13.

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 10 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 11 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re një ulje e lehtë në krahasim me vitin 2012.

Të gjithë të pandehurit janë të moshes madhore (mbi 18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 4 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, 5 me arsim të mesëm dhe 1 me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 7 të pandehur rezultojnë të jenë të papunë dhe 3 të punësuar.

Rezultojnë se 6 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 4 prej tyre në komuna. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 10 të pandehurit, janë të padënuar më parë.

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 5 vdekje.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2013 është 4 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2012 ky grup veprash përbënte 5 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i III “Vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje”:

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denu ar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denu ar
Neni 86 Tortura	2	0	5	0	0	2	1	1	1	0
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88 Plagosje e rëndë	139	108	125	127	126	170	112	213	137	72
Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psikike	4	3	5	4	2	5	5	9	10	7
Neni 88/b Plagosje e rëndë në kapërcim të mbrojtjes	7	7	10	7	8	3	2	3	2	3
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	996	417	762	547	373	942	386	884	512	228
Neni 89/a	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 90 Dëmtime të tjera	5	1	1	1	0	4	1	2	1	5
Totali	1153	536	908	686	509	1126	507	1112	663	315

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 2,3 % e numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2012. Po kështu tendencë ulje prej 5,4 % paraqet edhe numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 22 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 3,3 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 38 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër shëndetit të kryera me dashje për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2013 në total janë 1112 të pandehur të regjistruar ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 412 të pandehur të regjistruar. Pra, në këtë tregues vihet re një rritje prej 169 %.

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se vetëm 2,5 % e tyre janë femra (28 të tillë dhe pjesa tjetër janë meshkuj, rreth 97,5 %. Gjithashtu, rezulton se 58 të pandehur janë minorenë (14-18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se për këto grup veprash penale janë regjistruar 31 të pandehur me arsim të lartë, 217 të pandehur janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 62 % e të pandehurve janë të papunë, rreth 26 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe vetëm rreth 2 % e tyre janë nëpunës shtetëror.

Rezulton se 711 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 599 prej tyre në komuna. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se vetëm 6,5 % prej tyre janë përsëritës të të njëjtës vepër apo të dënuar për vepra të tjera penale, ndërsa 93,5 % janë të pa dënuar më parë.

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 1 vdekje, 96 plagosje e rëndë dhe 464 plagosje e lehtë. Në vitin 2013 është marrë i pandehur 1 shtetas i huaj.

Bazuar në sa më sipër, faktori kryesor kriminogjenë që ndikonë në ecurinë e këtyre veprave penale ka të bëjë me nivelin e papunësisë të të pandehurve.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Plagosja e rëndë me dashje


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër shëndetit të kryera me dashje” për vitin 2013 është 15 %, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 12 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013, vihet re tendenca në rritje prej 22 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”, në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje” për vitin 2013.



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë që përbën 23,5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi, e në vijim, në prokurorinë e shkallës së parë Fier që përbën 12 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër që përbën 10 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 9,4 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 8,8 % të numrit total të procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë e Berat që përbën 5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Mat, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Pukë, Pogradec, Lushnje, Lezhë, Sarandë, Tropojë e Vlorë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 3,5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara ndërsa prokuroria e shkallës së parë Përmet nuk ka regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”.

Plagosja e lehtë me dashje


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kryerë kundër shëndetit të kryerë me dashje” për vitin 2013 është 83,6 %, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 86 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013, vihet re tendenca një ulje prej 5 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”, në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje” për vitin 2013.



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë që përbën 20 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në

shkallë vendi, në vijim, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 19,4 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 8 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Korçë që përbën 7,7 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Fier që përbën 7,2 % të numrit total të procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër që përbën 4,5 % të numrit total të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Sarandë e Lushnjë që përbën 3,6 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Mat, Përmet, Pogradec e Pukë kanë regjistruar numër procedimesh që përbëjnë më pak se 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, ndërsa prokuroria e shkallës së parë Tropojë nuk ka regjistruar asnjë procedim penal gjatë vitit 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i IV “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia”:

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2012					2013				
	Nr. Procd . Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia	5	0	1	0	0	3	1	1	1	0
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia	3	0	1	0	0	3	0	0	0	1
Totali	8	0	2	0	0	6	1	1	1	1

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka ulje të numrit 25 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi” në krahasim me vitin 2012.

Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re se numri i të pandehurve të regjistruar është ulur nga 2 në 2012 në 1 në vitin 2013, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur nga 0 në 1 dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur po me të njëtin nivel.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,69 %. Ky tregues për vitin 2012 ka qenë 0,41 %, pra vihet re një rritje e lehtë e tij për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në seksionin V të kreut të dytë “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës”.

V. P. QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDERPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.	0	0	0	0	0	3	0	1	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	25	0	1	0	1	34	9	8	15	2
Neni 97 Mosdhënia ndihmë	1	1	0	1	0	1	1	0	1	1
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	65	2	2	2	1	154	6	11	8	2
Totali	92	3	3	3	2	192	16	20	24	5

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 108 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës”, në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq është rritur më shumë se pesë herë numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Gjithashtu rritje vërehet edhe në lidhje me numrin e të pandehurve të regjistruar, numrin e të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata me përkundrejt të njëjtëve tregues të vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 20 të pandehur në hetim.

Ndërsa në lidhje me të pandehurit gjatë vitit 2012 në total janë 8 të pandehur në hetim.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 3 të pandehur janë me arsim të mesëm dhe 5 të pandehur me arsim të lartë dhe pjesa tjetër m arsim deri në 9 vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 2 të pandehur, sektori privat 5 dhe 13 të papunë.

Rezultojnë se 13 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 7 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.

Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 3 meshkuj të mitur (mosha 14-18 vjeç); gjithsej 15 meshkuj madhorë ndërsa 2 janë femra madhore (të rritur mbi 18 vjeç).

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 91 raste vdekje, 2 plagosje e rëndë dhe 1 plagosje e lehtë. Në lidhje me këtë tregues ka një rritje prej 225 % me vitin 2012.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shkaktimi i vetëvrasjes

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 80 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 70,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore, vihet re tendenca në rritje prej 136 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, në krahasim me vitin 2012.

KRIME SEKSUALE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,34 %, ndërkohë që për vitin 2012 ka qenë 0,23 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VI të Kodit Penal “Krime Seksuale”:


KRIME SEKSUALE	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur	17	10	17	13	12	26	14	20	16	17
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç	7	0	1	0	1	15	7	17	9	0
Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura	14	5	11	6	5	21	2	19	2	1
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u	6	1	1	1	0	3	2	1	2	2

mbrojtur										
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërkënim me përdorimin e armës	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari	1	0	0	0	1	4	1	3	1	0
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	7	5	7	5	4	24	15	18	15	9
Totali	52	21	37	25	23	96	39	80	45	29

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 84 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2012. Po kështu kemi rritje prej 85 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 116 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 80 % dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 26 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e krimeve seksuale për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 80 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 37 të pandehur në hetim. Në vitin 2013 për 45 të pandehur është ngritur akuza në gjykatë, ndërkohë në vitin 2012 është ngritur akuza në gjykatë për 25 të pandehur.

Nga të pandehurit, 5 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër, të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 2 femra dhe 73 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2012 rezulton rritje e të pandehurve meshkuj në vitin 2012 prej 77 % .

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 60 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 18 me arsim të mesëm dhe 2 te pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur.

Nga sektori privat 5 të pandehur dhe pjesa tjetër të papunë.

Rezulton se 49 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 31 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.


Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 19 femra.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” është 27 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 32 %. Pra vihet re ulje krahasuar me vitin 2012.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, në vitin 2013, prej 52 % në krahasim me vitin 2012.

Duke konstatuar me shqetësim rritjen e konsiderueshme të kësaj vepre penale për vitin 2013, organi i prokurorisë ka ndërmarrë hapa konkrete duke synuar forcimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera, si Policia e Shtetit, Ministria e Arsimit. Gjithashtu, një instrument i rëndësishëm për parandalimin e tyre është ndergjegjesimi i qytetareve për të denoncuar raste të tilla, si dhe personat me tendenca të tilla kriminale, etj.

Ndërkohë që për hetimin e këtyre çështjeve, janë specializuar prokurorë dhe oficerë të seksioneve për të miturit, të cilët i nënshtrohen në vazhdimësi trajnimeve, seminareve edhe në kuadër të bashkëpunimeve me ndërkombëtarët për forcimin e kapaciteteve njerëzore.

Në këtë drejtim organi i Prokurorisë është fokusuar në ashpërsimin e politikës penale dhe masave të dënimit për të pandehurit e veprave penale në dëm të të miturve.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë vepër penale:



Rezulton se në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 5 procedime penale për këtë vepër, që është edhe numri më i madh i regjistruar në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Fier e Korçë janë regjistruar 4 procedime penale, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 3 procedime penale, në prokuroritë e shkallës së parë Lushnjë e Tiranë janë regjistruar 2 procedime penale dhe në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Lezhë e Shkodër është regjistruar përkatësisht nga 1 procedim penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, në vitin 2013.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,44, dhe për vitin 2012 ka qenë 0,38 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII “Vepra penale kundër lirisë së personit”.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit	9	2	11	8	2	12	1	9	3	0
Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese	0	1	0	1	1	1	0	0	0	0
Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise	36	12	34	21	22	42	8	17	15	16
Neni 109/c Zhdukja me forcë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	30	13	42	30	16	48	22	54	43	29
Neni 111 Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 112 Dhunimi i baneses	10	5	6	7	8	20	6	20	10	6
Totali	85	33	93	67	49	123	37	100	71	51

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 44,7 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi rritje prej 12 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 7,5 %, një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 5,9 % dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 4 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër lirisë së personit për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 100 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 93 të pandehur në hetim. Në këtë tregues vihet re rritje prej 7,5 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012. Në vitin 2012 për 71 të pandehur është ngritur akuza në gjykatë, ndërkohë që në vitin 2012 është ngritur akuza në gjykatë për 67 të pandehur që do të thotë një rritje e këtij treguesi për vitin 2013 prej 5,9% në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 1 ka qenë i pandehur i mitur mashkull dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 3 femra dhe 96 meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 57 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 40 me arsim të mesëm dhe 3 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur.

Nga sektori privat janë regjistruar 40 të pandehur dhe të papunë 60. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 59 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 41 prej tyre në komuna.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 34 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 42,35 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtërëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, në vitin 2013, prej 16,6 % në krahasim me vitin 2012.

Heqja e paligjshme e lirisë


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër lirisë së personit” është 39 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 35 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”, në vitin 2013, prej 60 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë veprë penale:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, Fier e Elbasan, ku janë regjistruar respektivisht 20 %, 18,7 % dhe 14,5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 8 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Durrës kanë regjistruar 6 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Lushnjë e Shkodër kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 4 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Krujë, Lezhë e Pogradec kanë regjistruar nga 1 procedim penal dhe prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Kukës, Mat, Përmet, Pukë, Sarandë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013, përkundrajt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike është 0,58 % ndërsa për vitin 2012 ka qenë 0,45 %. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VIII të Kodit Penal “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”.


VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2012					2013				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjkim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjkim	Nr. Pan d denu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proc ed per gjkim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pan d denu ar
Neni 113 Prostitucioni	10	8	34	18	20	7	5	9	15	16
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit	19	5	10	9	9	42	9	33	17	19
Neni 114/a Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	18	5	11	10	14 ⁹					
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion	0	0	0	0	3	1	1	1	3	0
Neni 117 Pornografia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 118 Dhunimi i varreve	26	5	6	6	5	21	6	8	7	5
Neni 119 Fyerja	5	1	3	1	0	4	0	2	0	0
Neni 120 Shpifja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private	2	0	0	0	0	3	0	3	0	1
Neni 121/a Përndjekja	17	7	9	6	0	74	32	52	33	21
Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	2	1	1	1	2	2	0	0	0	0
Totali	99	32	74	51	53	154	54	108	75	63

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 56 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi rritje prej 69 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 46%, po kështu ka rritje edhe numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit me 47 % dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 19 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:

⁹ Shfuqizuar me ligjin 144/2013



TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 108 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 74 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 46 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 2 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 23 femra dhe 83 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2013 rezultojnë ulje e të pandehurve femra në vitin 2012 prej 42 % .

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 66 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (që do të thotë ulje prej 10 % në krahasim me vitin 2012) dhe 27 me arsim të mesëm dhe 5 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore, nga sektori privat janë regjistruar 15 të pandehur përkundëjt 9 të tillë në vitin 2012 dhe të papunë 93 (rritje prej 69 % në krahasim me vitin 2012). Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezultojnë se 65 të pandehur kanë vendbanimin në qytet rritje prej 20 % në krahasim me vitin 2012) ndërsa 43 prej tyre në komuna (rritje prej 43 % në krahasim me vitin 2012).

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Prostitucioni

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 4,5 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 10 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni”, në vitin 2013, prej 30 % në krahasim me vitin 2012.

Shfrytëzimi i prostitucionit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 27 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 19 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”, në vitin 2013, prej 121 % në krahasim me vitin 2012, kjo për shkak edhe të ndryshimit të përmbajtjes së kësaj dispozite dhe shfuqizimit të nenin 114/a të Kodit Penal, me ligjin 144/2013.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit:



Prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Fier respektivisht nga 8 e 7 procedime të regjistruara që përbëjnë 19 % e 17 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për këtë veprë penale. Prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Berat e Tiranë, kanë regjistruar 12 % dhe 9,5 % të procedimeve penale në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Vlorë kanë regjistruar 7 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Shkodër kanë regjistruar 4,7 % të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë Gjirokastrë, Kavajë, Lushnje e Pogradec kanë regjistruar vetëm nga 1 procedim penal ose 2,3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi ndërkohë që nuk ka anjë procedim të regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Krujë, Kukës, Kurbin, Mat e Përmet.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013, përkundëjt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 3,4 %, ndërsa për vitin 2012 ka qenë 1,68 %. Pra, vihet re dyfishim i këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IX-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal “Vepra Penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES	2012					2013				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denua r	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pan d per gjyk im	Nr. Pand denua r
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur	19	5	9	5	4	36	9	20	9	6
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit	4	3	4	3	0	13	9	10	9	8
Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë	0	0	0	0	3	2	0	1	0	1
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit	6	2	3	2	2	4	2	1	2	0
Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës	5	0	0	0	2	5	1	3	1	0
Neni 128 Ndërrimi I fëmijëve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje I fëmijës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 129 Shtytja e të miturve në krim	3	0	1	0	0	5	6	5	6	4
Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë	5	3	4	3	3	55	36	43	36	17
130/a Dhuna në familje	328	159	255	171	69	826	589	791	606	405
Totali	371	172	276	184	83	946	652	874	669	441

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 154 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi rritje prej 279 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 217 %, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur me 263 % dhe ka rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 431 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 874 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 276 të pandehur në hetim.¹⁰

Nga të pandehurit, 6 të pandehur të mitur meshkuj, të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 36 femra, përkundrejt 16 të tilla në vitin 2012 dhe 832 meshkuj të pandehur në vitin 2013, përkundrejt 176 të tillë në vitin 2012.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 682 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 177 me arsim të mesëm dhe 15 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori shtetëror janë regjistruar 2 të pandehur.

Nga sektori privat janë regjistruar 139 të pandehur dhe pjesa tjetër e të pandehurve me arsimin 9-vjeçar.

Rezulton se 502 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 372 të pandehur në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë

¹⁰ Shtuar si veper penale me ligjin 23/2012, hyrë në fuqi në mars 2012.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2013 është 5,8 %, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 1,3 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje 11 herë më shumë (prej 1000 %) e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal “Shtërëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë”, në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Dhuna në familje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2013 është 87 %, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 88 % .


Në këtë grup veprash penale vihet re se në vitin 2013 janë regjistruar 826 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”, ndërkohë që në vitin 2012 ky numër ka qenë 328. Janë dërguar për gjykim 589 procedime penale nga ana e organit të prokurorisë në vitin 2013, në vitin 2012 ky tregues ka qenë 159. Janë regjistruar 791 të pandehur dhe është ngritur akuza në gjykatë për 606 të pandehur, ndërkohë që për vitin 2012 janë regjistruar 255 të pandehur dhe është ngritur akuzë për 171 të tillë. Janë dënuar nga gjykata 405 të pandehur për vitin 2013 ndërsa në vitin 2012 janë dënuar 69 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”.

Ecuria e kësaj vepre penale (e shtuar me ligjin 23/2012), për vitet 2012-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 152 % e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal “Dhuna në familje”, në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në familje” për vitin 2013:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të dhunës në familje është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 29 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan 8,8 %, në prokurorinë e shkallës së parë Fier, që përbën 8,5 % të numrit total të

procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 6,4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Berat, që përbën 6,2 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lushnjë e Shkodër, që kanë regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë, që përbën 5,3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë, që përbën 4,7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Krujë, Sarandë e Pukë janë regjistruar rreth 3 % e numrit të procedimeve për këtë veprë në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a “Dhuna në familje”, ku numri më i ulët rezulton në prokuroritë e shkallës së parë Mat e Përmet, dhe nuk ka asnjë procedim të regjistruar për këtë veprë në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë.

LIRIA E BESIMIT

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e X-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal, veprat penale kundër lirisë së besimit:

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 131 Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit	3	1	2	1	1	3	1	1	1	0
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	4	1	3	1	1	3	1	1	1	0

Për këtë grup veprash penale të dhënat statistikore tregojnë se gjatë vitit 2013 janë regjistruar procedime vetëm për veprën penale shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit. Rezulton se janë regjistruar 3 procedime për këtë veprë, është regjistruar 1 i pandehur, i është dërguar gjyqit 1 procedim dhe është ngritur akuza në gjykatë për një të pandehur. Krahasuar me vitin 2012 vërehet tendencë në ulje për këtë grup veprash penale.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

VJEDHJA E PASURISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike është 41,3 %, ndërsa në vitin 2012 ka qenë 42,03 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e parë të Kreut të tretë të Kodit Penal Vjedhja e Pasurisë.


VJEDHJA E PASURISË ¹¹	2012					2013				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 134 Vjedhja	8377	1593	2514	2387	2129	10411	1448	2116	2021	1906
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	110	29	56	47	47	128	50	94	69	61
Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursim.	3	1	0	2	4	5	3	2	5	4
Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	354	162	134	162	170	365	112	141	115	72
Neni 137 /a	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës	2	0	0	0	0	6	1	6	1	1
Neni 139 Vjedhja me dhunë	280	80	165	149	119	403	83	160	139	109
Neni 140 Vjedhja me armë	131	24	68	53	44	101	23	60	46	36
Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen	20	4	3	6	7	5	4	6	6	4
Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje	3	2	4	4	6	5	1	6	2	0
Totali	9280	1895	2944	2810	2526	11430	1725	2591	2404	2193

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 23 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi ulje prej 9 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 12 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 14 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 13 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale të vjedhjes së pasurisë për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:

¹¹ Vecuar nga ky grup dhe trajtuar me vete trafiket



Për vitin 2013 veprat penale të këtij seksioni krahasuar me vitin 2012 paraqesin tendencat si vijon:

- Neni 134 “Vjedhja”, ka rritje prej 24 % krahasuar me vitin 2012;
- Neni 135 “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, ka rritje prej 16 % krahasuar me vitin 2012;
- Neni 136 “Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit” ka rritje prej 66 % krahasuar me vitin 2012, por pesha e kësaj vepre në këtë grup veprash është 0,04 %;
- Neni 137 “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” ka rritje prej 3 % krahasuar me vitin 2012;
- Neni 138 “Vjedhja e veprave të artit e kulturës” është trefishuar, në 6 procedime regjistruara në vitin 2013, ndaj 2 procedime të vitit 2012;
- Neni 139 “Vjedhja me dhunë” ka rritje prej 43 % krahasuar me vitin 2012;
- Neni 140 “Vjedhja me armë” ka ulje prej 22 % krahasuar me vitin 2012;
- Neni 141 “Vjedhja me pasojë vdekjen” ka ulje prej 75 % krahasuar me vitin 2012;
- Neni 142 “Sigurimi i mjeteve për vjedhje” ka rritje prej 66 % krahasuar me vitin 2012, por pesha e kësaj vepre në këtë grup veprash është 0,04 %;

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total kanë qenë 2591 të pandehur në hetim, ndersa në vitit 2012 në total kanë qenë 2944 të pandehur në hetim. Pra, në këtë tregues vihet re ulje prej 12 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 494 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj (ulje prej 39 % e këtij treguesi në krahasim me vitin 2012) dhe 9 femra, të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 90 femra dhe 1998 meshkuj (ulje prej 15 % e këtij treguesi për vitin 2012).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 1931 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 605 me arsim të mesëm dhe 55 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 31 të pandehur përkundrejt 130 të tillë në vitin 2012. Nga këta, 1 i pandehur është funksionar, 10 të pandehur janë nëpunës të thjeshtë, 1 nëpunës është i nivelit të lartë, 18 nëpunës të nivelit të ulët.

Nga sektori privat janë regjistruar 247 të pandehur dhe të papunë 2313 (rritje prej 11 % në krahasim me vitin 2012). Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 1737 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 854 prej tyre në komuna.

Pra ky fenomen është i përhapor si në zonat rurale ashtu dhe në ato urbane, por tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2190 të pandehur, 195 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale (rritje prej 73, 26 % në krahasim me vitin 2011), ndërsa 189 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme (rritje prej 35,97 % në krahasim me vitin 2012).

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vjedhja


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” është 91 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 90 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, në vitin 2013, prej 28 % në krahasim me vitin 2012.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë, grafiku më poshtë paraqet të dhënat statistikore si vijon:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vjedhjes është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 35 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë që përbën 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 6,8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 5 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 4 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 3,2 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Tropojë, Pukë, Pogradec, Përmet, Mat, Lushnje, Lezhe, Kurbin, Kukës, Krujë, Kavajë, Gjirokastër e Dibër kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”.

Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë është 1,11 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 1,18 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, në vitin 2013, prej 16 % në krahasim me vitin 2012.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2013, rezulton se:



Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj veprë janë prokuroria e shkallës së parë Tiranë që përbën 37,5 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier me 14,8 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Elbasan me 12 % të totalit të procedimeve të regjistruara. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 6 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Berat me 4,7 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Shkodër 3,9 % të totalit të procedimeve dhe prokuroria e shkallës së parë Lezhë 3,1 % të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lushnje, Pogradec, Tropojë e Vlorë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2,5 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Mat, Përmet, Pukë e Sarandë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”.

Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë është 0,04 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 0,03 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 136 i Kodit Penal “Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit”, në vitin 2013, prej 66,66 % në krahasim me vitin 2012.

Vjedhja me dhunë


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2013, 3,5 % ndërkohë që për vitin 2012 ka qenë 1,18 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore se në vitin 2013 ka rritje prej 44 % në krahasim me vitin 2012 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 139 “Vjedhja me dhunë” i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale gjatë vitit 2013 sipas prokurorive të shkallës së parë:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vjedhjes me dhunë është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 51,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 17,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier që përbën 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 4,7 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnje, Pogradec, Pukë, Sarandë e Shkodër kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2,5 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Përmet e Tropojë nuk rezultojnë asnjë procedim i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”.

Vjedhja me pasojë vdekjen

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2013 është 0,04 %, që tregon ulje ndaj 0,21 % të peshës që zinte kjo veprë për vitin 2012.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009 - 2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal “Vjedhja me pasojë vdekjen”, në vitin 2013, prej 75 % në krahasim me vitin 2012.

MASHTRIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 3,1 %, ndërsa në vitin 2012 është 2,44 %. Pra, vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Skesionin e II, të Kreut të Tretë të Kodit Penal “Mashtrimet”:


MASHTRIMET	2012					2013				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand . Per gjykim	Nr. Pandenu ar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenu ar
Neni 143 Mashtrimi	472	328	216	339	428	584	235	298	255	245
Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale						3	0	0	0	0
Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/2 Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/3 Manipulimi i cmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 143/a/4 Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/6 Fshehja e pronësisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshëm i titujve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 144 Mashtrimi në subvencione	0	0	0	0	7	1	0	0	0	0
Neni 144/a						1	0	0	0	0
Neni 145 Mashtrimi në sigurime	50	23	46	25	22	231	61	106	61	39
Neni 146 Mashtrimi në kredi	9	5	6	8	10	19	12	14	12	0
Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 149 Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit	0	0	0	0	0	5	1	1	1	0
Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale	6	1	10	1	0	15	6	10	6	5
Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërcuesit	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	539	357	278	373	467	859	315	429	335	289

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 59 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të mashtrimit në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi ulje prej 11 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 54 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 10 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 38 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale të mashtrimeve për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 429 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 278 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 54 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 5 të pandehur të mitur meshkuj të pandehur, të rritur (mbi 18 vjeç) 72 femra, dhe 352 meshkuj të pandehur në vitin 2013.

Përsa i përket arsimit të të pandehurve rezulton se 8 të pandehur janë me arsim të lartë, 128 me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër rezultojnë me arsim deri në 9-vjeçar.

Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 6 shtetas të huaj.

Rezulton se 223 të pandehur kanë vendbanimin në qytet; ndërsa 206 prej tyre në komuna. Pra diferenca e të pandehurve sipas vendbanimit nuk ka ndonjë ndryshim të madh zonat urbane me ato rurale.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se vetëm 15 prej tyre janë përsëritës në krime.


Bazuar në sa më sipër, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e këtyre veprave penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mashtrimi


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 68 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 87,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, në vitin 2013, prej 24 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, gjatë vitit 2013.




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, edhe për këtë veprë penale numri më i madh i procedimeve të regjistruara është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 33 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër që përbën 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat që përbën 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Vlorë që përbëjnë 6,7 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë që përbën 5,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier që përbën 4,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 3,9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnje, Mat, Pogradec e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2,5 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Përmet, Pukë e Tropojë nuk rezulton asnjë procedim i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”.

Mashtrimi në sigurime


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 26,8 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 9,27 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë);



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, nga 50 procedime penale të regjistruara në vitin 2012 në 231 në vitin 2013 , e shprehur në përqindje rritja rezulton 362 %.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, gjatë vitit 2013.



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të mashtrimit në sigurime është në prokuroritë e shkallës së parë Kukës, që përbën 49 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 15,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Pukë që përbën 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë që përbën 5,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 4,8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnje, Mat, Pogradec, Shkodër e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Kurbin, Përmet e Sarandë, nuk rezulton asnjë procedim i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, ndërsa prokuroritë e tjera kanë numër të përafërt procedimesh të regjistruara për këtë veprë.

Mashtrimi në kredi

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër mashtrimit është 2,2 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 1,7 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal “Mashtrimi në kredi”, në vitin 2013, prej 111 % në krahasim me vitin 2012.

Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër mashtrimit është 0,6 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 0 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal "Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit".

SHKATËRRIMI I PRONËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike, është 4 %, ndërsa për vitin 2012 ka qenë 4,58 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e III, të Kreut të III të Kodit Penal:


SHKATËRRIMI I PRONËS	2012					2013				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	384	66	123	82	76	471	76	168	106	73
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	383	29	53	34	22	315	22	32	24	32
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	82	3	12	4	5	87	0	7	0	0
Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmbytje	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera	3	0	0	0	0	11	0	6	2	0
Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve	15	3	3	6	3	11	4	5	4	6
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik	21	2	6	3	1	112	5	7	7	5
Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes	7	2	3	3	2	4	1	2	1	1

Neni 158	3	2	3	3	0	7	2	3	2	1
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit	57	30	44	39	25	43	13	25	13	5
Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore	7	0	1	0	0	6	0	0	0	0
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia	51	14	18	18	18	27	6	13	8	7
Neni 162 Përplasja e mjeteve të transportit masiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1013	151	266	192	152	1095	129	268	167	130

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka rritje në krahasim me vitin 2012, në masën 8 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të shkatërrimit të pronës. Ndërkaq kemi ulje prej 14 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e lehtë e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 0,7 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 13 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 14,5 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale të shkatërrimit të pronës për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 268 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 266 të pandehur në hetim.

Nga të pandehurit, 11 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 8 femra dhe 249 meshkuj (rritje prej 8.2% në krahasim me vitin 2012).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 210 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, 55 me arsim të mesëm dhe 3 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur.

Nga sektori privat janë regjistruar 56 të pandehur (ulje prej 46% për qind) në krahasim me vitin 2013 dhe të papunë 212 (ulje prej 10,57% në krahasim me vitin 2012). Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 165 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 103 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 263 të pandehur, vetëm 5 prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shkatërrimi i pronës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 43 % për vitin 2013, ndërkohë që për vitin 2012 ka qenë 38 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës”, në vitin 2013, prej 22,6 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara në vitin 2013, për këtë veprë sipas prokurorive të shkallës së parë:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të shkatërrimit të pronës është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier që përbën 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Sarandë që përbëjnë 5,4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat që përbën 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi; në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër, Lushnjë e Durrës që përbëjnë rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës”.

Shkatërrimi i pronës me eksploziv


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” për vitin 2013 është 7,9 %. Ky tregues për vitin 2012 ka qenë 8 % .

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje në vitin 2013, e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, prej 6 % në krahasim me vitin 2012.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2013, rezulton se:



Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroria e shkallës së parë Tiranë që përbën 31 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Krujë me 15 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Shkodër me 10% të totalit të procedimeve të regjistruara, prokuroria e shkallës së parë Dibër, Durrës e Sarandë me 5,7 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Elbasan me 4,5 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Vlorë e Gjirokastër me 3,5 % të totalit të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Fier, Korçë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnje, Mat, Pogradec, e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2,5 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Berat, Kavajë, Përmet e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”.

Shkatërrimi i rrjetit elektrik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 10 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012, pesha specifike e kësaj vepre është 2,07 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit elektrik”. Kjo vepër në vitin 2012 regjistronte 21 procedime, ndërsa në vitin prej në vitin 2013, janë regjistruar 112 procedime penale, e shprehur në përqindje rritja rezulton 433%.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2013, rezulton se:



Siç vërehet edhe në paraqitjen grafike, të dhënat statistikore tregojnë se peshën më të madhe të kësaj vepre me 87 procedime ose 77,6 % e ka prokuroria e shkallës së parë Elbasan. Në prokuroritë e tjera numri i procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal “Shkatërimi i rrjetit elektrik”, varion nga zero procedim i regjistruar deri në 5 të tilla.

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike, është 0,09 %, për vitin 2012 ka qenë 0,4 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IV të Kreut të III të Kodit Penal “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare”.


VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 163 Përpilimi i deklaratave të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 164 Shpërdorimi i kompetencave	5	1	1	1	1	7	1	1	1	2
Neni 165 Falsifikimi i nënshkrimeve	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Neni 166 Emetimi i parregullt i aksioneve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 167 Mbajtja e padrejtë e dy cilësive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 168 Dhënia e informacioneve të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 169 Zbulimi i sekreteve të shoqërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 170 Mosbërja e shënimeve të detyrueshme	4	3	3	3	0	2	0	0	0	0
Neni 170/a Punësimi i paligjshëm	79	34	41	37	19	15	5	10	5	2
Neni 170/b Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	89	38	45	41	20	24	7	11	7	5

TENDENCA

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka ulje të ndjeshme të të gjithë treguesve të lidhur me procedimin penal. Kështu, në vitin 2012 janë regjistruar 89 procedime penale për këtë grup veprash penale, ndërkohë në vitin 2013 janë regjistruar 24 procedime penale, ose 73 % më pak. Procedimet e dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012 janë ulur me 81 % (7 procedime në vitin 2013 kundrejt 38 procedime në vitin 2012). Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje me 75 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt vitit 2012, ulje e numrit të të pandehurve për të cilët është ngritur akuza në gjykatë në vitin 2013 me 82 %, përkundrejt vitit 2012, dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar me 75 % për vitin 2013, përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera në shoqëritë tregtare për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 11 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 45 të pandehur në hetim. Pra kemi një ulje me 75 % në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 9 meshkuj kanë qenë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 2 femër.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 2 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, 6 me arsim të mesëm dhe 3 të pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur

Nga sektori privat janë regjistruar 11 të pandehur, përkundëjt 31 të tillë të regjistruar në vitin 2012.

Rezulton se 10 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 1 prej tyre në komunë. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë rezultojnë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Punësimi i paligjshëm


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare” është 62 % ndërkohë që për vitin 2012 ka qenë 88,76 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”. Kështu në vitin 2013, janë regjistruar 15 procedime penale kundëjt 79 procedime penale të regjistruara në vitin 2012, ose 81 % më pak.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara gjatë vitit 2013:



Sikurse vërehet edhe nga paraqitja grafike kjo veprë është regjistruar vetëm në prokuroritë e shkallës së parë më të mëdha si Tiranë, 4 procedime penale, prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Korçë 3 procedime penale, prokuroria e shkallës së parë Fier, 2 procedime penale, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Durrës e Lushnje kanë regjistruar nga 1 procedim penal dhe në prokuroritë e tjera nuk është regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal "Punësimi i paligjshëm".

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike është 0,07 %, ndërsa për vitin 2012 është 0,14 %, për vitin 2012. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:

V.P. NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE E FINANCIARE	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 170/c	21	11	17	13	6	5	3	4	3	4
Neni 170/ç	10	9	9	9	11	15	11	13	14	7
Totali	31	20	26	22	17	20	14	17	17	11

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 35 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi ulje prej 30 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 34 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 22 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 35 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,5 %, ndërsa për vitin 2012 është 0,9 %, për vitin 2012. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:


KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE	2012					2013				
	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar	1	0	1	1	0	3	1	1	1	0

Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	20	6	14	10	3	22	11	16	15	15
Neni 173 Kontrabanda me mallra të licencuar	1	0	1	0	0	7	1	6	1	1
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	81	39	52	49	53	48	23	32	27	29
Neni 175 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore	8	0	10	0	0	1	0	0	2	0
Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	63	42	53	45	48	55	9	37	9	9
Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë	11	4	9	4	6	4	1	5	2	2
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	15	12	14	13	2	5	4	4	4	6
TOTALI	201	103	154	122	112	145	50	101	61	62

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 28 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi ulje prej 51 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 34 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 50 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 44,6 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e doganave për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 101 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 154 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 34% e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 1 është i pandehur i mitur mashkull; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 97 meshkuj dhe 3 femra.

Rezulton 1 shtetas i huaj i pandehur për këtë grup veprash penale në vitin 2013, përkundrejt vitit 2012 kur janë regjistruar 6 të pandehur të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 11 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, 79 me arsim të mesëm dhe 11 të pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 5 të pandehur përkundrejt 12 të tillë në vitin 2012. Të gjithë të pandehurit nën këtë seri statistikore janë “nëpunës të thjeshtë”.

Nga sektori privat janë regjistruar 96 të pandehur (rritje prej 5.4% për qind) në krahasim me vitin 2012

Rezulton se 82 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 19 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 100 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e krimeve në fushën e doganave është 15 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 10 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, në vitin 2013, prej 10 % në krahasim me vitin 2012.

Kontrabanda me mallra të tjera


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” është 33 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 40 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”, në vitin 2013, prej 40 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të kësaj veprë sipas prokurorive të shkallës së parë:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kontrabandës me mallra të tjera është në prokurorinë e shkallës së parë Durrës, që përbën 27 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë, ku janë regjistruar 14,5 % e procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Sarandë e Tiranë ku janë regjistruar 12 % e procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë ku janë regjistruar 8,3 % e procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Dibër ku janë regjistruar 6% e procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Fier e Shkodër kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 4 % të totali të procedimeve, prokuroritë Kavajë, Kukës, Përmet, Pogradec e Tropojë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 2 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Elbasan, Krujë, Kurbin, Lezhë, Lushnje, Mat, Pukë e Vlorë nuk kanë regjistruar për vitin 2013 asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.

Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore

Në grupin e krimeve në fushën e doganave vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal “Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”, në vitin 2013 ku është regjistruar vetëm një procedim ndërsa në vitin 2012 janë regjistruar 8 procedime penale.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë


Për vitin 2013, tendencë në ulje paraqet edhe numri i procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”. Janë regjistruar 12,7 % më pak procedime krahasuar me vitin 2012.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” për vitin 2013 është 38 % ndërsa për vitin 2012 është 31,34 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi procedimet penale që janë regjistruar në vitin 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 178 “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë” i Kodit Penal:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kontrabandës me mallra të tjera është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë ku janë regjistruar 18 procedime penale, ose 33 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër ku janë regjistruar 15 procedime ose 27 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë ku janë regjistruar 5 procedime ose 27 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Pogradec e Elbasan ku janë regjistruar nga 4 procedime ose 7 % të totalit të procedimeve penale. Prokuroritë e shkallës së parë Berat e Kavajë kanë regjistruar 2 procedime ose 3,6 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Pukë, Tropojë e Vlorë kanë regjistruar nga 1 procedim penale ose 1,8 % të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Fier, Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lushnje, Mat, Përmet e Sarandë nuk kanë regjistruar gjatë vitit 2013 asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal.

Ruajta apo depozitimi i mallrave kontrabandë

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e krimeve në fushën e doganave është 2,7 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 5,5 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal “Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë”, në vitin 2013, prej 64 % në krahasim me vitin 2012.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike, është 0,3 %, ndërsa për vitin 2012 është 0,59 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu III, Seksionin e VI “Falsifikimi i Monedheve dhe Letrave me Vlerë” i Kodit Penal.

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT E TATIMET	2012					2013				
	Nr. Proecd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proecd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	71	8	14	8	8	54	1	27	1	0
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	58	28	39	28	21	30	21	20	21	26
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore	3	0	0	0	2	0	0	0	0	0
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 182/a						0	0	0	0	0
Totali	132	36	53	36	31	84	22	47	22	26

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 36 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi ulje prej 38 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re sërish ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 11 %, ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 38 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 16 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 47 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 53 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 11 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, të rritur (mbi 18 vjeç) janë 3 femra dhe 44 meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 16 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 29 me arsim të mesëm dhe 3 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim e mesëm.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori privat janë regjistruar 30 të pandehur.

Rezulton se 40 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 7 prej tyre në komuna.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurit janë të pa dënuar.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Fshehja e të ardhurave


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 64 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 53 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”, në vitin 2013, prej 23 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për këtë veprë në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2013 në shkallë vendi:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të fshehjes së të ardhurave është në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë ku janë regjistruar 18 procedime, që përbëjnë 33 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan, ku janë regjistruar 12 procedime ose 22 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë, Kurbin e Tiranë ku janë regjistruar nga 4 procedime ose 7,4 % e procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Durrës, Dibër, Korçë, Kukës, Shkodër e Tropojë kanë regjistruar numrin më të ulët të procedimeve dhe ndërkaq prokuroritë Fier, Gjirokastrë, Krujë, Lushnje, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Vlorë për vitin 2013 nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”.

Mospagimi i taksave dhe i tatimeve


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 35,7 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 44 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve”, në vitin 2013, prej 48 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për këtë veprë në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2013 në shkallë vendi:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të mospagimit të taksave dhe tatimeve është 9 procedime në prokurorinë e shkallës së parë Berat, 5 procedime në prokurorinë e shkallës së parë Korçë e 4 procedime në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Lezhë, Lushnjë, Mat, Pukë, Sarandë, Shkodër e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

FALSIFIKIMI I MONEDHEVE DHE LETRAVE ME VLERË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,2 % ndërsa për vitin 2012 është 0,31 %. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu III, Seksioni VII “Falsifikimi i Monedheve dhe Letrave me Vlerë” i Kodit Penal:

FALSIFIKIMI I MONEDHEVE DHE LETRAVE ME VLERË	2012					2013				
	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
Neni 183 Falsifikimi i monedheve	62	13	18	21	26	51	10	32	23	12
Neni 184 Falsifikimi i letarve me vlerë	6	0	4	0	1	7	3	1	3	0
Neni 185 Prodhimi i mjeteve për falsifikim	1	0	1	0	0	1	0	0	0	1
TOTALI	69	13	23	21	27	59	13	33	26	13

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 14 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Falsifikimi i monedheve dhe i letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 43 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 24 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 52 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të monedheve dhe letrave me vlerë për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 33 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 23 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 43 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 2 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) kanë qenë 4 femra dhe 27 meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 19 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, 13 me arsim të mesëm dhe 1 i pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve.

Rezulton se 25 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 8 prej tyre në komuna. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 32 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i monedheve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i monedheve dhe i letrave me vlerë” është 86 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 90 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedheve”, në vitin 2013, prej 18 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedheve”:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 43 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 15,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 11,7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 7,8 % të numrit total të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 5,8 % të numrit total të procedimeve dhe prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Fier, Gjirokastër, Korçë e Lushnje kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedheve”.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike, është 3,2 %, ndërsa për vitin 2012 është 5,5 %. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII të Kreut të III të Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE	2012					2013				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	499	173	184	241	336	501	153	162	219	194


Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore	36	14	15	16	23	36	12	23	15	16
Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore	51	52	53	52	89	13	10	14	10	18
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave	396	110	147	124	152	186	117	96	122	117
Neni 190 Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	198	113	144	132	78	108	66	68	72	69
Neni 191 Falsifikimi i akteve të gjendjes civile	33	11	14	15	10	46	5	19	6	3
Neni 192 Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve	1	0	0	0	1	2	1	0	1	1
Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve	1	0	0	0	0	2	1	3	3	3
TOTALI	1215	473	557	580	689	894	365	385	448	421

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 26 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2012. Ulje ka edhe numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012, me 23 %. Në lidhje me të pandehurit, vërehet sërish ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 31 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 23 % dhe sërish ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 39 % përkundrejt vitit 2012.

Një tendencë e tillë është rrjedhojë e rritjes së cilësisë së dokumentave, si edhe për shkak të shtimit të elementëve të sigurisë. Gjithashtu, subjekte të kësaj vepre penale janë kryesisht shtetas kosovarë që blejnë këto pasaporta, apo persona me precedent penalë.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 385 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë

557 të pandehur në hetim. Pra, në këtë tregues vihet re ulje prej 31 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 12 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe 1 femër, të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 82 femra dhe 290 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2012 rezulton ulje e të pandehurve meshkuj të mitur prej 37 %.

Në vitin 2013 rezultojnë 69 shtetas të huaj të pandehur për këtë grup veprash penale, përkundrejt 87 të tillë në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 20,6 % e këtij treguesi në vitin 2012 në krahasim me vitin 2012.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 120 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 185 me arsim të mesëm dhe 80 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, dhe një pjesë e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim të mesëm.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 45 të pandehur. Nga këta, 1 i pandehur është funksionar, 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të lartë, 5 të pandehur janë nëpunës të nivelit të mesëm; 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të ulët dhe 1 i pandehur është i nivelit ekzekutues, 36 të pandehur janë nëpunës të thjeshtë.

Nga sektori privat janë regjistruar 204 të pandehur dhe pjesa tjetër e të pandehurve të papunë.

Rezulton se 257 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 128 të pandehur në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më pare.


Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i dokumentave


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 56 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 41 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet rritje e lehtë e numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012, me 0,4 %.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 33 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë Elbasan e Shkodër kanë regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Korçë kanë regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnjë, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroria e shkallës së parë Sarandë, nuk ka regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”.

Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i Dokumenteve” për vitin 2013 është 20 %, ndërkohë që vitin 2012 është 32,6 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, në vitin 2013, me një shifër prej 53 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, me 36 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 19 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 16 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 7,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 5,3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Korçë, Kukës, Kurbin Lezhë, Lushnje, Pogradec e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Mat, Përmet, Pukë e Sarandë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave”.

Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 12 % për vitin 2013, ndërkohë që për vitin 2012 rezulton 16 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore, vërehet ulje e ndjeshme e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, në vitin 2013, prej 45 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, me 20,4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Gjirokastrë ka regjistruar 17 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 16 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 8,3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 3,7 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lushnje, Përmet, Pogradec Sarandë e Shkodër kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi ndërkaq prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Lezhë, Mat, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”.

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJRAVE TË FATIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2,7 %, ndërsa për vitin 2012 është 1,1 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e III, seksioni X i Kodit Penal “Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit”.

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT	2012					2013				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 197 Organizimi i llotarive te palejuara	240	158	166	160	123	729	106	311	107	80
Neni 197/a Paracaktimi i rezult. Ne garat sportive	1	0	0	0	0	1	1	0	1	0
Neni 197/b Shtremberimi i konkureses ne garat sportive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 198 Venia ne dispozicion e lokaleve per lojra te palejuara	4	1	0	1	0	17	1	5	2	1
Totali	245	159	166	161	123	747	108	316	110	81

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje të madhe prej 205 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit, në krahasim me vitin 2012. Ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012 ka pësuar ulje me 32 %. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 90 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit me 31 %. Ulje ka numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata me 34 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale të zhvillimit të palejuar të lojrave të fatit për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 316 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 166 të pandehur në hetim. Pra, në këtë tregues vihet re rritje prej 90 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 311 kanë qenë të pandehur meshkuj të rritur (mbi 18 vjeç) dhe 3 femra dhe 2 meshkuj të mitur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 180 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 124 me arsim të mesëm dhe 12 të pandehur me arsim të lartë.

Rezulton se 268 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 48 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Organizimi i llotarive të palejuara


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit” është 97,56 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 97,95%.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”, në vitin 2013, me 203 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara (në përqindje) në vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuar”.



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Fier kanë regjistruar 7,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 6,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 5,9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Vlorë, Lushnjë, Dibër e Durrës kanë regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi në vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”.

VEPRA PENALE QË CËNOJNË REGJIMIN JURIDIK TË TOKËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike është 3,6 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 0,9 %. Pra vihet re një rritje e ndjeshme treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksioni XI, të Kreut të II të Kodit Penal “Vepra Penale që çënojnë regjimin juridik të tokës”.

REGJIMI JURIDIK I TOKËS	2012					2013				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	6	2	2	2	4	18	4	5	4	1
Neni 199/a Ndertimi i paligjshem	129	45	48	45	38	876	213	389	221	50
Neni 200 Pushtimi i tokës	66	11	26	17	11	96	18	46	22	5
Totali	201	58	76	64	53	990	235	440	247	56

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 392 % të numrit të procedimeve të regjistruara për Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës, në krahasim me vitin 2012 dhe rritje prej 305 % të procedimeve të dërguara për gjykim. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje prej 478 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 286 % dhe rritje shumë të lehtë të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 5,6 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër regjimit juridik të tokës për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 440 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 76 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 478 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 13 femra dhe 427 meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 87 janë me arsim të mesëm, 14 të pandehur me arsim të lartë dhe pjesa tjetër me arsim 9 vjeçar. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim të mesëm.

Nga sektori privat janë regjistruar 64 të pandehur (rritje prej 120 % për qind) në krahasim me vitin 2012, ne sektorin shtetëror 9 dhe pjesa tjetër e të pandehurve janë të papunë 43. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 56 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 34 % prej tyre në komuna.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të padënuar më parë, vetëm 6 të pandehur janë të dënuar.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ndërtimi i paligjshëm


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që çenojnë regjimin juridik të tokës është 88 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 64 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm”, në vitin 2013, prej 579 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2013 për këtë veprë penale:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Elbasan, që përbën 15,4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 12 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 7,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Tiranë e Korçë kanë regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Pogradec ka regjistruar 5,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Kukës ka regjistruar 4,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lushnje ka regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Mat, Përmet, Pukë, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3,5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi gjatë vitit 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm”.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundëjt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike, është 0,9 % ndërkohë që për vitin 2012 është 1,4 %. Pra vihet re ulje e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2013.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT	2012					2013				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 201 Ndotja e ajrit	5	0	0	0	0	12	0	10	0	0
Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 203 Ndotja e ujërave	2	0	2	0	0	2	1	0	1	2
Neni 204 Peshkim i ndaluar	15	9	13	11	10	13	5	15	9	8
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	167	71	73	73	71	191	80	141	82	22
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë	6	1	2	1	1	21	1	4	1	1
Neni 206/a Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	106	1	5	1	0	13	0	0	0	1
Neni 206/b Shkatërrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve	3	1	2	1	1	3	0	0	0	0
Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	305	83	97	87	83	255	87	170	93	34

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 16 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra Penale Kundër Mjedisit” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi rritje prej 4,8 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 75 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 6,9 % dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 59 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër mjedisit për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 170 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 97 të pandehur në hetim. Pra, në këtë tregues vihet re rritje prej 75 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, të rritur (mbi 18 vjeç) asnjë femër dhe 170 meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se, 139 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, 29 me arsim të mesëm dhe 2 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Nga sektori privat janë regjistruar 58 të pandehur (rritje prej 16% për qind) në krahasim me vitin 2012 dhe të papunë 112 (rritje prej 187% në krahasim me vitin 2012). Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 36 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 134 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat rurale.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 165 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 4 është përsëritës për të njëjtën vepër penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Prerja e paligjshme e pyjeve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 75 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 55 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”, në vitin 2013, prej 14 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2013:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, prokuroritë e shkallës së parë Pogradec, Elbasan, Dibër, Korçë e Lezhë kanë nga 16 % deri në 12 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi për këtë veprë. Prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 5,8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 3,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Durrës, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Lushnje, Mat, Kurbin, Përmet, Pukë, Tiranë, Vlorë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Sarandë e Kukës nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”.

Shkatërrimi me zjarr i pyjeve

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 5 % për vitin 2013, ndërkohë që për vitin 2012 ka qenë 35%.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 206/a i Kodit Penal “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve”, në vitin 2013, prej 88 % në krahasim me vitin 2012.

KRIME KUNDËR PAVARËSISË E RENDIT KUSHTETUES dhe KRIME QË CËNOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA

Pesha specifike që zënë krimet kundër rendit kushtetues dhe krimet që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,01%.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara në lidhje me këto vepra:

KREU V- VI	2012					2013				
	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
V.P. kundër Pavarësisë e Rendit Kushtetues	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
V.P. që çënojnë Marrëdhëniet me Shtetet e tjera	3	2	2	2	1	2	1	1	1	1
Totali	3	2	2	2	1	3	1	2	1	1

VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE

VEPRA PENALE ME QËLLIME TERRORISTE	2012					2013				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
Neni 230 Vepra me qëllime terroriste	2	1	0	5	4	3	0	0	0	1
Neni 230/a Financimi i terrorizmit	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/b Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/c Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/ç Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 231 Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 232 Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 232/a Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 232/b Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 233 Krijimi i turmave të armatosura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234 Prodhimi i armëve luftarake	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234/a Organizata terroriste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234/b Banda e armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	4	1	1	5	4	4	0	0	0	1

Pesha specifike që zënë veprat me qëllime terroriste në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2013, është 0,01 %.

Tabela e më lart paraqet të dhënat e detajuara në lidhje me këto vepra.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore rezulton se:

Prokuroria për krime të rënda në vitin 2013 ka regjistruar 3 procedime penale për nenin 230 të Kodit Penal “Vepra me qëllime terroriste”, ndërkohë që për këtë vepër në 2012 kanë qenë regjistruar 2 procedime penale.

Për nenin 232/a “Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste” për vitin 2013 është regjistruar 1 procedim penal, dhe po kaq ka qenë ky tregues edhe për vitin 2012.

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike, është 2 %, ndërsa për vitin 2012 ka qenë 1, 86 %. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e VIII, “Krime Kundër Autoritetit të shtetit”.

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT	2012					2012				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	31	10	14	11	18	42	23	46	29	14
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	136	87	161	123	122	195	155	278	222	89
Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës	109	62	90	72	73	114	79	125	99	72
Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës	23	8	18	9	7	30	8	18	8	3
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik	106	72	99	86	74	164	107	151	120	62
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore	0	0	0	0	0	1	1	1	1	1
Neni 245/2 Përfshirja nga vuajtja e dënimit	0	0	0	0	0					
Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore	4	2	1	9	4	8	4	6	5	0
Neni 246/a Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe I shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës	2	0	2	0	0	2	1	2	1	0
Totali	411	241	385	310	298	556	378	627	485	241

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 35 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër autoritetit të shtetit” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi rritje prej 56,8 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 63 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 56 % dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 19 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër autoritetit të shtetit për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 627 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 385 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 63 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit, 10 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj (ulje prej 61 % në krahasim me vitin 2012) dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 15 femra dhe 602 meshkuj.

Në këtë grup veprash janë dhe 2 të pandehur shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 350 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, 220 me arsim të mesëm dhe 57 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 39 të pandehur (që do të thotë rritje prej 225 % në krahasim me vitin 2012).

Nga sektori privat janë regjistruar 256 të pandehur (rritje prej 153 % për qind) në krahasim me vitin 2012 dhe të papunë 332.

Rezulton se 450 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 177 prej tyre në komuna. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 580 të pandehur, vetëm 42 prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 5 për të njëjtën vepër penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër autoritetit të shtetit” është 35 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 33 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, në vitin 2013, prej 43 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2013:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 35 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 6,7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Korçë e Vlorë kanë regjistruar 5,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 4 % të procedimeve penale në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kukës, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë, Shkodër e Tropojë kanë regjistruar në vitin 2013, një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve ndërkohë që prokuroria e shkallës së parë Kurbin nuk ka regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.

Mosbindja ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë së rendit publik


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër autoritetit të shtetit” është 29 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 25,8 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësve të policisë së rendit publik”, në vitin 2013, prej 55 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2013:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 27 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 11,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Elbasan, Berat, Kavajë, Vlorë e Gjirokastrë kanë regjistruar nga 4% deri 6 % të numrit total të

procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Krujë, Fier, Shkodër kanë regjistruar 3 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Lushnjë, Mat, Përmet, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar në vitin 2013, numrin më të ulët të procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,8 % ndërsa në vitin 2012 pesha e kësaj vepre ka qenë 1,9 %. Pra, vihet re ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu VIII, Seksioni II, Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik”.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK	2012					2013				
	Nr. Proc. d. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. d. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 248 Shperdorim detyre	363	71	121	108	131	455	64	171	124	78
Neni 248/a Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhenies fund te tij	2	0	0	0	0	2	1	1	1	1
Neni 70 KPU Shperdorim detyre	4	1	2	1	2	5	1	0	1	0
Neni 250 Kryerja e Veprimeve arbitrare	31	5	15	10	10	37	3	15	4	7
Neni 251 Mosmarrja e masave per te nderprere gjendjen e paligjshme	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 252 Mbajtja ne burg pa vendim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 253 Shkelja e barazise se shtetasve	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 254 Shkelja e paprekshmerise se baneses	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtesise se korrenspondences	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 256 Shperdorim i kontributeve te dhena nga shteti	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 257 Perfitim i paligjshem i interesave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 257/a Refuzimi per deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë	7	9	4	9	8	0	0	0	0	0
Neni 258 Shkelja e barazize ne tendera apo ankande publike	10	2	4	6	0	12	5	9	9	6
TOTALI	422	88	146	134	151	514	76	197	141	93

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 22 % të numrit të procedimeve të regjistruara për Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik”, në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi ulje prej 13 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 35 %, një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 5 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 38 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 197 të pandehur në hetim, ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 146 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 35 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 106 të pandehur (që do të thotë rritje prej 55.8 % në krahasim me vitin 2012). Nga këta, 9 të pandehur janë funksionarë, dhe 6 i pandehur është nëpunës i nivelit të lartë; 33 të pandehur janë nëpunës të nivelit të mesëm; 18 të pandehur janë nëpunës i nivelit të ulët dhe 40 të pandehur janë funksionar të thjeshtë.

Nga sektori privat janë regjistruar 91 të pandehur rritje prej 250% në krahasim me vitin 2012.

Rezulton se 122 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 75 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 197 të pandehur, vetëm 3 prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shpërdorim detyre


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik” është 88,5 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 86 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre”, në vitin 2013, prej 25 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2013:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 24 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Vlorë kanë regjistruar nga 8,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier e Korçë kanë regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Durrës e Berat kanë regjistruar 4,4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lushnje, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, gjatë vitit 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre”.

Kryerja e veprimeve arbitrare


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik” në vitin 2013 është 7 % ndërsa në vitin 2012 pesha specifike e kësaj vepre ka qenë 7,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare”, në vitin 2013, prej 19 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2013:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 35 % të numrit total të

procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë shërndarje pothuajse të njëjtë të regjistrimit të procedimeve ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastër, Krujë, Përmet, Pogradec, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë viti 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare”.

Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë është 2,33 %, ndërsa për vitin 2012 ky tregues ka qenë 2,36 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, në vitin 2013, prej 20 % në krahasim me vitin 2012.

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike, është 15,8 % ndërsa në vitin 2012 ka qenë 14,6 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun VIII, Seksioni III, Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.


VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE	2012					2013				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 261 Pengimi në ushtrimin e së drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar	1	0	0	0	0	1	0	1		0
Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme	21	2	14	8	0	8	5	16	22	6
Neni 263 Organizimi i grumbullimeve e manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 264 Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve	0	0	0	0	0	2	0	2	0	0
Neni 266 Thirrja për urrejtje nacionale	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 267 Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 268 Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 269 Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 270 Rebelimi i të burgosurve	5	3	3	3	1	2	1	2	1	2
Neni 271 Disinformimi i ekipeve të urgjencës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 272 Njoftimi i rremë në organet e rendit	11	3	3	3	0	15	4	8	4	1
Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit	122	29	32	31	24	177	41	60	43	30
Neni 274 Prishja e qetësisë publike	82	40	53	52	36	89	51	73	70	42
Neni 275 Përdor. me keqdashje i thirrj. telefonike	637	66	83	70	40	718	46	124	48	20
Neni 276 Përdorimi pa të drejtë i emblemsë së Kryqit të Kuq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 277 Vetëgjyqësia	167	75	118	95	60	171	80	145	101	50
Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit	821	603	743	671	597	673	395	531	421	378
Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta	111	93	101	95	37	180	134	176	143	112
Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjatës dhe sportive	98	91	94	102	86	112	72	113	82	56
Neni 281 Shkelja e rregullave mbi lendët helmuese	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 282 Shkelja e rregullave mbi lendët plasëse, djegëse dhe radioaktive	5	5	8	8	9	7	4	7	5	1
Neni 282/b Stërvitja për prodhimin dhe përd. e paligjshëm të armëve e lend. të	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

tjera të rrezik.										
Neni 283/b Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përd. e drogës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/b Ndhima në zbuli. e krimeve (shfuqizuar)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/ç Prodhimi, tregëtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 285/a Përshtatja e lokalit për përdorim droge	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0
Neni 285/b Hedhja ose braktisja e shiringave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 286 Nxitja për përdorimin e drogës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 286/a Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 288 Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin	2	0	3	0	0	6	3	3	3	2
Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industr. dhe ushqimorë	11	4	7	4	1	7	2	4	2	2
Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	52	5	16	7	7	50	3	20	3	4
Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	770	356	522	370	329	832	339	695	346	262
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	292	278	286	298	197	1323	1024	1332	1045	519
Neni 292 Shkelja e disiplinës së punës në transport	6	3	4	3	0	5	0	0	0	0
Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit	13	3	7	5	4	15	10	17	23	9
Totali	3230	1660	2098	1826	1429	4394	2214	3329	2362	1496

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një rritje prej 36 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi rritje prej 33 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 57 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 29 % dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 4, 6 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 3329 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 2098 të pandehur në hetim.

Në vitin 2013 rezultojnë 17 shtetas të huaj të pandehur, përkundrajt 14 të tillë në vitin 2012, pra kemi një rritje prej 21.4 % për vitin 2013.

Nga të pandehurit, 245 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe 6 femra, të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 68 femra dhe 3010 meshkuj. Në të gjithë këta tregues vihet re një rritje e konsiderueshme e të pandehurve për vitin 2013 (83.7% rritje për të pandehurit femra)

Janë hetuar 17 të pandehur me shtetësi të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 1932 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 1265 me arsim të mesëm dhe 132 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 25 të pandehur (që do të thotë rritje prej 177 % në krahasim me vitin 2012). 16 të pandehurit janë nëpunës të thjeshtë, 6 niveli i mesëm dhe 3 niveli i ulët.

Nga sektori privat janë regjistruar 808 të pandehur (rritje prej 53 % për qind) në krahasim me vitin 2012 dhe të papunë 2496 (rritje prej 166 % në krahasim me vitin 2012).

Rezulton se 2447 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 882 prej tyre në komuna.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 3072 të pandehur, vetëm 51 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 206 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Largimi nga vendi aksidentit


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 4 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 3,7 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”, në vitin 2013, është 45 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2013.




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 56,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 11,8 %, e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan është regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier është regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë është regjistruar 4,5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Shkodër, Lushnje, Vlorë, Lezhë, Krujë, Kurbin, Mat e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastër, Kavajë, Kukës, Përmet, Poragdec, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”.

Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 16 % për vitin 2013, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 19,7 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, në vitin 2013, prej 13 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2013:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 25,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 8,3 %, e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës është regjistruar 7,7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Shkodër e Vlorë janë regjistruar 6,5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë është regjistruar 4,7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Lushnjë, Lezhë kanë regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet, Poragdec, Pukë, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”.

Vetëgjyqësia


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2013 është 3,9 %, ndërsa për vitin 2012 ka qenë 5 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”, në vitin 2013, prej 2,4 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veçër penale në vitin 2013:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 14,6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 10,5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës

së parë Vlorë është regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 9,3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Durrës janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Kurbin, janë regjistruar përkatësisht 7 % e 6 % numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë është regjistruar 4,7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kukës, Lushnje, Mat, Pogradec, Pukë e Tropojë, kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Përmet e Sarandë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “ Vetëgjyqësia” .

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2013 është 15 %, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 25,4 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” i Kodit Penal në vitin 2013, prej 18 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2013:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 19,8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 9,3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Krujë e Shkodër janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë është regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Vlorë janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier, është regjistruar 5,3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë është regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Kurbin, Kukës, Lushnje, Mat, Pogradec, Pukë e Tropojë, kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3,5 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Përmet e Sarandë është regjistruar numri më i ulët i procedimeve (0,3 % e 0,7 %) për vitin 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “ Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve ushtarake dhe municionit”. Ulja e kësaj vepre penale vjen dhe për shkak të dryshimeve të Kodit penal me ligjin nr.144/2013, ku marzhet e dënimit kanë pësuar rritje të theksuar, gjë e cila ka sjellë dhe uljen e procedimeve për këtë figurë krimi.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2013 është 4 %, ndërkohë që në vitin 2012 ka qenë 3,4 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, në vitin 2013, prej 62 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2013:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 60 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 8,9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës është regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e

shkallës së parë Berat, Dibër e Elbasan janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lushnjë e Pogradec kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Mat, Përmet, Pukë, Sarandë, Tropojë e Vlorë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për vitin 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “ Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2013 është 2,5 %, ndërkohë që në vitin 2012 është 3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, në vitin 2013, prej 14 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2013:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 15% të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë e Vlorë janë regjistruar 5 % deri në 7 %, e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kurbini, Krujë, Lushnjë, Pukë janë regjistruar 4,5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Korçë, Mat, Përmet, Pogradec e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Kukës e Sarandë nuk është regjistruar anjë procedim penal për vitin 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2013 është 19 %, ndërkohë që për vitin 2012 ka qenë 23,8 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, në vitin 2013, prej 8 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë për vitin 2013:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 20,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër është regjistruar 7,7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës, Fier e Korçë janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë është regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Krujë është regjistruar 5,3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë është regjistruar 54,5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lushnjë e Vlorë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kukës, Kurbin, Pogradec e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Mat, Përmet, Pukë e Tropojë është regjistruar numri më i ulët i procedimeve (0,2% – 0,6 %) për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”.

Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2013 është 30 % ndërsa në vitin 2012 ky tregues ka qenë 9 % .

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” në vitin 2013, prej 353 % në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë për vitin 2013:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 21 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 9,5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës është regjistruar 8,3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier është regjistruar 7,8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat e Kavajë janë regjistruar 5,4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Shkodër, Gjirokastër e Korçë, janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Krujë, Kukës, Kurbin, Mat, Sarandë e Vlorë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Përmet, Pukë e Tropojë është regjistruar numri më i ulët i procedimeve (0,1 %) për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur”.

VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2013 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,3 %, ndërsa në vitin 2012 ky tregues ka qenë 0,56 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale.


PASTRIMI I PARAVE	2012					2013				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 287 Produktet e vepres penale ose veprimtarisë kriminale	104	8	26	13	4	70	6	18	12	12
Neni 287/a Llogari anonime	1	1	1	1	0	1		0		
Neni 287/b Pervetesimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale	20	13	39	29	33	14	9	31	28	20
Totali	125	22	66	43	37	85	15	49	40	32

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka një ulje prej 32 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, në krahasim me vitin 2012. Ndërkaq kemi ulje prej 31 % të

procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2012. Edhe në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e treguesve në krahasim me vitin 2012, kështu numri i të pandehurve të regjistruar është ulur 26 %, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është ulur 7 % dhe numrit i të pandehurve të dënuar nga gjykata me 13,5 % përkundrejt vitit 2012.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër pastrimit të parave për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2013 në total janë 49 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2012 në total kanë qenë 66 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 26 % e të pandehurve në hetim në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012.

Nga të pandehurit (mbi 18 vjeç) 1 është femër dhe 48 meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 20 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 24 me arsim të mesëm dhe 5 i pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur.

Nga sektori privat janë regjistruar 29 të pandehur në vitin 2013 dhe 11 të pandehur në vitin 2012. Rezulton se 36 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 13 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 46 të pandehur, vetëm 3 prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprave penale për vitin 2013 është 82 % ndërsa për vitin 2012 ka qenë 83 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Gjatë vitit 2013 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, prej 32% në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2013 për këtë vepër penale:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 24 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 14 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan është regjistruar 13 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës e Lezhë janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 8,6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër është regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë është regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Gjirokastër, Kurbin, Përmet e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2013, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Korçë, Krujë, Kukës, Lushnjë, Mat, Pogradec, Pukë e Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim për vitin 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprave penale, në vitin 2013 është e njëjta me atë që ka pasur në vitin 2012, 16%.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2009-2013 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Gjatë vitit 2013 vërehet tendenca në ulje edhe e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, prej 30 % në krahasim me vitin 2012.

Shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale për vitin 2013 jepet më poshtë:



Në vitin 2009 janë dënuar 7172 të pandehur ose 85,87% e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2010 janë dënuar 7763 të pandehur ose 83,82% e të pandehurve të dërguar gjyqit; në vitin 2011 janë dënuar 8654 të pandehur ose 93,49% e të pandehurve të dërguar gjyqit, në vitin 2012 janë dënuar 8386 të pandehur ose 89,65% e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2013 janë dënuar 7518 të pandehur ose 75,37% e të pandehurve të dërguar gjyqit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjininë e të pandehurve në vitet 2009-2013:



Rezulton nga të dhënat statistikore për të pandehurit meshkuj se:

Në vitin 2009 janë 7555 të pandehur ose ulje prej 14,82% në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë 9425 të pandehur ose rritje prej 24,75% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2010 janë 10474 të pandehur ose rritje prej 11,12% për qind) në krahasim me vitin 2010 ; në vitin 2012 janë 11086 të pandehur meshkuj ose rritje prej 5,84% në krahasim me vitin 2011 dhe në vitin 2013 janë 12866 të pandehur meshkuj ose rritje prej 16% në krahasim me vitin 2012.

Për të pandehurit femra rezulton nga të dhënat statistikore se:

Në vitin 2009 janë 378 të pandehura ose ulje prej 17,28% në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë 458 të pandehura ose rritje prej 21,16% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 janë 445 të pandehura ose ulje e lehtë prej 2,83% në krahasim me vitin 2010 , në vitin 2012 janë 414 të pandehura femra ose ulje prej 6,96% në krahasim me vitin 2011 dhe në vitin 2013 janë 550 të pandehura femra ose rritje prej 32% në krahasim me vitin 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me të pandehurit të mitur në vitet 2009-2013:



Në lidhje me të pandehurit të mitur, nga të dhënat statistikore rezultojnë se:

Në vitin 2009 rezultojnë 665 të mitur të pandehur ose 25,19% më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 870 të mitur ta pandehur ose rritje prej 30,82% në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 rezultojnë 1015 të pandehur të mitur, që do të thotë rritje prej 16,66% në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 rezultojnë 1310 të pandehur të mitur, që do të thotë rritje prej 29,06% në krahasim me vitin 2011 dhe në vitin 2013 rezultojnë 911 të pandehur të mitur, që do të thotë ulje prej 30% në krahasim me vitin 2012.

Në lidhje me të pandehurit të mitur, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 nga 665 të pandehur, 636 janë meshkuj dhe 29 janë femra. Në vitin 2010, nga 870 të pandehur të mitur, 853 janë meshkuj, që do të thotë rritje prej 34,11% në krahasim me vitin 2009 dhe 17 janë femra, që do të thotë ulje prej 41,37% në krahasim me vitin 2009. Në vitin 2011, nga 1015 të pandehur të mitur, 997 janë meshkuj, që do të thotë rritje prej 16,88% në krahasim me vitin 2010 dhe 18 prej tyre janë femra. Në vitin 2013, nga **911 të pandehur të mitur, 885 janë meshkuj, që do të thotë ulje prej 14% në krahasim me vitin 2012 dhe 26 prej tyre janë femra.**

Grafiku i më poshtëm paraqet të dhëna në lidhje me arsimin e të pandehurve në vitet 2009-2013:



Nga të dhënat statistikore për të pandehurit me arsim deri 9-vjeçar rezulton, në vitin 2009 rezultojnë 5123 të pandehur ose 13% më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 6069 të pandehur që do të thotë rritje prej 18,46% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 rezultojnë 6960 të pandehur ose rritje prej 14,68% në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 rezultojnë 7158 të pandehur ose rritje 2,84% në krahasim me vitin 2011 dhe në vitin 2013 rezultojnë 7628 të pandehur ose rritje 6,5% në krahasim me vitin 2012.

Me arsim të mesëm:


Në vitin 2009 rezultojnë 2416 të pandehur ose 18,5% më shumë se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 3279 të pandehur që do të thotë rritje prej 35,72% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 rezultojnë 3302 të pandehur, që do të thotë një rritje e lehtë prej 0,7% në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 rezultojnë 3509 të pandehur, që do të thotë rritje prej 6,26% në krahasim me vitin 2011 dhe në vitin 2013 rezultojnë 3718 të pandehur, që do të thotë rritje prej 5,9% në krahasim me vitin 2012.

Me arsim të lartë:

Në vitin 2009 rezultojnë 397 të pandehur ose 7,88% më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 486 të pandehur, që do të thotë rritje prej 22,41% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 rezultojnë 536 të pandehur, që do të thotë rritje prej 10,28% në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 rezultojnë 458 të pandehur ose ulje prej 14,55% në krahasim me vitin 2011 dhe në vitin 2013 rezultojnë 620 të pandehur ose një rritje prej 35% në krahasim me vitin 2012.

Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitin 2013:




Përsa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, për të pandehur të cilët janë të punësuar në sektorin shtetëror, rezultojnë se në vitin 2011 janë 338 të pandehur nga sektori shtetëror, që do të thotë një ulje e ndjeshme në krahasim me vitin 2010 kur rezultojnë 602 të pandehur nën këtë tregues dhe në vitin 2012 janë 382 të pandehur, që do të thotë rritje prej 13,01% në krahasim me vitin 2011 ndërsa në vitin 2013 janë 269 të pandehur, që do të thotë ulje prej 29,58% në krahasim me vitin 2012.

Rezultojnë nga të dhënat statistikore se të pandehur të punësuar në sektorin privat në vitin 2011 rezultojnë 2259, në vitin 2012 rezultojnë 2636 të tillë, që do të thotë rritje prej 16,68% në krahasim me vitin 2011 dhe vitin 2013 rezultojnë 2275 të tillë, që do të thotë ulje prej 13,69% në krahasim me vitin 2012.

Në vitin 2012 rezultojnë 5648 të pandehur të papunë, përkundrajt vitit 2011 kur rezultojnë 5239 të tillë, që do të thotë rritje prej 7,8% në krahasim me vitin 2011. Në vitin 2013 rezultojnë 5198 të pandehur të papunë, përkundrajt vitit 2012 që do të thotë ulje prej 7,9% në krahasim me vitin 2012.

Sikurse vihet re papunesia është faktori kriminogjenë që vepron më së mirë në gjendjen shoqërore.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve:



Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton:

Pavarësisht tendecave në rritje për të dy kategoritë, kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në zonat urbane sesa në zonat rurale.

Grafiku i vijues paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitet 2011-2013.




Përsa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2013 rezultojnë 295 të pandehur që janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, që do të thotë ulje prej 28.39% në krahasim me vitin

2012; Përsa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2012 rezultojnë 412 të pandehur që janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, që do të thotë rritje prej 39,18% në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 rezultojnë 296 të pandehur të cilët janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, që do të thotë rritje prej 20,81% në krahasim me vitin 2010; në vitin 2009 rezultojnë të pandehur të cilët janë përsëritës për të njëjtën veprë penale 174 persona dhe në vitin 2010 rezultojnë 245 të tillë që do të thotë rritje prej 40,80% në krahasim me vitin 2009;

Përsëritës për vepra penale të ndryshme, rezultojnë në vitin 2013 të jenë 654 persona, që do të thotë rritje prej 26,49% | në krahasim me vitin 2012, përsëritës për vepra penale të ndryshme, rezultojnë në vitin 2012 të jenë 517 persona, që do të thotë rritje prej 26,40% | në krahasim me vitin 2011; rezultojnë të jenë 409 persona në vitin 2011, që do të thotë rritje prej 7,63% në krahasim me vitin 2010; rezultojnë 304 persona në vitin 2009 dhe 380 të tillë në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 25% në krahasim me vitin 2009.

Të pandehur të padënuar më parë, për vitin 2013 rezultojnë 11085 persona, që do të thotë rritje prej 12,32% në krahasim me vitin 2012; Të pandehur të padënuar më parë, për vitin 2012 rezultojnë 9869 persona, që do të thotë ulje prej 1,59% në krahasim me vitin 2011; rezultojnë në vitin 2011 të jenë 10029 të pandehur, që do të thotë rritje prej 9,23% në krahasim me vitin 2010; rezultojnë 7407 persona në vitin 2009 dhe 9181 të tillë në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 23,95% në krahasim me vitin 2009.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me pasojat në dëm të shëndetit:



Në lidhje me pasojat e veprave penale, në dëm të shëndetit, për vitin 2013 nga të dhënat statistikore rezultojnë se në lidhje me pasojën “vdekje” ka një rritje prej 14,37% në krahasim me vitin 2012 ; në dëm të shëndetit, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në lidhje me pasojën “vdekje” ka një ulje prej 4,84% në krahasim me vitin 2011; prej ka një rritje të lehtë prej 1,73%


në krahasim me vitin 2010; ka një rënie të pasojës me vdekje nga veprat penale gjatë vitit 2010 prej 36,11% në krahasim me vitin 2009 (540 raste në vitin 2009 dhe 345 në vitin 2010).

Pasoja nga veprat penale “plagosje e rëndë” rezultojnë në vitin 2013 me një ulje prej 1% në krahasim me vitin 2012, rezultojnë në vitin 2012 me një rritje prej 8,73% në krahasim me vitin 2011; vitin 2011 me një rritje prej 4,13% në krahasim me vitin 2010; me ulje, rezultojnë pasoja nga veprat penale “plagosje e rëndë” dhe ulja është prej 12,31% në krahasim me vitin 2009 (276 raste në vitin 2009 dhe 242 në vitin 2010).

Me rritje rezultojnë edhe në vitin 2013 treguesi në lidhje me pasojën “plagosje e lehtë” prej 14% në krahasim me vitin 2012; në vitin 2012 treguesi në lidhje me pasojën “plagosje e lehtë” prej 1,56% në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 edhe pasoja “plagosje e lehtë” është më rritje prej 32,48% në krahasim me vitin 2010; me ulje rezultojnë të jetë dhe pasojë e veprës penale “plagosje e lehtë” rezultojnë me ulje prej 8,32% në krahasim me vitin 2009 (685 raste në vitin 2009 dhe 628 në vitin 2010).


Në shifrat e mësipërme përfshihen pasojat në dëm të jetës dhe të shëndetit të personave, për çdo fakt të dyshuar kriminal të hetuar, pavarësisht nga mënyra e përfundimit të procedimit rreth tij.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhënat mbi pasojat në dëm të jetës dhe të shëndetit, të regjistruara sipas veprave penale konkrete:



Në mënyrë më të detajuar të dhënat lidhur me numrin e vdekjeve të regjistruara në organin e prokurorisë për vitin 2013 sipas veprave penale konkrete është si më poshtë:

- Për nenin 76 të Kodit Penal “Vrasja me dashje”, janë regjistruar 48 vdekje;
- Për nenin 78 të Kodit Penal “Vrasja me paramendim”, janë regjistruar 29 vdekje;
- Për nenin 78/a të Kodit Penal “Vrasja për gjakmarrje”, është regjistruar 1 vdekje;
- Për nenin 79 të Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, janë regjistruar 27 vdekje;
- Për nenin 79/b të Kodit Penal “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, është regjistruar 1 vdekje;
- Për nenin 79/c të Kodit Penal “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, janë regjistruar 10 vdekje;
- Për nenin 85 të Kodit Penal “Vrasja nga pakujdesia”, janë regjistruar 4 vdekje;
- Për nenin 88 të Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje” (me pasojë vdekjen), janë regjistruar 3 vdekje;
- Për nenin 96 të Kodit Penal “Mjekimi i pakujdesshëm”, janë regjistruar 5 vdekje;
- Për nenin 99 të Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, janë regjistruar 87 vdekje;
- Për nenin 141 të Kodit Penal “Vjedhja me pasojë vdekjen”, janë regjistruar 3 vdekje;
- Për nenin 289 të Kodit Penal “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, janë regjistruar 7 vdekje;
- Për nenin 290 të Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, janë regjistruar 157 vdekje;



TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK


Nga të dhënat statistikore, rezulton se:

Në vitin 2009 rreth 74,27 % e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2010 rreth 68,38% e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2011 rreth 67,03% e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim , në vitin 2012 rreth 66,22% e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2013 rreth 56.23% e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim.

Rezulton nga të dhënat statistikore se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak ka qenë si më poshtë:

Në vitin 2009 janë përfunduar hetimet për 9890 të pandehur nga të cilat 8352 janë dërguar për gjykim dhe për 2013 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 84,44% e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2010 janë përfunduar hetimet për 11364 të pandehur nga të cilat 9261 janë dërguar për gjykim dhe për 2103 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 81,49% e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2011 janë përfunduar hetimet për 11330 të pandehur nga të cilat 9256 janë dërguar për gjykim dhe për 2074 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 81,69% e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2012 janë përfunduar hetimet për 11654 të pandehur nga të cilët 9354 janë dërguar për gjykim 80,26% e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe në vitin 2013 janë përfunduar hetimet për 12315 të pandehur nga të cilët 9974 janë dërguar për gjykim 80.99% e personave për të cilët është ngritur akuzë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak për vitin 2013:




TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË GJYKIMIN DHE NË DËNIMIN E TË PANDEHURVE

Nga të dhënat statistikore, rezulton se:

Në vitin 2009 rreth 96,29% e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2010 rreth 96,20% e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; në vitin 2011 për rreth 96,21% e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe në vitin 2012 për rreth 88,35% e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata, dhe në vitin 2013 për rreth 93% e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata.

TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KËRKUARA NGA PROKURORËT

Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2009-2013.




Të dhënat statistikore tregojnë për ulje të dënimeve me gjobë (kërkesa të prokurorëve) gjatë vitit 2013 ka një ulje prej 36.49% në krahasim me vitin 2012; me gjobë (kërkesa të prokurorëve) gjatë vitit 2012 ka një ulje prej 19,86% në krahasim me vitin 2011; gjatë vitit 2011 prej 13,8% në krahasim me vitin 2010; gjatë vitit 2010 dhe rritja është prej 13,09 % në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 3,35% dhe në vitin 2010 ka rritje prej 13,9% kërtime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2013 ka një ulje prej 38.86%; në vitin 2011 ka një rritje të vendimeve të gjykatës për dënimin me gjobë prej 13,17% në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje prej 11,32% të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 2,44% në krahasim me vitin 2008.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e dënimit më burgim nën minimumin e parashikuar nga ligji:

Te dhenat mbi denimin e te pandehurve ne minimum




Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum:

Vihet re se në vitin 2013 ka rritje të kërkesave të prokurorëve në minimum nga vitin 2012 prej 11.57%; se në vitin 2012 ka ulje të kërkesave të prokurorëve në minimum nga vitin 2011 prej 2,61%; në vitin 2011 ka një ulje të kërkesave të prokurorëve për dënimin me burgim në krahasim me vitin 2010 prej 2,87%; ne vitin 2010 vihet re përsëri ulje të kërkesave të prokurorëve për këtë lloj dënimi prej 30,67% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 4,32%, të kërkesave të prokurorëve për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2013 ka rritje prej 13.66% të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2012; në vitin 2011 ka ulje prej 6,52% të dënimeve të gjykatës për dënimin me burgim në minimum krahasuar me vitin 2010; në vitin 2010 ka një ulje prej 22,03% të vendimit të gjykatës për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 2,1%, të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e dënimit burgim në maksimum për vitet 2009-2013:

Denim ne maksimum 2009-2013




Vihet re se në vitin 2013 ka një ulje prej 18.98% të kërkesave të prokurorëve për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2012; në vitin 2012 ka një rritje prej 17,24% të kërkesave të prokurorëve për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka një rritje të kërkesave të prokurorëve për dënimin me burgim në maksimum prej 39,58% në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje të ndjeshme prej 56,27% të kërkesave të prokurorëve për këtë lloj dënimi, në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,87%, kërkitime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2013 ka një ulje prej 23.64% të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2012, në vitin 2012 ka një rritje prej 20,39% të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka një rritje të ndjeshme të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum prej 103,44% në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka ulje prej 5,84% në krahasim me vitin 2009 të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,76%, vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar shprehimisht “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” si kërkitime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:

Neni 59 i K.Penal: “Dënimi me kusht”



Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2013 ka një rritje prej **4.72% raste të kërkimimeve të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”** në krahasim me vitin 2012; në vitin 2012 ka një ulje prej 3,53% raste të kërkimimeve të prokurorit për “Pezullimi I ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 jemi në të njëjtat nivele sikurse në vitin 2010; kështu në vitin 2010 rezultojnë 1075 raste të kërimit të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” ndërsa në vitin 2010 rezultojnë të jenë 10754 raste; në vitin 2010 ka rritje prej 17,63% në krahasim me vitin 2009 të këtij treguesi; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 0,97%, kërtime të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në parashikim të nenit 59 të Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e dënimit “Burgim i përjetshëm” për periudhën 2009-2013:

Burgim i perjetshem 2009 - 2013




Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore rezultojnë se:


Në vitin 2013 ka një ulje 42.85% të kërkesave të prokurorëve për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2012, në vitin 2012 ka një rritje prej 16,66% të kërkesave të prokurorëve për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka një rritje prej 63,63% të kërkesave të prokurorëve për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka ulje prej 26,66% në krahasim me vitin 2009 për këtë masë dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 31,81%, kërkime të prokurorit për masën e dënimit, burgim i përjetshëm.

Nga të dhënat statistikore rezultojnë se: në vitin 2013 ka një ulje të vendimeve të gjykatës prej 25% për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2012; në vitin 2012 ka një ulje të vendimeve të gjykatës prej 7,69% për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2011 në vitin 2011 ka rritje të ndjeshme prej 116,66% në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje prej 20% në krahasim me vitin 2009 të vendimeve të gjykatës për këtë masë dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 61,53%, kërkime të prokurorit për masën e dënimit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me kërkesat e prokurorëve për dënimin me burgim gjatë vitit 2013:




Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendimet e dhëna nga gjykata për vitin 2013 për dënimin me burgim:




TE DHENA MBI KERKESEN E PROKURORIT DHE VENDIMET GJYKATES

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me kërkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykes për vitin 2013 në lidhje me dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe me burgimin e përjetshëm:



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me kërkimet e prokurorit gjatë vitit 2013 mbi llojet e dënimeve:



PJESA III

MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2013.

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale.

Kriminaliteti në të gjitha format e tij ka ndryshuar thellësisht kohët e fundit. Krahas atij që mund ta quajmë “tradicional”, sepse është vendosur në një territor të caktuar (me degëzime dhe kontakte me organizata të tjera), ekziston dhe kriminaliteti që sot quhet “transnacional”, i cili formohet nga grupe personash që u përkasin vendeve të ndryshme, të bashkuar jo më nga prejardhja e përbashkët, por vetëm nga interesi i përbashkët dhe që veprojnë njëkohësisht në më shumë se një vend.

Ndikimi që kriminaliteti në përgjithësi dhe veçanërisht krimi i organizuar ka në rajonin e Ballkanit kërkon përpjekje gjithnjë e më të mëdha në luftën kundër këtij fenomeni. Vendi ynë merr pjesë në mënyrë aktive në nisma kundër krimit, të ndërmarra nga komuniteti ndërkombëtar në plotësim e mbështetje të përpjekjeve të kryera nga çdo vend, me qëllim përballjen e përvojave të ndryshme hetimore dhe gjyqësore për të gjetur e përcaktuar teknika të përbashkëta të luftës kundër krimit të organizuar transnacional.

Specifikisht, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, të para në këndvështrimin teknik të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së Institucionit të Prokurorisë Shqiptare me agjensitë ligjzbatuese ndërkombëtare në fushën penale, janë zgjeruar ndjeshëm, veçanërisht vitet e fundit. Kjo tendencë rritjeje duhet parë në lidhje me faktin se, veprimtaria kriminale në përgjithësi dhe krimi i organizuar në veçanti, ka kaluar kufijtë nacionalë, duke u bërë gjithnjë e më shumë problem rajonal e global.

I parë në këndvështrimin cilësor në kuadrin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, bashkëpunimi në çështjet penale ka patur një rritje të ndjeshme, më në veçanti, sa i takon kërkesave për ndihmë juridike nga/për autoritetet e huaja, ekstradimeve të subjekteve në ndjekje penale ose të dënuar penalisht, njohjes së vendimeve gjyqësore penale, transferimit të të dënuarve etj.

Në kuadrin e zgjerimit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, një rëndësi të madhe ka patur edhe dinamizmi i legjislacionit ndërkombëtar penal, ku mund të veçojmë ratifikimin e mjaft marrëveshjeve të rëndësishme ndërkombëtare penale, të cilat kanë qenë premisa për nënshkrimin e disa marrëveshjeve dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të rajonit, por jo vetëm.

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar nuk mund të trajtohet i shkëputur nga asistencë e vazhdueshme e cilësore e SHBA dhe Këshillit të Europës, për Institucionin e Prokurorisë Shqiptare, nëpërmjet projekteve të ndryshme në kuadrin e ndihmës profesionale si dhe trajnimit sistematik të Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore. Ky bashkëpunim i ka dhënë një qasje të re cilësore punës së autoritetit të Prokurorisë në drejtim të rritjes së performancës profesionale.

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar, përfshin gjithashtu edhe pjesëmarrjen e Institucionit të Prokurorisë Shqiptare, në rrjete e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë penale.

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme përbën hallkën institucionale lidhëse dhe njëherazi njësinë e specializuar për bashkëpunimin ndërkombëtar, duke ofruar ndihmë specifike në harmonizimin e hallkave ligjzbatuese kombëtare, ndërkufitare e ndërkombëtare, në luftën kundër veprimtarisë kriminale në përgjithësi dhe krimin të organizuar në veçanti. Duke e parë në këtë këndvështrim karakterin operacional të kësaj Drejtorie, pjesë integrale e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, kjo njësi merr një rëndësi të veçantë në kuadrin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në përgjithësi dhe realizimit të objektivave rajonale e globale në luftë kundër aktivitetit kriminal.

Në vijim paraqesim të dhëna statistikore sipas fushës specifike të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale, konkretisht:

I. Ekstradimet

i. Ekstradime nga jashtë

Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2013 janë paraqitur 125 kërkesa ekstradimi për subjektet e shpallur në kërkim ndërkombëtar mbi bazën e një vendimi penal të formës së prerë ose vendimi për kufizimin e lirisë personale “*arrest në burg*”, të cilët janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shteteve të tjera. Krahasuar me vitin 2012, në të cilin janë paraqitur në total 59 kërkesa për ekstradim nga jashtë shtetit, gjatë vitit 2013 vërehet një rritje e ndjeshme në masën 112 %.


Më poshtë paraqesim në formë tabelare dhe grafike të dhënat për periudhën 2012-2013:

Viti	2012	2013
Nr. kërkesave për ekstradim	59	125



Nga të dhënat statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2013 numri më i madh i kërkesave për ekstradim i është paraqitur autoriteteve Italiane dhe Greke, përkatësisht 43 dhe 37 kërkesa, një trend me rritje të ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat statistikore për këtë tregues (*ekstradime nga jashtë*) dhe grafiku përkatës sipas shteteve të cilëve i janë drejtuar kërkesat për ekstradim:

Shteti	Viti 2012	Viti 2013
Angli	2	6
Belgjikë	1	6
Gjermani	0	5
Greqi	17	37
Itali	21	43
Kosovë	1	5
SH.B.A	7	2




Sa i takon subjekteve të ekstraduar rezulton se, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2013 janë realizuar ekstradimet në 49 raste. Theksojmë këtu se, për një pjesë të personave të ekstraduar fizikisht në vitin 2013, kërkesat e ekstradimit janë paraqitur kryesisht në vitin 2012, ndërsa për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2013, dorëzimi fizik i këtyre personave pritet të realizohet gjatë vitit 2014.

ii. Ekstradime për jashtë

Në lidhje me ekstradimet e shtetasve shqiptarë/të huaj nga Shqipëria në vende të tjera, nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2013, janë arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim ekstradimitin e tyre drejt shteteve të tjera 136 shtetas. Sikurse vërehet nga tabela rezulton se, numri i kërkesave për ekstradim të paraqitura nga autoritetet e huaja, gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012 ka pësuar një rritje në masën 28,3%.

VITI	2012	2013
Ekstradime për jashtë	106	136

Viti 2013 zë 56% të totalit të volumit të ekstradimeve për jashtë gjatë periudhës 2012-2013, ndërsa viti 2012 përbën 44 %, sikurse paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Në referencë të tabelës së mëposhtme vërehet se, gjatë vitit 2013 numri më i lartë i kërkesave të ekstradimitit për shtetasit shqiptarë ose të huaj, të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur nga Italia me 73 kërkesa, Kosova 14 kërkesa, Gjermania 12 kërkesa, Maqedonia 8 kërkesa etj.

Vlen të theksojmë këtu se, numri i lartë i kërkesave të ekstradimitit nga Italia ka ardhur si rezultat i nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimitin të 13 Dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale, ratifikuar me Ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008 (*hyrë në fuqi më 01.08.2011*). Kjo ka çuar në rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, ku Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme ka pasur një rol tejet të rëndësishëm në këtë aspekt.

Gjithashtu, krahasuar me vitet e kaluara gjatë vitit 2013 vërehet një rritje e ndjeshme e kërkesave për ekstradim nga Republika e Kosovës, si pasojë e nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Dypalëshe “Për ekstradimin” ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, ratifikuar me Ligjin nr. 2, të vitit 2013 (hyrë në fuqi më 12.04.2013).

Sa më sipër, paraqitet grafikisht:



Duke marrë në konsideratë se në shtetin Grek, ka vendqëndrimin e zakonshëm një komunitet i konsiderueshëm shtetasish shqiptarë, ndër të cilët disa shtetas janë shpallur në kërkim ndërkombëtar nga këto autoritete, në mënyrë që të realizohet drejtësia penale dhe të sigurohet se procesi i liberalizimit të vizave nuk do të ndihmojë ata që përpiqen t’i shpëtojnë forcës së ligjit, lind domosdoshshmëria e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok, nën frymën e zbatimit të Konventës Europiane për Ekstradimin. Në këtë kuadër, Prokuroria e Përgjithshme ka

propozuar fillimin e negociatave me autoritetet greke për hartimin dhe nënshkrimin e një Marrëveshjeje Dypalëshe Ekstradimi.

Gjithashtu, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë trajtimin e praktikave të ekstradimit të shtetasve shqiptarë të shpallur në kërkim ndërkombëtar, në veçanti në Itali, e ka zgjeruar duke i kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në 31 raste, zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së këtyre shtetasve, brenda objektit të nenit 3, pika 1/d (*fusha e zbatimit*) dhe nenin 8/1 (*verifikimet paraprake*) të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

II. Letërporositë

i. Letërporositë nga jashtë


Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale të ardhura nga autoritetet e huaja, gjatë vitit 2013 janë transmetuar 675 letërporosi, duke konstatuar rritje të ndjeshme në masën 16 % krahasuar me vitin 2012, vit në të cilin janë transmetuar 582 kërkesa.



Lidhur me sa më sipër, konstatohet se numrin më i lartë i kërkesave ka ardhur nga shtetet kufitare si, Greqia me 131 kërkesa, Kosova me 125, Italia 91, Maqedonia 46, Sllovenia 30, Gjermania 25, Zvicra 17, Kroacia, Mali i Zi dhe Turqia 15 kërkesa, Belgjika 14, Austria dhe Franca 12, Anglia, Serbia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës 11 kërkesa, Holanda 10, Egjipti 9, si dhe shtete të tjera 75 kërkesa, duke veçuar këtu EUROJUST dhe EUROPOL përkatësisht me 2 kërkesa për ndihmë juridike.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Letërporosi nga jashtë



Sa i takon letërporosive nga jashtë, ekziston një problematikë në lidhje me kthimin e automjeteve të trafikuar, të cilën e trajtojmë në vijim:

Vepra penale e “*Trafikimit të mjeteve motorike*” parashikohet në nenin 141/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Legjislacioni ynë procedural penal, parashikon që sendet apo produktet e një vepre penale mund të sekuestrohen dhe si masa të sigurimit pasuror parashikohen: sekuestroja preventive dhe sekuestroja konservative (*Nenet 270-276 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë*). Sekuestroja mund të vendoset me vendim të Gjykatës ose të Prokurorit.

Në lidhje me kthimin e mjetit pronarit të ligjshëm sqarojmë si më poshtë:

Krahas rregullit bazë, që kthimi i sendit të vjedhur është atribut i Gjykatës, Neni 218 i Kodit të Procedurës Penale, i jep diskrecionin prokurorit që të realizojë kthimin, pronarit të ligjshëm edhe në fazën e hetimeve paraprake. (*Neni 218: “1. Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre.....3. Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori.....”*)

Problematika që lind me rastet e trafikimit të automjeteve varet nga lloji i trafikimit dhe konkretisht:

- *Së pari*, kur automjeti është i vjedhur dhe trafikohet nga një subjekt që ka vjedhur ose të tjerë persona, në rolin e “korrierit”: autoritetet tona regjistrojnë procedimin penal në bazë të flagrancës. Në këto raste problemi qëndron te mbërritja e letërporosive pasi në këto të fundit nuk përmbahen veprimet e bëra nga autoritetet tuaja. Ato përmbajnë vetëm kallëzimin formal të bërë lidhur me vjedhjen e automjetit.
- *Së dyti*, kur disponuesi i mjetit është palë në trafikim, si me shoqëritë e marrjes me qira dhe me shoqëritë e sigurimeve: në raste të tilla, mbrohet blerësi me mirëbesim dhe për sa kohë që ekzistojnë dyshime lidhur me sa më sipër, nuk mund të realizohet kthimi i automjetit nga ana jonë.

Sa më sipër, Prokurorët kanë hasur vështirësi në ekzekutimin e kërkesave me objekt kthimin e mjeteve motorike pronarëve të ligjshëm, pasi legjislacioni procedural penal nuk përcakton qartë mënyrën se si duhet të procedohet në raste të tilla. Ndryshimet përkatëse në legjislacion do të passjellin unifikimin e praktikës dhe ekzekutimin e letërporosive.

ii. Komisione Rogatore

Një pjesë e kërkesave për ndihmë juridike ekzekutohen në prezencë të përfaqësuesve të autoriteteve huaja të drejtësisë, gjë e cila parashikohet shprehimisht nga neni 16 i Ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 “*Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale*”. Gjatë vitit 2013, ka patur një numër të konsiderueshëm kërkesash dhe bashkëpunime të suksesshme në disa operatione dy ose shumëpalëshe të finalizuara me goditjen e grupeve dhe organizatave kriminale në fushën e trafikut të personave, të trafikut të lëndëve narkotike. Këtu

mund të përmendim operacione shumë të suksesshme të organizuara me autoritet italiane, angleze, gjemane, kroate, sllovene, belge etj.

iii. Skuadrat e përbashkëta hetimore.

Autoritetet e drejtësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, përkatësisht Prokuroria e Bosnjës dhe Hercegovinës, Sektori i Veçantë për Krimin e organizuar, Krimin Financiar dhe Korrupsionin, ka transmetuar drejtpërsëdrejti, një kërkesë për ndihmë juridike, që lidhet me procedimin penal të regjistruar në ngarkim të dy shtetasve, për veprën penale të “*Pastrimit të parave*”, parashikuar nga neni 209 i Kodit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Gjithashtu autoritetet e Bosnjës & Hercegovinës kanë shprehur interesimin për krijimin e një skuadre të përbashkët hetimore, në përputhje me nenin 20 të Protokollit të Dytë shtesë të Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale.


Një nga prioritetet e institucionit të Prokurorisë gjatë vitit 2014 është krijimi i skuadrave të përbashkëta hetimore, mbështetur në Protokollin e Dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale, sugjeruar dhe rënë dakort gjatë takimeve të shpeshta ndërmjet përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe atyre të EUROJUST.

Edhe pse komisionet rogatore të përmendura më sipër, nuk janë quajtur Skuadra të Përbashkëta Hetimore, ato kanë pasur të njëjtat karakteristika dhe të njëjtat rezultate, sikurse këto Skuadra, kjo në sajë të marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe ndërpersonale të personave të përfshirë të to.

iv. Letërporositë për jashtë

Gjatë vitit 2013 Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore i kanë drejtuar autoriteteve të huaja gjyqësore gjithsej 308 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të ushtrimit të ndjekjes penale ndaj subjekteve shqiptarë dhe të huaj. Nga të dhënat statistikore rezulton se kanë dërguar letërporosi përkatësisht Prokuroritë, Durrës 85, Tiranë 54, Vlorë 44, Shkodër 25, Korçë 15, Elbasan 12, Prokuroria për Krime të Rënda 10, Gjirokastër e Pogradec 8 etj.

Letërporosi për jashtë Viti 2013



Nga totali i letërporosive për jashtë vërehet se për vepra penale kundër personit janë dërguar 37 letërporosi, për vepra penale kundër pasurisë dhe ekonomisë 200 letërporosi, për vepra penale kundër autoritetit të shtetit 56 letërporosi, vepra penale kundër drejtësisë 4 ndërsa për vepra penale të kryera nga banda të armatosura 2 letërporosi.


Problematika

Përsa i takon letërporosive për jashtë ekziston një problematikë lidhur me përkthimin e tyre në gjuhët zyrtare të vendeve të cilave u drejtohen, sikurse parashikohet në legjislacion. Më konkretisht, referuar Ligjit nr. 100, të vitit 2013, i cili ka ndryshuar Ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, është Ministria e Drejtësisë autoriteti i cili duhet të bëjë përkthimet përkatëse. Nga ana jonë kemi konsideruar se, këto ndryshime ligjore do të rrisin efektivitetin e punës së prokurorëve e cila më pas do të pasqyrohet edhe në realizimin e një bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar në kohë reale, në përputhje me angazhimet e marra në kuadër të strukturave ndërkombëtare ku Shqipëria është vend anëtar. Por në praktikë rezulton se, shpesh letërporositë për jashtë shtetit kthehen nga Ministria e Drejtësisë për realizimin e përkthimit prej Prokurorive respektive të Rretheve Gjyqësore, duke sjellë vonesa dhe zvarritje në përkthimin e letërkërkesave. Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore për shkak të largësisë territoriale nuk kanë pasuri mundësi kontaktimin dhe kontraktimin e përkthyesve të licencuar të Ministrisë së Drejtësisë, gjë që nuk i ka shërbyer sigurimit të një asistence ndërkombëtare më efektive, në shërbim të ushtrimit të ndjekjes penale brënda afateve ligjore të përcaktuara.

III. Njohjet e vendimeve penale.

i. Njohjet e vendimeve penale të huaja

Në vitin 2013 është kërkuar në 29 raste njohja e vendimeve penale të huaja dhënë në ngarkim të shtetasve shqiptarë, duke konstatuar ulje me afërsisht 37 % krahasuar me vitin 2012, në të cilin është kërkuar njohja e vendimeve penale në 46 raste.




Nga të dhënat statistikore vërehet se, Kosova dhe Italia zënë pjesën më të madhe të kërkesave për njohje, përkatësisht me 12 dhe 10 kërkesa.

Shtetet	Njohje vendimesh penale të huaja	
	Viti 2012	Viti 2013
Kosovë	32	12
Itali	7	10
Belgjikë	2	2
Greqi	3	2
Mal i Zi	0	2
Maqedoni	1	1
Hollandë	1	0
Totali	46	29

Ulja e numrit të kërkesave të autoriteteve të huaja për njohjen në Shqipëri të vendimeve penale, ka ardhur si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjeve Dypalëshe për Ekstradimin ndërmejt Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë e Kosovës. Mbi bazën e këtyre marrëveshjeve, tashmë është i mundur ekstradimi i shtetasve shqiptarë të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga këto vende.


Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Njohje vendimesh penale të huaja



ii. Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2013 autoritetet shqiptare kanë paraqitur gjithsej 16 kërkesa për njohjen e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit, krahasuar me 12 të tilla në vitin 2012.



Në tabelën e mëposhtme, shihet qartë se numri më i lartë i kërkesave i është dërguar autoriteteve kosovare me 9 të tilla, duke vijuar më pas Maqedonisë dhe Bullgarisë me 2 kërkesa etj.

Njohje e vendimeve penale shqiptare jashtë vëndit

	Viti 2012	Viti 2013
Bullgari	1	2
Kosovë	7	9
Itali	1	1
Bosnjë-Herz.	0	1
Mal i Zi	1	1
Maqedoni	2	2
Totali	12	16


Rënia e numrit të kërkesave edhe në këtë rast ka ndodhur për shkak të nënshkrimit të Marrëveshjeve Dypalëshe të përmendura më lart.

IV. Transferimet e procedimeve penale

i. Transferimet e procedimeve nga jashtë

Në vitin 2013 është kërkuar në 14 raste transferimi i procedimeve penale nga jashtë, duke konstatuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2012, në të cilin është kërkuar transferimi në 12 raste.

Transferime procedimesh penale nga jashtë



Vlen të theksojmë se, numri më i lartë i kërkesave për transferimin e procedimeve i përket Greqisë. Këto kërkesa të transmetuara nga autoritetet greke të drejtësisë lidhen me procedime penale të regjistruara në ngarkim të shtetasve shqiptarë dhe në pamundësi të ekstradimit të tyre, për shkak të mungesës së një Marrëveshjeje Dypalëshe Ekstradimi, transferimi i procedimit penal është e vetmja zgjidhje ligjore e mundshme.

ii. Transferimet e procedimeve për jashtë

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2013 janë transferuar 11 procedime penale për jashtë vendit, krahasuar me 5 të tilla gjatë vitit 2012.

VITI	2012	2013
Transferimi i procedimeve penale jashtë vendit	5	11

Transferime procedimesh penale për jashtë




Rezulton se, gjatë vitit 2013 janë transferuar gjithsej 6 procedime penale në Kosovë dhe nga 1 procedim në Austri, Francë, Greqi, Itali dhe Spanjë.

V. Transferimet e personave të dënuar

i. Transferimet e personave të dënuar nga jashtë

Në vitin 2013 është kërkuar në 28 raste transferimi i subjekteve të dënuar nga jashtë, duke konstatuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2012, në të cilin është kërkuar transferimi në 6 raste.


Viti	2012	2013
Transferimi i të dënuarve nga jashtë	6	28



Numri më i lartë i kërkesave për transferimin e të dënuarve ka ardhur nga Italia dhe Anglia përkatësisht 12 dhe 10 kërkesa, Greqia 3, Kosova, Maqedonia dhe Irlanda nga 1 kërkesë. Kjo rritje e ndjeshme i referohet kryesisht nënshkrimit të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut “Për transferimin e personave të dënuar”.

ii. Transferimet e personave të dënuar për jashtë

Në vitin 2013 është kërkuar në 21 raste transferimi jashtë vendit i subjekteve të dënuar nga autoritetet shqiptare, duke konstatuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2012, në të cilin është kërkuar transferimi në 3 raste.



Konstatohet se, gjatë vitit 2013 është rritur numri i kërkesave për transferim jashtë vendit, konkretisht në Kosovë janë paraqitur 7 kërkesa, Itali dhe Greqi 4, Gjermani 3 dhe Maqedoni 2 kërkesa. Theksojmë se, rritja e ndjeshme e transferimeve me Republikën e Kosovës ka ardhur si pasojë e nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi në vitin 2013 të Marrëveshjes Dypalëshe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për transferimin e të dënuarve”.


VI. Urdhrat e arrestit ndërkombëtar

Një pjesë e rëndësishme e punës së Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme është trajtimi i shpalljeve apo heqjeve nga kërkimi ndërkombëtar i shtetasve shqiptarë në ngarkim të të cilëve ka një vendim të formës së prerë (*me një dënim të paktën prej 4 muajsh burgim*) ose një vendim për caktim mase sigurimi “Arrest në burg”. Ky proces realizohet në koordinim me Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë në vendin tonë.

Sa i takon urdhrave të arrestit ndërkombëtar për subjektet e dënuar nga autoritetet shqiptare të drejtësisë ose me masë sigurimi personal “Arrest në burg”, konstatohet se gjatë vitit 2013 Prokuroria Shqiptare ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 186 subjekte. Ky tregues ka pësuar rritje në masën 59% krahasuar me vitin 2012, në të cilin janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 117 subjekte.

Përsa parashtrohet më lart vërehet në grafikun e mëposhtëm:


Shpallje në kërkim ndërkombëtar



Theksojmë se, rritja e numrit të shpalljeve ka passjellë edhe rritjen gjatë vitit 2013 të numrit të subjekteve të arrestuar nga autoritetet e huaja me qëllim ekstradimi drejt vendit tonë.

Sa i takon heqjeve nga kërkimi ndërkombëtar nga të dhënat statistikore gjatë vitit 2013 rezultojnë në total 135 heqje, duke konstatuar rritje në masën 36,4% krahasuar me vitin 2012 në të cilin janë realizuar 99 heqje nga kërkimi ndërkombëtar.

Theksojmë këtu se, në masën më të madhe heqjet janë kryer për shkak të ekstradimit në Shqipëri të subjekteve nga vendet e tjera, një pjesë e tyre janë arrestuar brenda vendit, një pjesë për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit etj.



i. Problematika

Ekziston një problematikë lidhur me urdhrat e arrestit ndërkombëtar e konkretisht, mbi *vonesat ose mosdërgimin e materialeve të nevojshme për të bërë të mundur shpalljen në kërkim ndërkombëtar.*

Sipas pikave 6 dhe 7 të Udhëzimit të Përbashkët “Për Shpalljen në Kërkim Ndërkombëtar” Nr. Prot. 02, datë 03.06.2010 (në vijim Udhëzimi i Përbashkët), midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme:

“Drejtoritë e Policive në Qarqe ose Komisarariatet e Policisë, nga momenti i marrjes së urdhërit të ekzekutimit nga prokurori, brenda 3 muajve duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për kërkimin në shkallë kombëtare me qëllim lokalizimin dhe arrestimin e personit në kërkim. Në përfundim të afatit të parashikuar në pikën gjashtë të këtij udhëzimi dhe kur rezulton se personi i kërkuar nuk gjendet brenda territorit kombëtar, Drejtoritë e policisë në Qarqe ose Komisarariatet e Policisë njoftojnë prokurorin, i cili urdhëron shpalljen në kërkim ndërkombëtar”.

Po ashtu, sipas pikave 8, 8.1 dhe 10 të Udhëzimit të Përbashkët, *Drejtoritë e Policive në Qarqe ose Komisarariatet e Policisë, në zbatim të Urdhrit të Prokurorit për shpalljen e personit në kërkim ndërkombëtar, brenda 5 ditëve, duhet të plotësojnë dhe dërgojnë në Prokurori dokumentacionin e mëposhtëm:*

Të dhënat identifikuese të subjektit të tilla si, çertifikatë personale ose familjare etj.....

Prokurori i çështjes apo Prokurori i ekzekutimeve penale brenda 5 ditëve nga marrja e dokumentacionit të plotësuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut apo Komisarariatit të Policisë, materialet bashkëlidhur ia dërgon Prokurorisë së Përgjithshme - Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

Afati i mësipërm shpesh nuk është respektuar nga Prokuroritë e ndryshme të Rretheve Gjyqësore të cilat i dërgojnë aktet përkatëse të paplota (*mungojnë psh të dhënat identifikuese të personave që do të shpallen në kërkim si certifikatë lindjeje, fotografi ose gjurmë gishtash etj.*), pasi në këto raste nuk vihen në dispozicion nga Drejtoritë përkatëse të Policisë së Qarqeve. Theksojmë këtu, se nga ana jonë i jemi drejtuar së fundmi Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë me qëllim ndërhyrjen për zgjidhjen e një problematike të tillë, e cila konstatohet kryesisht në Rrethin Gjyqësor Tiranë.

Vonesa në shpalljet në kërkim ndërkombëtar ose madje në disa raste mosshpallja në kërkim ka çuar në atë që shumë të dënuar i kanë shpëtuar vuajtjes së dënimit pasi kanë kaluar afatet e parashikuara për ekzekutimin e vendimit.

VII. Marrëveshjet Dypalëshe/Shumëpalëshe të nënshkruara në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale.

Sikurse kemi përmendur edhe më sipër, nënshkrimi nga ana e Republikës së Shqipërisë i disa Marrëveshjeve Dypalëshe, si pasojë e dinamizmit të legjislacionit ndërkombëtar në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, i ka dhënë tonus zhvillimit të marrëdhënieve ndërshtetërore, e veçanërisht me vendet e rajonit.

Në këtë aspekt, gjatë vitit të kaluar vërehet rritje e bashkëpunimit juridiksional me autoritetet e huaja, si p.sh. rritje e numrit të ekstradimeve, të letërporosive etj.

Marrëveshjet dypalëshe/shumëpalëshe të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë së fundmi, paraqiten si më poshtë:

1. Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për Transferimin e Personave të Dënuar.
Ratifikuar me Ligjin Nr. 98/2013
2. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferimin e personave të dënuar.
Ratifikuar me Ligjin Nr. 1/2013
3. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ekstradimin.
Ratifikuar me Ligjin Nr. 2/2013
4. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale.
Ratifikuar me Ligjin Nr. 3/2013
5. LIGJ Nr. 117/2013 Për Ratifikimin e Protokollit të 4^l Shtesë të Konventës Europiane të Ekstradimit.
(Ky Protokoll nuk ka hyrë ende në fuqi, pasi nuk është plotësuar kushti i te pakten tre ratifikimeve nga Shtetet nënshkruese)
6. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit për bashkëpunimin ligjor dhe gjyqësor në çështjet penale.

Ratifikuar me Ligjin Nr. 93/2012

7. Gjithashtu theksojmë se, gjatë vitit 2013 ka filluar procesi i draftimit dhe miratimit në parim të tre Marrëveshjeve Dypalëshe me Republikën e Bosnjë-Herzegovinës, të cilat priten të nënshkruhen dhe ratifikohen nga Parlamenti Shqiptar gjatë këtij viti.

Sjellim në vëmendje se, në funksion të zbatimit sa më të drejtë në praktikë të marrëveshjeve dypalëshe, Prokurori i Përgjithshëm dhe përfaqësues të Prokurorisë Shqiptare gjatë vitit 2013 kanë zhvilluar takime të herëpashershme me përfaqësues të shteteve Palë, si dhe në këtë kuadër Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë ka përgatitur disa udhëzime, të cilat u janë dërguar Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut “*Për transferimin e personave të dënuar*”, paraqesim disa problematika të cilat po i parashtrijmë sa më poshtë vijon:

- **Së pari**, nga ana jonë u konstatua se, neni 2 pika 3 e Marrëveshjes bie në kundërshtim me nenin 3, gërma “b”, pasi në to parashikohet shprehimisht:

Neni 2

Parime të Përgjithshme

3. “Kur të dyja palët bien dakord dhe në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, një person i dënuar mund të transferohet nga territori i shtetit transferues në territorin e shtetit marrës, **pa pëlqimin e personit të dënuar**, në mënyrë që personi i dënuar të vazhdojë vuajtjen e dënimit të dhënë nga shteti transferues.

Qëllimi i këtij Neni është të qartësojë se, Marrëveshja parashikon transferimin me ose pa pëlqimin e të burgosurit. Një person mund të ofrohet vullnetar për transferim p.sh. “*me ë.....] pëlqimin e personit të dënuar*” ose ai mund të transferohet pa pëlqimin e tij p.sh. “*pa pëlqimin e personit të dënuar*”. Kushtet për transferime të tilla përcaktohen në Nenin 3.

Neni 3

Kushtet për transferim

“*b) personi i dënuar jep pëlqimin për transferimin ose është subjekt i një urdhri për dëbim, deportim ose largim nga shteti transferues;*”

Këta persona, në çdo rast, do të transferohen vetëm me pëlqimin e tyre, ndërsa nuk i kërkohet pëlqimi në rastet kur dëbohen, deportohen apo largohen nga shteti transferues.

Sa më sipër, në takim u konkludua se, personat e dënuar mund të transferohen **me ose pa** pëlqimin e personit të dënuar, duke iu referuar tekstit origjinal të Marrëveshjes së gjuhës angleze dhe një gabimi të përkthimit në tekstin e gjuhës shqipe.

- **Së dyti**, në zbatim të nenit 4 të Marrëveshjes “*Procedurat për transferim*”, Pala Shqiptare do të zbatojë legjislacionin e saj të brendshëm procedural penal, por gjithnjë në harmoni me këtë dispozitë, duke proceduar fillimisht me kalimin e akteve Prokurorisë kompetente, e cila më pas do të vijojë me paraqitjen në Gjykatë të kërkesës për njohjen e vendimit penal të dhënë nga autoritetet britanike me qëllim transferimin e shtetasve shqiptarë për vazhdimin e vuajtjes së dënimit në Shqipëri.

Gjithashtu, nga pikëpamja formale e akteve, duke marrë në konsideratë ndryshimin midis sistemeve ligjore të të dy vendeve, Palë të Marrëveshjes dhe duke iu referuar tashmë dokumentacionit të dërguar nga autoritetet britanike, vendimi i gjykatave britanike paraqitet në formën e një formulari (*Court Order*), i cili është moduli i vendimit penal të dënimit, i miratuar për vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Duke qenë se, tashmë Shqipëria ndodhet në proces të marrjes së statusit si vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian, sqarojmë se, ky modul vendimi do të aplikohet në të ardhmen edhe në vendin tonë.

- ***Së treti***, në zbatim të nenit 7, pika 1 e Marrëveshjes, duhet pasur parasysh që shteti marrës nuk e konverton dënimin në një dënim që mund të ishte dhënë në shtetin marrës për një veprë penale të ngjashme. Kjo do të thotë se, masa e dënimit e dhënë nga autoritetet britanike duhet të konsiderohet e mirëqenë dhe prokurori duhet të kërkojë në Gjykatë të njëjtën masë dënimi. Në frymën e kësaj Marrëveshje Dypalëshe, si dhe të Konventës Europiane Për Transferimin e Personave të Dënuar, edhe Gjykatat Shqiptare janë të detyruara të caktojnë të njëjtën masë dënimi, sikurse ajo e dhënë nga autoritetet britanike.

Shembull: Nëqoftëse një Gjykatë Britanike jep një dënim prej 10 vjet burgim për vjedhje, por konform praktikës së dënimit në Shqipëri, shkelësi do të kishte pritur të merrte një dënim në Shqipëri prej 6 vjetësh, atëherë Gjykata Shqiptare nuk mund ta reduktojë vendimin në një dënim 6 vjet. Duke qenë se, vendimi i dhënë nga pala Britanike në këtë shembull nuk e kalon dënimin maksimal të dhënë nga një gjykatë shqiptare për një shkelje për vjedhje, gjykatës do t'i kërkohej të njëjtit dhe të zbatonte vendimin e 10 viteve.

Në zbatim të nenit 7, pika 2, nëse dënimi e kalon dënimin maksimal të parashikuar në shtetin marrës për një veprë penale të ngjashme, shteti marrës, *me pëlqimin e shtetit transferues*, para transferimit, mund të ulë dënimin në dënimin maksimal të parashikuar në legjislacionin e shtetit marrës për atë veprë penale.

Shembull: Ky paragraf përcakton rrethanat në të cilat një dënim i dhënë në Shtetin që jep dënimin mund të ndryshohet. Praktikisht kjo mund të ndodhë vetëm kur dënimi i dhënë në Shtetin që jep dënimin është më i lartë se dënimi maksimal i mundshëm për atë veprë penale të parashikuar në ligjin e Shtetit marrës. P.sh. kur një gjykatë Britanike i jep një dënim prej 15 vjetësh një shkelësi për një shkelje për vjedhje, autoritetet Shqiptare do të kishin të drejtën të reduktonin dënimin me dënimin maksimal që mund të jëpte një gjykatë e tyre p.sh. me 10 vjet. Nuk mund ta reduktojë dënimin nën dënimin maksimal.

Theksojmë këtu se, pëlqimi i shtetit transferues do të jepet vetëm pasi Gjykata shqiptare të disponojë me vendim për njohjen e vendimit penal britanik.

Në zbatim të nenit 7, pika 3, “*Vazhdimi i zbatimit të dënimit pas transferimit rregullohet nga ligjet dhe procedurat e shtetit marrës, duke përfshirë ato që rregullojnë kushtet e burgimit, kufizimit ose ndonjë heqje tjetër lirie dhe ato që parashikojnë uljen e periudhës*

së burgimit, kufizimit ose ndonjë heqje tjetër lirie, me kusht, lirimi me kusht, ulje dënimi ose ndryshe.”

Sipas këtij paragrafi, Shteti marrës është përgjegjës për të gjitha vendimet që lidhen me lirimimin e një të burgosuri. Shteti i cili ka dhënë dënimin nuk ka më një rol përse më lart. Si rrjedhojë, ndërsa vazhdon të zbatohet vendimin e dhënë nga një gjykatë në Shtetin që ka marrë këtë vendim, Shteti marrës nuk varet nga rregullat mbi lirimimin të cilat i ka Shteti dënues, por duhet të aplikojë legjislacionin kombëtar përse i përket lirimimit. Mund të ndodhë pra, që një i burgosur të lirohet më herët në Shtetin marrës sesa do të mund të lirohej në Shtetin që jep dënimin, ose anasjelltas, mund të ndodhë që i burgosuri ta vuajë më gjatë dënimin. Gjykata Europiane ka gjykuar raste kur një i burgosur është transferuar nga njëri vend në tjetrin dhe si rrjedhojë ka vuajtur një dënim më të gjatë në qeli. Kjo gjykatë ka vendosur që kjo nuk përbën shkelje e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut përveçse kur i burgosuri është mbajtur përtej fundit të vendimit dhënë prej Shtetit i cili jep dënimin.

VIII. Trajnime, vizita të prokurorëve jashtë vendit

Gjatë vitit 2013, Institucioni i Prokurorisë ka koordinuar dhe ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve ndërkombëtare si, trajnime, vizita, konferenca etj. të cituara si më poshtë:

- Trajnim i organizuar nga TAIEX dhe EUROPOL, në Hagë, Hollandë, *mbi luftën kundër krimit ekonomik, shkeljeve të të drejtave intelektuale, falsifikimin e mallrave, prodhimin dhe shpërndarjen e monedhave falco e më gjerë.*
- Takimi i Pestë i Nënkomitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë, BE-Shqipëri i zhvilluar në Bruksel, Belgjikë.
- Takimi i katërt i Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, zhvilluar në Bruksel.
- Me ftesë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, në Budapest, Hungar, është zhvilluar një kurs trajnimi me temë *“Teknikat e hetimit financiar”*.
- Kurs trajnimi në Sofje, Bullgari me temë *“Trafikimi i veprave antike të artit”*, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit.
- Trajnim i organizuar nga ILEA Academy, në Rosëell, Neë Mexico SH.B.A me temë *“Forumi i Politikave për Krimin e Organizuar Transnacional”*.
- Në kuadër të Programit Ndërkombëtar kundër Përhapjes, të Departamentit të Shtetit të Sh.B.A dhe në bashkëpunim me Projektin OPDAT të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, në Prishtinë, Kosovë, është zhvilluar kurs trajnimi me temë *“Rrugët e përhapjes”* (Proliferation Pathways), në të cilin do të trajtohet përmasa e kompleksiteti i përhapjes globale të armëve të shkatërrimit në masë.
- Seminar Trajnimi në Lubjanë, Slloveni, i organizuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Interpolit në Lion, me temë *“Integriteti në sport”*.
- Seminar Teknik në Lubjanë, Slloveni, i organizuar nga mekanizmat e Bashkimit Europian EPAC/EACN, për avantazhet e përdorimit të teknologjisë së informacionit IT në luftën kundër korrupsionit, me temë *“The Anti-Corruption Body’s Perspect”*.

- Me ftesë të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë Z. Adriatik Llalla, ka kryer një vizitë zyrtare në Kosovë.
- Konferenca Rajonale Antikorrupsion për Vendet e Europës Juglindore në Sarajevo, Bosnjë-Herzegovinë, në kuadër të Përvjetorit të 10^{të} të hapjes për nënshkrim të Konventës të Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit.
- Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësues të Institucionit të Prokurorisë kanë zhvilluar një vizitë studimore në Bruksel, Belgjikë, me temë *“Bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda”*, vizitë e organizuar nga Zyra e Bashkimit European për Zgjerimin në kuadër të TAIEX Instrument.
- Me ftesë të Zyrës së Prokurorit të Lartë Publik të Vjenës, në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Shtetit të Lirë të Saksonisë dhe Zyrës së Bashkimit European për Zgjerimin (TAIEX Instrument), Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësues të Institucionit të Prokurorisë, kanë marrë pjesë në Forumin e 16^{të} të Prokurorëve të Përgjithshëm në Vjenë, Austri.
- Lufta kundër korrupsionit”, i organizuar nga Zyra Federale e Antokorrupsionit pranë Ministrisë së Brendshme Austriake.
- ILEA në Budapest / Hungari një kurs trajnimi me temë *“Kurs bazë për hetimin e vendngjarjes në krimet kompjuterike”*, i organizuar nga Zyra Rajonale e Sigurimit pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.
- Korfuz / Greqi takimi i 22 i SEEPAG-ut, me temë *“Kontrabandimin e migrantëve në kuadër të krimit të organizuar”*, si dhe një takim përgatitor me Rrjetin e Prokurorve të Ballkanit Perëndimor.
- Instituti “CEELI” në Pragë/Republika e Çekisë një kurs trajnimi me temë *“Hetimi në çështjet e korrupsionit zyrtar”*, i organizuar nga Zyra Amerikane “OPDAT”
- Takim pune me temë *“Përforsimi i luftës kundër krimit kibernetik”*, Stamboll/Turqi i organizuar nga Cyber Crime@.
- Takimi i radhës në Shkollën Verore për Magjistratët e Rinj të Evropës Jug – Lindore, i organizuar nga Zyra Rajonale i Antikorrupsionit.
- Prokurori i Përgjithshëm, Z. Adriatik LLALLA, ka zhvilluar një takim zyrtar me disa përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, të kryesuar nga z. Ismet Kabashi Prokuror i Përgjithshëm dhe z. Hajredin Kuci Ministër i Drejtësisë, për të diskutuar mbi çështjen e reformave në fushën e drejtësisë dhe të bashkëpunimit me Institucionet e Drejtësisë të Bashkimit Evropian.
- Seminari Rajonal me temë *“Duke luftuar trafikun e qënieve njerëzore dhe bashkëpunimi Prokurori-Polici në luftën ndaj tij”*.
- Seminari Rajonal me temë *“Duke luftuar trafikun ilegal të armëve”*.
- Kursi *“Trajno Trajnerin”* – Bashkëpunimi në Drejtësinë Penale, Mbrojtja e Dëshmitarëve në Luftën ndaj Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (ËINORO II),
- Seminari me temë *“Fokusimi në kriteret për përfshirjen në BE, lidhur me parimin e shtetit të së drejtës”*.
- Seminari *“Lufta kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, duke forcuar Rrjetin e Prokurorëve”*.

- Konferenca Rajonale mbi *Trafikun e qënieve njerëzore dhe prostitucionin* me temë “Eksperiencia Suedeze dhe eksperiencia e Ballkanit”,
- Kurs për trajnimin e Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore, pranë Shkollës së Policisë Tatimore të Romës.
- Trajnimi rajonal në Shkollën Rajonale të Administratës Publike, me temë “*Skuadrat e përbashkëta hetimore*”.
- Sekretari i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme, ka zhvilluar disa takime me drejtues të Guardia di Finanzës në Romë, Itali, lidhur me bashkëpunimin në fushën e trajnimeve të ardhshme të Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore si dhe mbështetjen logjistike të Guardia di Finanzës.
- Në kuadër të projektit të Trajnimit Evropian Anti-Korrupsion (EACT), i organizuar nga Zyra Anti-Korrupsion (BAK) e Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme të Austrisë, në Vienë, Austri u zhvillua Takimi i 4-t i Grupit të Punës mbi hetimin dhe procedimin në fushën kundër korrupsionit.
- Takim operacional në Mal të Zi, në kuadër të një hetimi të përbashkët ndërkombëtar të autoriteteve të drejtësisë së Bosnjës & Herzegovinës, Kroacisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë, në kuadër të aktivitetit kriminal të trafikimit të narkotikëve.
- Seminar në Blagoevgrad, Bullgari, me temë “*Implementimi i një Përqasjeje Gjithpërfshirëse dhe të Integruar në Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit në Rajonin e Danubit*”.
- Në kuadër të projektit të përbashkët rajonal BE/KE për Krimin Kibernetik (CyberCrime@IPA), është zhvilluar Konferenca e Prioriteteve Strategjike, në Dubrovnik, Kroaci, e organizuar nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë së Kroacisë. Qëllimi i konferencës ishte të prezantojë mjetet e zhvilluara sipas projektit, të finalizohen dhe miratohen rezultatet e vlerësimit të kryer së fundmi dhe arritja e një marrëveshjeje apo miratimi i një deklaratë rajonale mbi prioritetet strategjike në bashkëpunimin kundër krimit kibernetik.
- Kurs dy javor mbi menaxhimin e skenës së krimit organizuar nga Qendra Shkencore e Kolegjit të Policimit në Angli.

Veçojmë këtu trajnimet e bëra nëpërmjet Projektit IPA 2010 2010 “*Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve*”, ku Prokuroria Shqiptare ka qenë një ndër përfituesit mes vendeve të Rajonit të Ballkanit Perëndimor, përkatësisht, Mali i Zi, Maqedoni, Kosovë, Serbi, Kroaci, Bosnjë-Herzegovinë. Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar një sërë trajnimesh:

- Takimi i Bordit Drejtues, në Zagreb, Kroaci në kuadër të programit rajonal IPA 2010 “*Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve*”.
- Konferenca Rajonale në Zagreb, Kroaci në kuadër të programit rajonal IPA 2010 “*Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve*”.
- Takimi i 4^t i Komitetit Drejtues të Projektit Rajonal IPA 2010 “*Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve*” në Lubjanë, Slloveni.
- Vizitë studimore në USKOK (Zyra për Shtypjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar), Kroaci, në kuadër të programit rajonal IPA 2010 “*Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve*”. Secili nga prokurorët pjesëmarrës gjatë ditëve të qëndrimit ka punuar me një nga Zv/Drejtuesit e USKOK.

- Vizitë studimore në kuadër të programit rajonal IPA 2010 “*Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve*”, me objekt “*Trajtimin e çështjeve të krimit të organizuar nga pikëpamja e bashkëpunimit midis policisë dhe prokurorisë dhe çështjet e korrupsionit në nivele të larta*” në Çeki dhe Austri.
- Trajnim mbi pastrimin e parave dhe hetimin e korrupsionit, në Shkup Maqedoni.
- Konferencë për ndërgjegjësimin mbi produktet e veprës penale që kanë ndikim mbi sigurinë, në Alikante Spanjë.

IX. Përfshirje e Prokurorisë me vendosje pika kontakti në organizata të ndryshme si dhe pika kontakti ndërinstitucionale.

Prokuroria e Përgjithshme ka disa pika kontakti me strukturat ndërkombëtare, konkretisht me EUROJUST Njësia e Bashkëpunimit Gjyqësor të Bashkimit Europian; SEEPAG, Grupi i Këshillimit të Prokurorëve të Europës Juglindore; ILECU/SELECU, Njësia e Koordinimit Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit etj.


PJESA IV

PROKURORIA PËR KRIME TË RËNDA

Volumi dhe dinamika e procedimeve

Gjatë vitit 2013 në Prokurorinë për Krime të Rënda u hetuan 471 procedime, nga të cilat 133 të mbartura nga vitet e mëparshme dhe 338 të regjistruara rishtazi gjatë vitit që kaloi. Kanë marrë zgjidhje 248 procedime, ndërkohë që u mbartën për vitin 2014, 223 procedime. Kjo situatë paraqitet në vijim:

Dinamika e lëvizjes së çështjeve




Vihet re rritje e numrit të procedimeve të regjistruara rishtazi (94 më shumë se në vitin 2012). Referimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit vazhdojnë të mbeten në të njëjtat nivele me vitin 2102 (shih Tabelën 1). Ndërkohë, kanë marrë zgjidhje përfundimtare 248 procedime, ose 52 procedime më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Për shkak të rritjes së ngarkesës numri i çështjeve të mbartura për këtë vit pësoi rritje. Rezulton se puna e përballuar në hetime, referuar numrit të procedimeve, u rrit në raport me vitet e kaluara, kryesisht si rezultat i rritjes së numrit të rasteve të flagrancës në pikat e kalimit kufitar.

Origjina e procedimeve të regjistruara

Nr.	Mënyra e regjistrimit	Numri i procedimeve
1	Me vendngjarje	66
2	Ardhur me transferim nga prokurorite e rretheve	50
3	Kallëzime nga shtetasit dhe referime nga PGJ e zyrave rajonale	142
4	Referime nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	19
5	Regjistruar kryesisht ose me urdhër të Prokurorisë së Përgjithshme	5
6	Nga ndarja e procedimeve në dorë	50
7	Bashkuar me procedime të tjera	6
8	Procedime të rifilluara	3
9	Nga autoritetet e huaja	2
10	Referim nga SHKB	1
TOTAL		344

Treguesit teknikë


Në përfundim të hetimeve u dërguan për gjykim 122 çështje (42 më shumë se 2012), u pushuan 36 procedime dhe u pezulluan 56. Në gjyq u dërguan 57% e numrit të procedimeve të zgjidhura (për vitin 2012 ky tregues ka qenë 48%), që konsiderohet një tregues shumë i mirë. Gjatë 2013-ës u transferuan për kompetencë në prokuroritë e rretheve gjyqësore 34 procedime, tregues gati i barabartë me një vit më parë.




3. Tipologjia dhe tendenca e kriminalitetit

Ndër grupveprat penale të hetuara, ashtu si vitet e kaluara, pjesën dërmuese e përbëjnë krimet e trafikimit të lëndëve narkotike (269 procedime – 57%), shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë (62 procedime – 13%), vrasjet e ndryshme, sidomos vrasjet brenda familjes (47 procedime – 10%), trafikimi i qënieve njerëzore (41 procedime – 8,7%), trafikim i armëve dhe i municioneve (23 procedime – 4,9%), veprat e ndryshme penale të kryera nga organizata kriminale dhe grupe të strukturuar (12 procedime – 2,5%), rrëmbimi i personit (12 procedime – 2,5%).

NUMRI I PROCEDIMEVE TE HETUARA SIPAS GRUPVEPRAVE KRYESORE




Analiza e të dhënave tregon se, në raport me mesataren e viteve 2009, 2010 (shih diagramën 4), numri i procedimeve për trafikim të lëndëve narkotike është pesëfishuar. Rritje të ndjeshme patën procedimet për krimet e vrasjes, për shkak të përfshirjes në kompetencën lëndore të GJKR-së të vrasjeve brenda familjes dhe vrasjeve për gjakmarrje. Numri i procedimeve të regjistruara për trafikim të qënieve njerëzore, pati të njëjtin trend me 2012, me një rritje të vogël (nga 36 në 41 raste). Rastet e kimit të shtrëngimit me anën e kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë vazhdojnë të kenë rritje. Tendenca e kriminalitetit të hetuar për krime të kryera nga organizata ose grupe të strukturuar mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2012.



Vendimmarrja për subjektet

Gjatë vitit 2013 u vunë nën hetim 413 persona, 65 më shumë se në vitin 2012. Nga këta, 204 u dërguan për gjykim dhe 120 u mbartën për vitin në vazhdim. U pushuan hetimet ose akuzat për 49 subjekte, ndërsa procedimet për 40 subjekte u transferuan për kompetencë në prokuroritë e tjera.

Ndër 204 subjektet e dërguar për gjykim, pjesa më e madhe e tyre (184) kanë qenë nën masën e sigurimit arrest në burg (172 në fakt dhe 12 në mungesë), kurse 5 prej tyre nën masën e arrestit në shtëpi (*shih diagramën 6*). Ndërkohë, 8 subjekte kanë qenë nën masën e sigurimit detyrim për paraqitje në PGJ, kurse 2 pa masë sigurimi.




U pushuan akuzat ose çështjet për 49 persona, nga të cilët 5 kanë qenë me arrest në burg (3 të arrestuar në fakt), 2 me detyrim për paraqitje, 30 persona pa masë sigurimi dhe 8 me ndalim dalje jashtë shtetit.

Nga 40 personat e hetuar në procedimet e transferuara për mungesë të kompetencës lëndore, 29 kanë qenë të arrestuar dhe 4 kanë qenë pa masë sigurimi. Janë transferuar, gjithashtu, 5 persona me detyrim për paraqitje dhe 2 në arrest shtëpie.

Për vitin 2014 u mbartën 120 persona në procedimet ende në hetim. Nga këta 95 janë të arrestuar në fakt, përgjithësisht në flagrancë të krimit, 5 janë me masë arrestimi në mungesë. Vazhdojnë të hetohen pa masë sigurimi 18 persona, 1 person me ndalim dalje jashtë shtetit, kurse 1 i hetuar me detyrim për paraqitje.

Masat e sigurimit personal të zbatuara për personat nën hetim, krahasuar me numrin e procedimeve dhe veprat penale të hetuara jepen në tabelë.


Çështjet e dërguara për gjykim, sipas llojit të veprave penale, paraqiten në diagramën 10. Numrin më të madh të tyre (91 çështje ose 38 më shumë se 2012-ta) dhe të personave të akuzuar (129 të pandehur ose 50 më shumë se 2012-ta) e përbëjnë, sikurse edhe vitet e tjera, trafikimi i lëndëve narkotike. Vitin që shkoi u dërguan për gjykim dy çështje për vepra të kryera nga organizata dhe grupe të strukturuar kriminale.



Volumi dhe dinamika

Gjatë vitit 2013 përfundoi gjykimi në shkallë të parë për 120 çështje (34 më shumë se një vit më parë) me 201 persona të akuzuar (39 më shumë se në 2012-n). Numri i çështjeve të gjykuara gjatë viti të kaluar është më i larti në të gjitha këto vite. Gjithashtu, përfundoi gjykimi në apel dhe u vunë në ekzekutim 97 vendime penale (28 më shumë se gjatë vitit 2012), për 155 persona (38 persona më shumë se në vitin 2012). Në fazën e gjyqimit në shkallë të parë u mbartën për 2014-n - 23 çështje (4 më shumë se në 2012-n). Të gjitha vendimet e gjykatës së apelit janë vënë në ekzekutim brenda afatit ligjor.


ECUARIA E ÇESHTJEVE NE GJYKIM




Politika e dënimit

Gjatë vitit 2013, për dënimet me burgim vërehet e njëjta politikë dënimesh si në vitin e kaluar, pa ndryshime të ndjeshme. Rastet e pakta të gjykuara për akuzat e vrasjes së cilësuar dhe të trafikimit të njerëzve, nuk lejojnë të nxirren konkluzione për plolitikën e dënimit (edhe pse në terma absolute vihet re ashpërsim i dënimeve. Për krimin e trafikimit të lëndëve narkotike, gjatë vitit 2013, pati një zbutje të lehtë të dënimeve, për shkak të rasteve të shumta të kapjes së sasive të vogla, të kryera nga persona me rrezikshmëri jo të theksuar.

TREGUESIT E POLITIKES SE DENIMIT SIPAS GRUPEPRAVE KRYESORE



Me gjykim të zakonshëm u gjykuan 20 çështje (29 të pandehur), kurse me gjykim të shkurtuar 100 çështje (172 të pandehur). Shifrat e vitit të kaluar janë më të lartat në historinë e GJKR; rastet e gjykimit të shkurtuar në raport me gjykimin e zakonshëm janë pesë herë më të larta. Prirja e të akuzuarve për të zgjedhur gjykimin e shkurtuar, besojmë se nuk lidhet vetëm me dëshirën për të përfituar zbritje dënimi, por edhe me faktin e plotësisë dhe cilësisë së hetimeve të kryera, që lejojnë zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet në fashikullin e prokurorit.



Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, siç parashikohet në ligj dhe në statistikat e prezantuara më lart, ka prioritet të saj luftën kundër krimit të organizuar. Në drejtim të forcimit të kapaciteteve të kësaj strukture, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore janë përfshirë aktivisht në takime trajnuese, në kuadër të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, janë zhvilluar dhe është marrë pjesë në disa aktivitete;

- Tryezë e Përbashkët, me temë, “Mbi akseset e viktimave të trafikimit në procesin penal”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me IOM zhvilluar në datë 10.06.2013,
- Seminar trajnues me temë, “Trafikimi i qënieve njerëzore dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit”, Sarajevo zhvilluar në datë 19-20 shtator 2013).
- Mbledhje e grupit të punës për vendet e Europës juglindore për programin GIT, zhvilluar në datë 10.12.2013, Lubjanë – Slloveni.
- Tryezë me temë “Lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore” zhvilluar në datë 03-04.06.2013 në Vjenë – Austri.
- Pjesëmarrje në një konference të mbajtur në Zagreb në datat 21-22 Nëntor 2013 për Mbrojtjen e viktimave të trafikut të Qënieve Njerëzore organizuar me mbështetjen e Ambasadës së Suedise dhe pjesëmarrjen e Prokurorëve, Oficerëve të Policisë gjyqësore, gazetarve, drejtuesve të qendrave të mbrojtjes dhe trajtimit të viktimave nga rajoni i Ballkanit.

Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka marrë pjesë aktive në takimet periodike me Task Forcën Kombëtare për trafikimin e qënieve njerëzore, organizatat ndërkombëtare, donatorët etj.

PJESA V

OBJEKTIVAT E PROKURORISË PËR VITIN 2014

Pasi ju paraqitëm në mënyrë të detajuar gjendjen e kriminalitetit dhe aktivitetin institucional gjatë vitit 2013, duke u vënë theksin në realizimin e objektivave prioritarë të Prokurorisë së Përgjithshme, raporti vijon me objektivat e mëtejshëm për periudhën në vijim. Fokusi kryesor i punës do të vijojë të jetë lufta kundër korrupsionit dhe rritja e efektivitetit në ndjekjen penale.

OBJEKTIVAT DHE VIZIONI I PROKURORISË SHQIPTARE NË STRATEGJINË KOMBËTARE KUNDËR KORRUPSIONIT 2014-2017

Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomiko-financiar mbetet një ndër prioritetet e punës së prokurorisë. Në funksion të këtij prioriteti, me synim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në hetimin dhe ndjekjen penale kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, institucioni jonë ka ndërmarrë hapa konkretë dhe ka arritur rezultate të ndjeshme.

Prokuroria Shqiptare në ushtrim të funksioneve të saj kushtetuese ka vijuar përmbushjen me sukses të detyrimeve që rrjedhin nga ligji si dhe ka ndjekur me vemendje rekomandimet e organizmave ndërkombetare.

Objektivat kryesorë të Prokurorisë Shqiptare në luftën kundër korrupsionit, janë të lidhura me rritjen e efektivitetit në procesin e ndjekjes penale, forcimin e kapaciteteve institucionale, me qëllimin kryesor arritjen standarteve më të larta në aktivitetin institucional si dhe rritjen e garancive më të mëdha në procesin e punës të prokurorisë.

Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale

- Rritja e shpejtësisë dhe efikasitetit të ndjekjes penale, forcimin e kapaciteteve në sistemin e prokurorisë duke mundësuar shtimin e numrit të prokurorëve për shkak të rritjes së ngarkesës së volumit dhe dinamikës të punës.
- Krijimi i shërbimeve të ekspertimeve pranë sistemit të prokurorisë, në përbërje të së cilët do të kishte ekspertë të krimit kibernetik, autoteknik, kontabël dhe vlerësues, eksperteve psikologe për të mitur etj, të cilët do kontribuojnë me ekspertiza të specializuara si dhe trajnime të prokurorëve e oficerëve të policisë gjyqësore, do të ndihmonte maksimalisht në forcimin e kapaciteteve hetimore në këtë drejtim.
- Mbështetja në të gjitha drejtimet e punës së Njësive të Përbashkëta Hetimore, duke orientuar rritjen e numrit të hetimeve proaktive, rritjen e aftësive hetimore si dhe mbështetjen me staf të trajnuar të këtyre njësive dhe mundësinë e shtrirjes së tyre edhe në prokurori të tjera.
- Zbatimi i efektshëm dhe përmirësimi i mekanizmave dhe mjeteve për hetimin e akteve dhe veprimeve korruptive.
- Rritja e mekanizmave të kontrollit e të vetëkontrollit të strukturave të prokurorisë, forcimi i rolit të inspektimit dhe mbështetja me bazën e duhur ligjore për matjen e vlerësimit e performancës së prokuroreve.
- Aksesimi i drejtpërdrejtë në regjistrat elektronike të administratës publike, në interes të hetimit.
- Garantimin e statistikave periodike të ecurisë së ndjekjes penale, unifikimi i të dhënave statistikore me agjensite e tjera ligjzbatuese.

Forcimi i integritetit të prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore

- Niveli i statusit të prokurorëve dhe gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, duke përfshirë edhe pagat, ende nuk është në përputhje të plotë me standardet europiane dhe rekomandimet e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Aktualisht ka nevojë për një analizë dhe standartizim të të gjitha privilegjeve që gëzojnë gjyqtarët dhe prokurorët për shkak të detyrës.
- Konsolidimi i sistemit të vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore.
- Zbatimi me efikasitet të Kodit të Etikës së prokurorëve dhe vënia në funksion e strukturave të ngarkuara me kontrollin e zbatueshmërisë së tij.
- Përcaktimi ligjor i kohëzgjatjes së mandatit të drejtuesve të Prokurorive të rretheve dhe apeleve.
- Përmirësimi i procesit të seleksionimit të kandidatëve për magjistratë dhe vlerësimi i nevojës për vendosjen e një kriteri kohor eksperience në profesionin e juristit para kandidimit për magjistrat.
- Rritja e profesionalizmit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.
- Përmirësimi i statusit të administratës procedurale në organin e prokurorisë (ndihmësit ligjore, sekretaria procedurale).

Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional

- Përmirësimi dhe rritja e vazhdueshme e bashkëpunimit me të gjitha institucionet që kanë shërbime të Policisë Gjyqësore. Koordinimi me institucione të tjera si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, administrate tatimore dhe doganore etj, janë në fokus të punës të organit të prokurorisë.
- Në këtë drejtim, me anë të forcimit të këtij bashkëpunimi synohet parandalimi dhe reduktimi progresiv i korrupsionit, forcimi i integritetit të policisë dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, rritja e treguesve në luftën kundër korrupsionit, evidentimit dhe dokumentimit sa më efektiv të hetimeve për korrupsion, krijimit të një sistemi të konsoliduar të dhënash për regjistrimin e hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në fushën e korrupsionit të zyrtarëve publikë.

Masa legjislative

- Në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe intensifikimit të punës në drejtim të hetimeve proaktive, në ndryshimet e ardhshme të Kodit të Procedurës Penale, në nenin 221 të K.P.Penale të “Kufij të lejimit të përgjimeve” duhet të shtohet edhe për veprat korruptive, duke qënë se jo të gjitha veprat korruptive kanë të parashikuar masën e dënimit me burgim jo më pak në maksimum se shtatë vjet, siç është rasti i veprës penale të Korrupsionit aktiv të nëpunësve të huaj publikë (neni 244/a i K.Penal), Korrupsionit aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë (neni 245); Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike (neni 245/1 K.Penal) etj.
- Rishikimi dhe realizimi i disa amendimeve në ligjin 10192, datë 03.12.2009. “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.
- Ndryshimi dhe përshtatja e ligjit nr.9508, datë 03.04.2006 “Mbi bashkëpunimin e publikut kundër korrupsionit” me standardet ndërkombëtare, dhënia e garancive të plota të personit që kallzon korrupsionin etj.

Nxitja e publikut për të përdorur mekanizmat për ankesa dhe denoncime për korrupsion

- Ndërtimi dhe përmirësimi i mekanizmave ekzistues që sigurojnë transparencën dhe marrëdhëniet me publikun,
- Shtimi i adresave dhe numrave falas, krahas atyre ekzistues, për ankimet.
- Ruajta e standartit të mos aplikimit të tarfave në depozitim të kallzimeve për veprat penale.

ROLI I PROKURORISË NË STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË

Strategjia e re Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe plani i saj i veprimit për periudhën 2014-2020 duhet të vijojë të përqendrohet në parimet kryesore të sistemit të drejtësisë:

- përgjegjshmëria ndaj Kushtetutës dhe ligjit
- respektimi i të drejtave të njeriut
- paanësia;
- aksesimi në drejtësi;
- transparenca

Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale

- Duke vlerësuar punën dhe rezultatet e Njësive të Përbashkëta Hetimore, do të vijojë mbështetja në të gjitha drejtimit puna e 7-të Njësive të Përbashkëta Hetimore të ngritura për këtë qëllim, duke orientuar rritjen e numrit të hetimeve proaktive, rritjen e aftësive hetimore si dhe mbështetjen me staf të trajnuar të këtyre njësive. Gjithashtu, për shkak të ngarkesës së madhe dhe numrit të çështjeve të trajtuara, synojmë që në përbërje të strukturës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të krijohet një Njësi e Përbashkët Hetimore, sipas memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar në datë 6 maj 2009.
- Mungesa e aksesit në regjistrat publike të prokurorëve të Njësive të Përbashkëta Hetimore dhe të Prokurorisë për Krime të Rënda, është bërë pengesë për kryerjen me shpejtësi dhe efektivitet të ndjekjes penale nga organi i prokurorisë. Ky fakt është bërë prezent dhe është ngritur si shqetësim edhe nga ekspertët ndërkombëtarë të cilët kanë sugjeruar marrjen e masave konkrete në këtë drejtim. Sa më sipër vlerësojmë se aksesimi në bazat e të dhënave funksionale nga ana e prokurorëve të Njësive të Përbashkëta Hetimore dhe të Prokurorisë për Krime të Rënda, do të ndikojë ndjeshëm në rezultatet e luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.
- Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale, duke patur synim rritjen e kërkesave të vazhdueshme për arritjen e standarteve më të mira në aktivitetin institucional, performancën dhe efektivitetin në punën e prokurorëve, apo përmirësimet në organizimin dhe funksionimin e organit të Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë disa propozime konkrete për amendim të ligjit organik të Prokurorisë.

Përmirësimi i statusit të prokurorëve

- Në këtë pikë e gjejmë me vend të theksojmë se niveli i statusit të prokurorëve dhe gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, duke përfshirë edhe pagat, ende nuk është në përputhje të plotë me standardet europiane dhe rekomandimet e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Aktualisht ka nevojë për një analizë dhe standartizim të të gjitha privilegjeve që gëzojnë gjyqtarët dhe prokurorët për shkak të detyrës.

Forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore

- Në drejtim të forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore është e domosdoshme rritja e numrit të prokurorëve. Sipas dekretit të vitit 2002 të Presidentit të Republikës numri i

prokurorëve në gjithë sistemin e prokurorisë është 330. Duke konsideruar se nga të dhënat statistikore kemi një rritje shumë të ndjeshme të numrit të përgjithshëm të çështjeve të regjistruara nga viti 2002 (9170 çështje të regjistruara), krahasuar me ngarkesën e vitit 2013 (27651 çështje të regjistruara) e vlerësojmë mundësinë e shtimit të numrit të prokurorëve si një masë konkrete në drejtim të rritjes së efektivitetit, cilësisë dhe kapaciteteve njerëzore të prokurorisë.

- Nga praktika e deritanishme dhe problematikat e përditshme që përballet organi i akuzës lidhur me nevojat për shërbimin e ekspertimeve gjatë hetimeve dhe ndjekjes penale ka lindur domosdoshmeria për krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të ekspertimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si ekspert autoteknik, kontabël dhe vlerësues, ekspert të kibernetikës, e psikologe për të mitur etj. Nëpërmjet përmirësimit të strukturës së brendshme të Prokurorisë së Përgjithshme synohet të arrihet rritje e koordinimit dhe efikasitetit të organit të akuzës, në përputhje dhe me rekomandimet e ekspertëve të BE-së.

- Duke iu referuar shqetësimit të ngritur dhe në Progres Raportin e vitit 2013 lidhur me çështje të krimit kibernetik si një fushë që kërkon prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore të specializuar, synojmë vazhdimin e realizimit të trajnimeve të thelluara në këtë fushë për prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore. Gjithashtu, krijimi i shërbimeve të ekspertimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në përbërje të së cilët do të kishte dhe ekspertë të krimit kibernetik, që do të ngarkohej me ekspertiza të specializuara si dhe trajnime të prokurorëve e oficerëve të policisë gjyqësore, do të ndihmonte maksimalisht në forcimin e kapaciteteve hetimore në këtë drejtim.

Përmirësimi i kushteve të punës në prokurori

- Investime të mëtijshme në Prokurori, nëpërmjet ndërtimeve të godinave të reja apo rikonstrukcione të nevojshme, mbetet një objektivi i rëndësishëm me qëllim përmirësimin e kushteve të punës në prokurori, nevoja të cilat do të konkretizohen me analiza të plota nga grupi i punës që do të përfaqësojë Prokurorinë e Përgjithshme në procesin e hartimit të Strategjisë dhe planit të veprimit për periudhën 2014-2020.

MARRËDHËNIET ME JASHTË, NEVOJA PËR PËRMIRËSIME

Së pari, vlerësohet mjaft e rëndësishme vendosja e një Programi INTRANET për Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili rrit kapacitetet për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, rrit efikasitetin në punë duke përmirësuar në mënyrë të ndjeshme monitorimin në zgjidhjen e praktikave gjatë gjithë procesit dhe brënda afateve kohore të përcaktuara, gjeneron informacion të shpejtë për praktikatat si dhe të dhëna statistikore për kryerjen e analizave periodike, duke siguruar kështu një sistem raportimi elektronik që mund të jetë shumë i dobishëm për mbledhjen e të dhënave në mënyrë të saktë dhe në kohën e duhur.

Së dyti, tashmë paraqitet mjaft i nevojshëm azhurnimi i legjislacionit të brendshëm në fushën e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar në këtë fushë dhe për shkak të dinamizmit të tij gjatë viteve të fundit. Duke qenë se, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale rregullohen nga konventat ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe, kodi i procedurës penale (Titulli X) dhe Ligji nr. 10 193, dt. 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” është mjaft e rëndësishme që legjislacioni i brendshëm të jetë në përputhje me atë ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana jonë janë konstatuar, mospërputhje midis vetë legjislacionit të brendshëm e konkretish, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009, të cilat mund të zgjidhen duke bërë ndryshimet përkatëse në këtë Kod.

Gjithashtu duhen bërë plotësime të mëtejshme për të inkorporuar parashikimet e konventave ndërkombëtare, të cilat në disa raste kanë nevojë për detaje dhe specifikime më të hollësishme. Një nga rastet psh janë skuadrat e përbashkëta hetimore (SPH) të parashikuara në nenin 20 të Protokollit të dytë shtesë të Konventës Evropiane për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale. Ky nen parashikon ngritjen, strukturën, etj të SPH por vetë vendet duhet të parashikojnë në legjislacionin e brendshëm dispozita konkrete si lidhur me autoritetetin që autorizon ngritjen e SPH-ve, vlerën e provave të mbledhura nga SPH-të, etj.

Një çështje tjetër janë urdhrat e arrestit ndërkombëtar. Mbështetur në nenin 2/1 të Konventës Evropiane të Ekstradimit, për personat e dënuar me vendim penal të formës së prerë parashikohet një minimum dënimi prej 4 muajsh. Për më tepër RSH në një deklaram që ka bërë në ratifikimin e Konventës Evropiane të Ekstradimit është shprehur mbi mospasjen e një limiti në afatin e burgimit për efekt ekstradimi.

Limit kohor prej 4 muajsh parashikohet edhe në ligjin nr. 10193, neni 32/b. Mbi këtë bazë është nxjerrë dhe udhëzimi i përbashkët midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme për shpalljen në kërkim ndërkombëtar.

Por në praktikë shpallja në kërkim ndërkombëtar dhe më pas ekstradimi i shtetasve të dënuar me 4 muaj, apo 6 muaj paraqet një kosto financiare për shtetin shqiptar. Shumica e shteteve palë të konventës evropiane të ekstradimit kanë deklaruar si limit një afat një-vjeçar. Do të ishte me rëndësi që të konsiderohej një ndryshim në këtë pikë duke parashikuar të paktën një afat një-vjeçar.

Së treti, nënshkrimi i Marrëveshjeve Dypalëshe në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale me vende si, Belgjika, Greqia etj., e konkretisht për, ekstradimin dhe transferimin e të dënuarve.

Së katërti, duke marrë në konsideratë faktin se, legjislacioni ndërkombëtar në këtë fushë po zhvillohet gjithnjë e më tepër, gjë e cila shoqërohet me nënshkrimin e Protokolleve shtesë, Marrëveshjeve, Memorandumeve të Bashkëpunimit, lind e nevojshme që Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Ekzekutimeve Penale, por jo vetëm, të trajnohen vazhdimisht nga ekspertë vendas dhe të huaj. Gjithashtu, është e nevojshme të zhvillohen trajnime lidhur me krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore dhe krimin kibernetik.

Së pesti, për çështje të veçanta është e nevojshme dhe e rëndësishme pjesëmarrja e Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gyqësore shqiptarë gjatë ekzekutimit të kërkesave për ndihmë juridike jashtë vendit, ku pengesë deri më tani ka qenë mungesa e burimeve financiare.

Të nderuar deputetë,

Duke shprehur vlerësimin për mbështetjen e deritanishme, si edhe duke Ju siguruar se organi i Prokurorisë do të vijojë të jetë i angazhuar maksimalisht në luftën kundër kriminalitetit në, si edhe në forcimin e shtetit ligjor në Shqipëri.

Ju faleminderit